

# RAPORTI VJETOR 2022

# Përmbajtja

- 1.** Cilët jemi ne
- 2.** Mesazhi i Kryetarit të Këshillit Drejtues
- 3.** Mesazhi i Drejtores së Përgjithshme Ekzekutive
- 4.** Banka dhe aksionarët e saj
  - 4.1 Historiku i Union Bank
  - 4.2 Aksionarët e Union Bank
  - 4.3 Organet Drejtuese të Bankës
- 5.** Mjedisi makroekonomik dhe sistemi bankar në Shqipëri
  - 5.1 Mjedisi makroekonomik i jashtëm
  - 5.2 Mjedisi makroekonomik në vend
  - 5.3 Sektori bankar në Shqipëri
- 6.** Performanca në Union Bank
  - 6.1 Treguesit kryesorë financiarë
  - 6.2 Shërbimi ndaj klientit
- 7.** Biznesi për Klientët Individë
- 8.** Raporti i Produkteve dhe Segmenteve të klientëve
  - 8.1 Shërbime bankare për Individë
  - 8.2 Shërbime bankare për Biznese
  - 8.3 Kreditë e dhëna për klientët
- 9.** Zhvillimi i Operacioneve të Brendshme
- 10.** Zhvillimi dhe Menaxhimi i Rrjetit
  - 10.1 Roli i degëve dhe zhvillimi i prezencës fizike (Degë dhe ATM)
- 11.** Menaxhimi i Rrezikut
- 12.** Burimet Njerëzore, trajnimi dhe zhvillimi i stafit
  - 12.1 Struktura Organizative
  - 12.2 Zhvillimi i Burimeve Njerëzore
  - 12.3 Rekrutimi dhe përzgjedhja e stafit
  - 12.4 Programi i Praktikës
  - 12.5 Trajnime dhe edukimi i mëtejshëm
  - 12.6 Politikat e pagesave
  - 12.7 Risku dhe siguria në punë
- 13.** Aktivitetet Marketing dhe Përgjegjësia Sociale
- 14.** Planet për vitin 2023
  - 14.1 Planet Strategjike
  - 14.2 Planet dhe performanca financiare
- 15.** Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2022

# CILËT JEMI NE

## MISIONI YNË

Union Bank është angazhuar që të jetë një institucion financiar i fortë dhe i qëndrueshëm, duke ofruar produkte lehtësisht të aksesueshme dhe të diferencuara, si dhe eksperiencë të shkëlqyer bankare për të gjithë klientët tanë.

## VIZIONI

Ne qëndrojmë në treg të fortë, për t'i ofruar klientëve tanë, kolegëve dhe komunitetit, mundësi për të bërë më shumë në jetë.

# VITI 2022

## NË PAMJE TË SHPEJTË

### POZICIONIM I MIRË NË TREG


Rritje asetesh në total 14.1%.

Portofoli i Kredisë me rritje 16.3%, duke sjellë një diversifikim më të mirë, dukshëm më mirë se tregu, tregues i një prezence në treg pavarësisht një tjetër vitit të veçantë.

Depozitat në rritje 8.8% të diversifikuara në një bazë të konsiderueshme klientësh mbi 113,000<sup>1</sup>.

Kapitalizim i fortë me një Raport Mjaftueshmërie prej 15.8%.

■ Rritja e asetëve  
■ Rritja e depozitave  
■ Rritja e portofolit kreditor




### PERFORMANCA FINANCIARE STABËL

Kthimi mbi kapitalin rezulton 11.4% nivel dyshifror që tregon themele të forta të performancës në një mjedis ekonomik e financiar mjaft dinamik dhe me risqe të shtuara si ky i vitit të fundit.

Raporti Kosto mbi të Ardhurat ndryshon pak nga niveli i 2021, rritet me 4.0% duke qenë se banka është në rritje, duke fuqizuar edhe strukturat dhe kapacitetet e saj.

Përmirësim të aktiveve për punonjës dhe aktiveve për degë me 6.7% dhe 14.1% respektivisht.

### Kthimi mbi asetet



### PLANET PËR 2023


Rritje e planifikuar të zërave kyç të bilancit, si fondet, investimet dhe kredia ndërmjet kufijve 8-13%, më fort rritje në kredihënie.

Kthimi mbi kapitalin me mbi 14%.

Forcim i strukturës sonë të degëve me shërbim më cilësor dhe profesional.

Investime në teknologji, për një shërbim të shpejtë dhe komod në të gjitha kanalet tona të shërbimit, degë apo platforma digjitale.

### Kthimi mbi Kapitalin



<sup>1</sup> Klientë që kanë të paktën një produkt bankar

# VLERAT TONA THEMELORE

- Ne çmojmë **integritetin** si organizatë dhe si individë.
- Ne kërkojmë të krijojmë **marrëdhënie besimi dhe respekti** me klientët tanë.
- Ne vlerësojmë **profesionistët e kualifikuar, besnikë dhe të përkushtuar** si aset in tonë më të çmuar.
- Ne vlerësojmë **dedikimin pa kompromis** për të kuptuar dhe plotësuar nevojat financiare të klientëve tanë si dhe për të nxitur rritje të qëndrueshme.
- Ne **përqafojmë ndryshimin** dhe do të vazhdojmë të kërkojmë mënyra për të siguruar cilësi, shërbime me kosto efektive që plotësojnë apo tejkalojnë pritshmëritë e klientëve tanë.
- Ne jemi të përkushtuar për të ofruar **shërbimin më të mirë të mundshëm** për klientët tanë.
- Për t'i shërbyer aksionerëve tanë dhe për të pasur mbështetjen e tyre, ne jemi të përkushtuar **për një komunikim transparent të strategjisë sonë**, qeverisje të kujdesshme dhe kthime tërheqëse dhe të qëndrueshme.

# MESAZH I KRYETARIT TË KËSHILLIT DREJTUES



**Edmond LEKA**  
Kryetar i Këshillit Drejtues

**Në vitin 2022  
shënuam një  
rritje të bazës së  
klientëve me 11.7%.**

Në vitin 2022, kur pritej një kthim në konsum pas daljes nga pandemia COVID 19, bota u përball me goditjen nga konflikti Rusi-Ukrainë. Ky konflikt i dha një efekt shtesë inflacionit të pritshëm prej rritjes në konsum dhe problemeve me rrjetin e furnizimit si pasojë e COVID-19. Solli një krizë energjitike në botë si rrjedhojë e krizës së furnizimit me lëndë të parë nga Ukraina dhe me gaz nga Rusia. Ky konflikt pati një impakt të madh në ekonominë globale duke arritur në pikën e paralajmërimit të një mundësie për një recesion të ri.

Ndërkohë, ekonomia e Shqipërisë shënoi një tjetër vit të mbarë në 2022, me rritje në nivelin 3.74%<sup>2</sup> e shpërndarë në gjithë sektorët e ekonomisë, e kryesuar nga ndërtimi pothuaj përgjatë gjithë vitit. Ecuria e ekonomisë në Shqipëri u ngadalësua ndjeshëm në tremujorin e dytë të vitit ndikuar nga lufta në Ukrainë, por u rigjallërua më tej në tremujorin e tretë ndikuar nga sektori i ndërtimit dhe i turizmit, të cilët priten të vazhdojnë të jenë dy sektorët më të rëndësishëm që do të ndihmojnë në rritjen e ekonomisë edhe në të ardhmen. Nga ana tjetër, inflacioni, i cili ka qenë kryefjala e analizave ekonomike në vitin 2022, ishte më i kontrolluar se vendet e rajonit dhe vendet e BE-së, kjo falë subvencionimit të çmimit të energjisë elektrike.

Në vitin e kaluar, banka jonë arriti suksese në shumë fusha. Ne arritëm të rrisim total asetet me 14.1%, duke arritur në 91,852 milion lekë, ku 75% sigurohen nga depozitat e klientëve tanë. Struktura e asetve është diverse, me 47% në kredi ndaj klientëve, kjo e diversifikuar mjaft mirë mes kredive për aktivitete tregtare dhe individë. Në të njëjtën kohë, kemi përmirësuar cilësinë e portofolit kreditor, duke ulur nivelin e NPL-së në 5.8% në dhjetor 2022 nga 6.8% në vitin 2021.

Procesi i transformimit të plotë të Degëve, shoqëruar me investime në përmirësimin e rrjetit të Degëve dhe punën e vazhdueshme për automatizimin dhe eficientësinë e proceseve tona të brendshme për të përmirësuar shërbimin ndaj klientëve, dha dukshëm rezultate pozitive në vitin 2022 duke shënuar një rritje të bazës së klientëve prej 11.7%.

Ne do të vazhdojmë të kemi në fokus rritjen e digjitalizimit dhe shtimin e flotës së ATM-ve tona. Gjithashtu, do të vijojmë investimet në teknologjitë e identifikimit dhe nënshkrimit elektronik në distancë duke mundësuar rritje të numrit të shërbimeve që klienti mund t'i marrë pa qenë nevoja për t'u paraqitur në bankë.

Për Union Bank viti 2022 ishte një vit i mirë, me tregues veçanërisht të lartë të marxhit neto nga interesat dhe kthimi i kapitalit, i cili u arrit 11% (ROE) me gjithë sfidat e vështira të vitit. Ne vazhduam rrugëtimin tonë të zhvillimit duke përmirësuar infrastrukturën e bankës dhe duke ofruar shërbime të shumta dhe inovative për të plotësuar nevojat e klientëve tanë. Përsa i përket rrezikut kibernetik në vend vitin që lamë pas, ne rritëm vigjilencën ndaj sistemeve mbrojtëse dhe parandaluese dhe arritëm të mbajmë situatën nën kontroll, pa incidente. Ne do të vazhdojmë të investojmë në mbrojtje dhe prokurim të shërbimeve profesionale shtesë në trajtimin e rrezikut kibernetik.

Në emër të Këshillit Drejtues të Union Bank, dëshiroj të përcjell një falënderim për të gjithë ju klientët tanë për besimin dhe mbështetjen që na jepni. Ju ftoj të vazhdoni të na besoni dhe të na përdorni si bankën tuaj të zgjedhur. Ne do të vazhdojmë të punojmë me këmbëngulje dhe përkushtim për të arritur qëllimet tuaja financiare. Mirënjohje e thellë shkon dhe për punonjësit tanë, puna e palodhur dhe përkushtimi i të cilëve e bëjnë bankën tonë të ndërtojë besim më klientët dhe të shijojë sukseset e mëtejshme.



**Flutura Veipi**

Drejtoresh e Përgjithshme Ekzekutive

**Viti 2022 është një tjetër vit suksesi në aktivitetin e Union Bank në treg.**

Union Bank mbylli vitin 2022 me shumë suksese dhe sfida njëkohësisht. U përballëm me një vit tjetër pasigurie në treg dhe në sistemin bankar, ku pas pandemisë u përballëm me inflacionin e sjellë prej saj por edhe prej luftës në Ukrainë, që shtoi pasiguritë në treg tek popullsia dhe klientët tanë. Duke operuar në një ambient të tillë, sfida kryesore ishte: kreditimi ndaj ekonomisë në 6 mujorin e parë të vitit, i cili pati një kërkesë për kredi përtej parashikimeve, që solli dhe rritjen e portofolit me 11.5% në këtë periudhë, krahasuar me 16.3% që ishte rritja vjetore.

Shumë e mirëpritur si rritje, pasi ishte një nevojë e ndikuar nga situata që përqëndronte në një periudhë disa mujore, blerje shpesh të planifikuara për gjithë vitin për shumë aktivitete që duhet të mbroheshin si nga rritja e çmimeve por dhe ndonjë bllokim kanalesh furnizimi si pasojë e inflacionit dhe luftës. Rritja e kreditimit mbi planin kërkoi jo vetëm riorganizim, por një kujdes në manaxhimin e likuiditetit dhe në cilësinë e kreditimit, të cilat i kaluam të dyja me sukses. Viti 2022 ishte një viti suksesi por dhe mësimi nga një vit i veçantë në ekonomi dhe shoqëri.

Në vitin 2022 depozitat burimi ynë kryesor i fondeve, patën një rritje me 8.8% duke e bërë 2022 një vit suksesi edhe pse që një vit i vështirë për kursimet apo për likuiditetin në valutën vendase. Ritmi i ulët i rritjes së depozitave në linjë për të mbështetur kredinë, i shkaktuar kryesisht prej rritjes së shpenzimeve në të gjitha segmentet konsumatore në ekonomi, solli që një pjesë e investimeve në Tituj të Qeverisë Shqiptare të tjetërsoheshin në mbështetje të kreditimit. Në këtë mënyrë dëshmuam edhe njëherë fokusin e vazhdueshëm ndaj klientëve tanë për të qenë gjithmonë pranë tyre dhe për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e tyre. Strategjia jonë afatgjatë në lidhje me raportin kredi/fonde klientësh me një mesatare 60% deri më tani ka rezultuar e suksesshme duke patur një rritje të qëndrueshme që balancon dhe vite dinamike si 2022.

Më tej, vijuan të rrisim bazën e klientëve me 11.7% në vitin 2022 dhe ky do të jetë fokusi ynë edhe për vitin 2023. Veçanërisht, fokusi do të jetë edhe në uljen e numrit të klientëve që largohen, një fenomen ky i ndikuar nga elemente demografike por dhe nga ndryshimet në treg. Pa dyshim, që këtë do ta arrijmë nëpërmjet punës sonë shumë dimensionale, duke ofruar transparencë, komunikim dhe një shërbim cilësor për klientët tanë, që ata të kenë komoditet dhe akses 24/7 në produktet dhe shërbimet bankare që ne ofrojmë.

Investimet në platformën digjitale UB online, bënë që transaksionet në këtë platformë të rriten në 60%. Vlen të përmendet që në Dhjetor 2022, 57% e transaksioneve financiare<sup>3</sup> janë kryer në platformën online, nga 38% e klientëve të bankës me akses në këtë platformë. Në ditët e sotme klientët e sidomos brezi i ri janë gjithnjë e më kërkues për shërbime bankare digjitale dhe kryerjen e transaksioneve bankare online apo në kanale alternative. Dhe ne u përgjigjemi në çdo kohë me shërbimet në platformën digjitale UB Online, me rritjen tonë të ATM-ve në të gjithë Shqipërinë si dhe me Qendrën tonë të Kontaktit në dispozicion 24/7.

Në këtë linjë do të vijojmë edhe në vitin 2023, ku shtyva vjen edhe nga ndryshimet rregullatore, që me rishikimin e ligjeve i kane hapur rrugën regjistrimit të klientit në bankë për herë të parë pa qenë nevoja për prezencën e tij fizike. Ky është një nga projektet kryesore që do të fillojë në Union Bank gjatë vitit 2023.

Në vitin 2023 ATM-të dhe POS-et tona mund të pranojnë dhe kartat VISA duke sjellë diversifikim të shërbimeve që ne ofrojmë. Numri transaksioneve në ATM zuri 55% të transaksioneve totale, shifër kjo që synojmë ta rrisim në 70% në vitin 2023. Për të realizuar këtë synojmë shtimin e flotës së ATM-ve për depozitim dhe tërheqje në çdo degë.

Objektivi ynë për vitin 2023 është rritja jo vetëm në asete por dhe një përmirësim cilësor në çdo aspekt të punës. Synojmë të sjellim risi në produkte dhe shërbime për klientët tanë, rritje të automatizimit në operacionet tona, duke sjellë Automatizim Robotik të Proceseve (RPA)<sup>4</sup> në ri-hartimin e tyre, apo dhe ndjekje procesesh në sisteme duke lënë gjurmë të hapave, që sjellin analiza dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Objektivat tanë synojnë rritjen e peshës së Union Bank në treg, jo vetëm për klientët tanë, por edhe si një faktor të rëndësishëm për sistemin dhe tregun. Fokusi ynë për 2023 është rritja e stabilitetit të kthyeshmërisë nga kapitali me mbi 12% dhe me 15% në tre vitet e ardhshme duke synuar cilësinë e aktivitetit tonë bankar.

Viti 2023 kemi besim që do të sjellë një zhvillim cilësor në proceset tona, në përmirësimin dhe optimizimin e tyre si dhe në funksionimin e strukturës. Nisja e shumë projekteve të reja do të sjellin risi në modelin e biznesit të bankës. Ky synim mbetet primar; sjellja e risive është përgjegjësi ndaj të gjithë aktorëve me të cilët operojmë, klientëve, aksionerëve, punonjësve si edhe ndaj vetë institucionit si pjesë e sektorit financiar në vend. Me premtimin për një bankë të konsoliduar, dhe në përmirësim të vazhdueshëm duke investuar në cilësi dhe siguri, një falënderim i veçantë shkon për punonjësit tanë që nuk stepen para sfidave, por janë të hapur për përgjegjësi dhe ndryshim.

<sup>3</sup> Transaksione financiare janë ato të inicluara nga klienti, duke përfshirë veprimet me monedhat në depozitim dhe tërheqje  
<sup>4</sup> RPA- Robotic Process Automation



#### 4.1 HISTORIKU I UNION BANK

- Union Bank është licensuar nga Banka e Shqipërisë në vitin 2005 dhe në janar të vitit 2006 hapi dyert për herë të parë. Union Bank është regjistruar si shoqëri aksionare, e cila ofron shërbime të shumëllojshme bankare, kryesisht për individë dhe kompani në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu nga viti 2014, Union Bank zotëron 100% të aksioneve të kompanisë së leasing Landeslease, e cila operon në Shqipëri që nga viti 2005.
- Në vitin 2006 banka e nisi aktivitetin e saj me hapjen e 7 degëve në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fushë Krujë dhe Fier, duke ofruar një shërbim të plotë për depozita, kredi dhe shërbime pagesash. Më tej, rrjeti i degëve u zgjerua edhe në Kukës, Berat, Korçë, Shkodër, Pogradec, Lezhë, Lushnjë, Laç dhe Rrogozhinë. Gjithashtu Union Bank plotësoi gamën e produkteve dhe shërbimeve bankare me prezantimin në treg të kartës së debitit Maestro dhe kartës së kreditit Mastercard, si dhe të shërbimit e-banking UB Online.
- Në vitin 2009, rrjeti i degëve të Union Bank arriti në 30 degë dhe 39 ATM. Ky ishte edhe viti i parë, në të cilin banka realizoi fitim vjetor. Më tej, në përgjigje të rritjes së Bankës në madhësi dhe kompleksitet, si dhe për t'i dhënë fokus ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Union Bank nënshkroi në vitin 2011 marrëveshjen me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për një linjë kredie në mbështetjeve të SME-ve.
- Gjithashtu, me objektivin për të zgjeruar aktivitetin e saj dhe diversifikuar portofolin, në vitin 2014, Union Bank bleu 100% të aksioneve të Landeslease sha, një kompani leasing.
- Në vitin 2017, Union Bank renditet ndër gjashtë bankat e para për rritjen e portofolit të kredive dhe ndër tre me performancën më të mirë në vend për rritjen e fondeve. Po këtë vit, Banka merr nga BERZH një linjë financimi 5 milionë Euro për Programin e Nxitjes së Tregtisë.
- Viti 2018 shënon firmosjen nga Union Bank të marrëveshjes për blerjen e 100% të aksioneve të Bankës Ndërkombëtare Tregtare (ICB). Banka vazhdoi me rritje vjetore dyshifrore të asetëve dhe në kthim kapitali. Gjithashtu, po këtë vit Union Bank firmosi me BERZH një marrëveshje për një linjë kredie, në mbështetje të zbatimit të Projektit Green Economy Financing Facility (GEFF) në Shqipëri.
- Union Bank përfundoi me sukses blerjen dhe përthithjen e Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. (ICB) në vitin 2019. Me këtë përthithje pjesa e tregut për asetet mbërriti në rreth 5%. Aktivitetet totale të Bankës kalojnë 540 milionë Euro, me një kthim kapitali prej mbi 15.3%. Rrjeti i degëve të Bankës në këtë vit u shtua me 3 njësi të reja. Në muajin gusht 2019 filloi implementimi i upgrade të platformës digjitale UB Online.
- Në vitin 2019 Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) nënshkroi marrëveshjen dalëse si aksionere e Union Bank, e cila u kompletua në dhjetor 2021.

## 4.2 AKSIONARËT E BANKËS

Aksionarët e Union Bank dhe njëkohësisht mbështetësit kryesorë të aktivitetit të Bankës, janë një institucion financiar dhe disa sipërmarrës të suksesshëm.

Struktura e kapitalit të nënshkruar është si më poshtë:

Struktura e kapitalit	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Unioni Financiar Tiranë Sh.a (UFT)	96.46%	96.46%
Edmond Leka	1.77%	1.77%
Niko Leka	1.77%	1.77%

Më poshtë paraqiten lëvizjet në kapitalin e paguar në vitet 2022 dhe 2021. Në datë 27 Korrik 2022 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve miratoi zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Bankës, nëpërmjet fitimeve të akumuluar, me një shumë prej 10 Milionë Euro (kundravlehtë 1,166,000 Mijë Lekë).

	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Nr. i aksioneve	Vlera e aksioneve	Nr. i aksioneve	Vlera e aksioneve
Gjendja në fillim të vitit	2,097,143	2,717,813	2,097,143	2,717,813
Rritja e kapitalit gjatë vitit	-	1,166,000	-	-
Kapitali i paguar	2,097,143	3,883,813	2,097,143	2,717,813

Kapitali i paguar përbëhet nga aksione të zakonshme dhe nuk ka asnjë kufizim mbi to apo dallim ndërmjet tyre.

### UNIONI FINANCIAR TIRANË (UFT)

Unioni Financiar Tiranë (UFT ose "Kompania Mëmë") është aksionari kryesor i Union Bank dhe është institucioni financiar jobankar më i suksesshëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor. UFT përfaqëson Western Union në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Kroaci dhe Zvicër. UFT është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC që nga viti 1995, i cili ushtron veprimtarinë e transfertave të parave si dhe ndërmjetësimit e arkëtimit dhe pagesave të ndryshme, atë të këmbimit valutor, atë të agjentit apo këshillimit financiar, të konsulencës në fushën e biznesit dhe të administrimit, të emetimit të parasë elektronike.

"UFT" është një kompani me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS J62424002G, regjistruar në bazë të vendimit të Gjykatës Tiranë No. 9406, datë 6 Mars 1995. UFT është një institucion financiar që ushtron aktivitetin në Shqipëri dhe autoriteti mbikëqyrës i kësaj veprimtarie është Banka e Shqipërisë. Selia e UFT-së është në Rrugën "Ismail Qemali", Nr. 32, Kati 3, Tiranë. Kapitali i UFT-së është 60 milionë Lekë.

	31 dhjetor 2021	Aksione me të drejtë vote	Aksione pa të drejtë vote
Edmond Leka	35%	35%	
Niko Leka	35%	35%	
Gjergji Misha	10%		10%
Varuzhan Piranjani	10%	10%	
Eduard Shima	10%		10%

### EDMOND LEKA

Z. Leka ka një eksperiencë të gjatë në aktivitete të ndryshme financiare. Ai është President dhe Drejtor i Përgjithshëm i Unionit Financiar Tiranë (UFT) që nga marsi i vitit 1995 dhe nga viti 2006 është Kryetar i Këshillit Drejtues të Union Bank. Gjatë periudhës shtator 2000-2008 z. Leka ka qenë Zëvendëspresident i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri dhe më parë Kryetar i Bordit të AMC-së (Albanian Mobile Communication). Ai ka qenë gjithashtu Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Bankës Italo-Shqiptare nga marsi 1996 – shkurt 2002 dhe Kryetar i Bordit të Fondacionit për Shoqëri të Hapur në Shqipëri (Fondacioni Soros) nga janari 2002 deri në mars 2005.

## 4.2 AKSIONARËT E BANKËS

### NIKO LEKA

Z. Leka ka një eksperiencë të gjatë dhe solide në sektorin financiar, në menaxhim si dhe në aktivitetet e biznesit. Aktualisht ai është Drejtor Ekzekutiv i Unionit Financiar Tiranë (UFT) nga viti 2014 deri në 2017 ka mbajtur pozicionin e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të Landeslease. Më parë z. Leka ka punuar si konsulent dhe anëtar i disa organizatave të ndryshme financiare dhe menaxhuese. Gjatë periudhës 1994-1995, z. Leka ka qenë Drejtor i Departamentit të Kreditit Urban (institucion mikrofinancë) në Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe gjatë periudhës 1999-2002 ka qenë Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Fondit Besa (institucion financiar i mikrokredisë). Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Fondit Besa (institucion financiar i mikrokredisë).

### Informacion i përgjithshëm mbi Grupin Bankar

Në strukturën e Grupit Bankar UFT janë në përbërje këto kompani të renditura më poshte:

#### Unioni Financiar Prishtinë Shpk ("UFP")

UFP është një kompani me përgjegjësi të kufizuar që operon në Kosovë. NUIS i saj është NRB80073291. Ajo është përfaqësuese kontraktuale e Western Union Financial Services INC në Kosovë dhe ushtron aktivitetin që nga 1 janari 2004. UFP është një institucion financiar që ushtron aktivitetin e transfertave të parave dhe është nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Kosovës.

Selia e UFP është në Rr. Perandori Justinian IE, Qyteza Pejton, Prishtinë, Kosovë.

#### Unija Finansiska Skopje Doo ("UFS")

UFS është një kompani me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Republikën e Maqedonisë me vendim të Gjykatës së Shkupit Nr. 5710/03, datë 16 janar 2004. NUIS i saj është NIT4030004498497 dhe është përfaqësuese kontraktuale e Western Union Financial Services INC në Maqedoninë e Veriut. Ajo ushtron aktivitetin e transfertave të parave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe autoriteti mbikëqyrës i kësaj veprimtarie është Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut.

Selia e UFS është në Rr. Goce Dellcevi, Shkup, Maqedoni e Veriut.

#### Union of Financial Corners ("UFC")

UFC është një institucion financiar i themeluar në 1 maj 2005 në Gjenevë, Zvicër dhe ka NUIS CHE112 349585. UFC është përfaqësuese kontraktuale e Western Union Financial Services INC në Zvicër dhe ofron shërbimin e transfertave të parasë. Autoriteti mbikëqyrës është ARIF.

Selia e UFC është në Gjenevë, Zvicër.

#### Paylink Sha ("Paylink")

Paylink është një kompani financiare e licensuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer shërbimet e procesimit të kartave si dhe shërbimeve të tjera lidhur me to. NUIS i saj është L22112003M dhe ka filluar aktivitetin në Shtator 2012. Selia e Paylink sha është në Autostradën Tiranë-Durrës, km 8, Tiranë.

#### Auto City Sha ("Auto city")

Investimi në Auto City është bërë në 26 Dhjetor 2012. Auto City është një kompani që nuk operon në sektorin financiar dhe ka NUIS K81918006B. Selia e Auto City është në autostradën Tiranë-Durrës, km 6, Tiranë. Kjo kompani ofron shërbime për utilitete si dhe ekspozim, ambiente me qira, etj.

#### Union Net Kroaci ("UUK")

UUK është një institucion financiar i themeluar në 10 Mars 2016 në Zagreb, Kroaci dhe ka NUIS HR74536886827. UUK është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC në Kroaci dhe ofron shërbimin e transfertave të parasë. Autoriteti mbikëqyrës është HANFA.

### Informacion mbi filialet e Bankës

Në 22 dhjetor 2014 Union Bank bleu 100% të aksioneve të Landeslease Sh.a. dhe është aksionari i vetëm i këtij institucioni financiar. Investimi në Filiale në fund të Dhjetorit 2022 është në shumën prej 161,002 Mijë Lekë.

Më 31 dhjetor 2022 kapitali aksionar i filialit, i nënshkruar dhe i shlyer tërësisht, është 175,653 Mijë Lekë që përbëhet nga 175,653 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) aksione me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë secili. Banka ka akorduar në total kredi për shumën 18.8 Milionë Euro Filialit, duke respektuar limitet rregullatore dhe të brendshme për këtë ekspozim.

Landeslease Sh.a është një shoqëri anonime me NUIS K51629002M. Ai ushtron aktivitetin në Shqipëri dhe është nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Selia e Landeslease është në Rrugën "Mine Peza", Nd. 8, Nj. Ap.9, Tiranë.

# ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Të drejtat e aksionarëve për çështjet e lidhura me aktivitetin e bankës ushtrohen nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve i cili është organi suprem vendimarrës i bankës.

Asambleja e Përgjithshme miraton vendime për përcaktimin e politikave tregtare, emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të Komitetit të Kontrollit, emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuidatorit/ëve, përcaktimin e shpërblimeve të personave të përmendur më sipër, miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, përfaqësimin e Bankës në gjykatë, revokimin apo ndryshimin e Politikave kundër Pastrimit të Parave apo procedurave të ruajtjes së mjedisit, si dhe çdo çështje tjetër që përcaktohet nga ligji.

## KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues i Union Bank është një organ vendimarrës, i cili vendos objektivat afatmesëm të bankës, strategjinë dhe politikat e bankës, si dhe mbikëqyr përmbushjen e tyre.

Këshilli Drejtues zgjedh strukturën drejtuese të bankës (Drejtoria Ekzekutive) dhe drejtorët e divizioneve. Këshilli Drejtues mbikëqyr implementimin e politikave të Bankës nga Drejtoria, si dhe ecurinë e aktivitetit të bankës. Këshilli Drejtues është një organ që mbështet Drejtorinë me një rol këshillues. Në ushtrimin e detyrës së tij, Këshilli Drejtues udhëhiqet nga interesi i bankës për të siguruar cilësi në operacione, besim dhe ecuri të qëndrueshme në vite. Për këtë Këshilli Drejtues ka në konsideratë interesat e të gjitha palëve të interesuara në operacionet e bankës.

## 4.3 ORGANET DREJTUESE TË BANKËS

### KËSHILLI DREJTUES



**Edmond LEKA**  
Kryetar i Këshillit Drejtues



**Niko LEKA**  
Zv. Kryetar i Këshillit Drejtues



**Flutura VEPI**  
Drejtoresh e Përgjithshme Ekzekutive  
dhe Anëtare e Këshillit Drejtues



**Varuzhan PIRANJANI**  
Anëtar i Këshillit Drejtues



**Henry Russell**  
Anëtar i Këshillit Drejtues



**Teuta BALETA**  
Anëtare e Këshillit Drejtues



**Gazmend KADRIU**  
Anëtar i Këshillit Drejtues



**Kreshnik Dibra**  
Anëtar i Këshillit Drejtues

# KËSHILLI DREJTUES I UNION BANK

mbledhet periodikisht të paktën në 5 mbledhje kryesore në vit dhe ndërkohë jo më pak se 4 (katër) mbledhje të ndërmjetme midis dy mbledhjeve kryesore në vit për të miratuar: strategjinë e përgjithshme dhe drejtimin e Bankës, për vendime të rëndësishme organizative dhe kreditimi, si dhe për të monitoruar menaxhimin e Bankës. Këshilli shqyrton dhe miraton çdo vit të gjitha politikat dhe procedurat kryesore operacionale të Bankës. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Union Bank kanë të drejtën e votës dhe nuk mund të abstenojnë. Të gjithë vendimet e Këshillit Drejtues të Bankës janë të vlefshme nëse shumica e anëtarëve të Këshillit Drejtues pjesëmarrës në mbledhje voton në favor ose votim me 2/3 për vendimmarrje specifike të rëndësishme.

Anëtarët e Këshillit Drejtues përzgjidhen me kujdesin e duhur në mënyrë që kualifikimet, përvoja dhe ekspertiza individuale të kombinohen në grup, në funksion të përdorimit sa më të mirë të kontributit të secilit në strategjinë dhe aktivitetin vendimmarrës të Bankës.

**Këshilli Drejtues** me qëllim realizimin sa më të plotë të përgjegjësive të tij ka themeluar komitete të përhershme dhe të përkohshme, si Komitetin e Kontrollit, Komitetin e Strategjisë (i përkohshëm) dhe Komitetin e Remunerimit dhe Burimeve Njerëzore.

Komitetet kanë në përbërjen e tyre më pak se 1/2 e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Bankës duke synuar pjesëmarrje edhe të ekspertëve të pavarur.

1. Detyrat kryesore të Komitetit të Kontrollit janë të asistojë Këshillin Drejtues në mbikëqyrjen e:

- Integritetit të raporteve financiare të Bankës,
- Përputhshmërinë e Bankës me ligjet dhe rregulloret në fuqi,
- Procesit të përzgjedhjes dhe të performancës së auditoreve të jashtëm,
- Performancës së njësisë së brendshme të auditit.

Komiteti i Kontrollit i Union Bank përbëhet nga tre anëtarë, nga të cilët njëri është Kryetar.

Anëtarësia në Komitet sipas kërkesave rregullatore është e pavarur, njëri prej tyre nuk është pjesë e Këshillit Drejtues të Bankës, ndërsa Kryetari i Komitetit është edhe anëtar i Këshillit Drejtues. Përbërja e Komitetit të Kontrollit është si në vijim:

Komiteti i Kontrollit

- Teuta Baleta - Kryetar
- Sonila Bicaku - Anëtar
- Varuzhan Piranjan - Anëtar

Në përbërje të Komitetit të Kontrollit është shtuar edhe "anëtari shok", në funksion të plotësisht të profilit profesional dhe planit të vijueshmërisë. Ai është Kreshnik Dibra, njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës.

2. Detyrat kryesore të Komitetit të Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore (KSHBNJ) është të asistojë dhe mbështesë Këshillin Drejtues të Union Bank në përgjegjësitë që Këshilli ka lidhur me çështje të Burimeve Njerëzore, të tilla si:

- Vendosjen dhe rishikimin e politikës së shpërblimeve në Union Bank në fusha si kompensimet dhe përfitimet e punonjësve;
- Politikën dhe procedurat që lidhen me punësimin dhe largimin nga puna të punonjësve në nivele të larta të Bankës;
- Shqyrtimin dhe rishikimin e zhvillimeve të rëndësishme në çështje si Kodi i Sjelljes dhe Struktura Organizative e Bankës;
- Politika që asistojnë në afrimin, mbajtjen, planet e zëvendësimit dhe zhvillimin e punonjësve në Union Bank.

Përbërja e KSHBNJ është si në vijim:

- Edmond Leka - Kryetar
- Teuta Baleta - Anëtar
- Elton Çollaku - Anëtar
- Gazmend Kadriu - Anëtar

3. **Komiteti Strategjik** (i përkohshëm) ka si qëllim që të këshillojë Këshillin Drejtues ose të përgatisë vendimet e tij në lidhje me çështje ose aktivitete që bien nën këtë fushë kryesore të vendimeve strategjike. Të tilla mund të jenë:

- Rishikimi i strategjisë së Bankës;
- Ristrukturim madhor i brendshëm i Bankës;
- Mundësi blerjeje (acquisition);
- Planifikim i hapjes së një filiali; etj.

Përbërja e Komitetit Strategjik është si në vijim:

- Edmond Leka - Kryetar
- Henry Russell - Anëtar
- Flutura Veipi - Anëtar
- Gazmend Kadriu - Anëtar
- Niko Leka - Anëtar

### DREJTORIA EKZEKUTIVE



**Flutura VEIPI**  
Drejtoresh e Përgjithshme Ekzekutive



**Suela BOKSHI**  
Zv. Drejtore e Përgjithshme dhe  
Drejtoresh e Divizionit të Operacioneve

### MENAXHIMI I LARTË



**Arten ZIKAJ**  
Drejtor i Divizionit të Financës



**Enkelelda HASHO**  
Drejtoresh e Divizionit të Shitjeve



**Gent DRITA**  
Drejtor i Divizionit të Kredisë



**Fatbardha Rino**  
Drejtoresh e Divizionit Retail



**Irena Rushaj**  
Drejtoresh e Divizionit IT

# MJEDISI MAKROEKONOMIK DHE SISTEMI BANKAR NË SHQIPËRI



## 5.1 MJEDISI MAKROEKONOMIK I JASHTËM<sup>5</sup>

Rritja e ekonomisë botërore gjatë gjysmës së dytë të vitit u ndikua negativisht nga rritja e ndjeshme e inflacionit në rang botëror, zgjatja e luftës në Ukrainë dhe rikthimi i masave anti Covid në Kinë. Pas një rritjeje të qëndrueshme në tremujorin e tretë, aktiviteti global është ngadalësuar në tremujorin e fundit të vitit. Ngadalësimi erdhi nga dobësimi i kërkesës dhe tregtisë për shkak të inflacionit të lartë dhe shtrëngimit të kushteve të financimit.

Bankat qendrore kanë vijuar me masat për normalizimin e politikës monetare me qëllim frenimin e rritjes së çmimeve. Kushtet e financimit në tregjet botërore mbeten të shtrënguara dhe të luhatshme, ndikuar nga pritjet për rritje të shpejtë të normave të interesit dhe nga pritjet për ngadalësim të ekonomisë botërore.

Faktorët që kanë mbështetur rritjen ekonomike të Eurozonës dhe të rajonit të Ballkanit Perëndimor janë kushtet e qëndrueshme në tregun e punës, paketat e mbështetjes fiskale dhe kërkesa e brendshme, e cila u rigjallërua pas heqjes së masave të pandemisë. Në dobësimin e ritmit të rritjes ekonomike ka ndikuar inflacioni i lartë dhe shtrëngimi i kushteve të financimit.

Vëllimet e kreditimit kanë qenë të larta, por kanë shfaqur shenja ngadalësimi. Cilësia e kredisë ka mbetur në nivele të mira, por pritjet janë për rënien e saj në afatin e mesëm.

Parashikimet afatshkurtra dhe afatmesme të ekspertëve janë për një ngadalësim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2023, të lidhur me shtrëngimin e kushteve të financimit dhe frenimin e konsumit dhe investimeve, si rezultat i dobësimit të fuqisë blerëse. Rritja ekonomike e vendeve të zhvilluara pritet të bjerë në 1.2% gjatë vitit 2023, nga 2.7% në vitin 2022, ndërsa ekonomitë në zhvillim parashikohet të zgjerohen me 4.0% nga 3.9% në 2022. Presionet inflacioniste pritet të zbuten gradualisht gjatë periudhës në vazhdim, në kushtet e shtrëngimit monetar në shkallë globale dhe rënies së çmimeve në tregjet e naftës.

FMN-ja parashikon që inflacioni në shkallë botërore të bjerë mesatarisht në 6.6% në vitin 2023 dhe në 4.3% në vitin 2024, nga 8.8% në vitin 2022, por duke mbetur mbi nivelet e periudhës së parapandemisë. Perspektiva ekonomike afatshkurtër mbetet ende e rrethuar nga një nivel i lartë pasigurie dhe nën presionin e rreziqeve të lidhura me luftën në Ukrainë dhe shtrirjen e pasojave të saj, dinamikat e ardhshme të inflacionit dhe kostove ekonomike të normalizimit të politikës monetare. Rreziqet afatshkurtra ndaj stabilitetit financiar global gjithashtu konsiderohen në rritje, dhe lidhen kryesisht me ndikimin e rritjes së normave të interesit në barrën e borxhit dhe në qëndrueshmërinë financiare të agjentëve të ekonomisë në mbarë botën.

<sup>5</sup> Marrë nga Raporti i Stabilitetit Financiar 6MII2022 Seksioni 1.2


## 5.2 MJEDISI MAKROEKONOMIK NË VEND<sup>6</sup>

Rritja ekonomike në vend ka mbetur në vlera pozitive dhe të qëndrueshme deri në fund të vitit. Zhvillimet ndërkombëtare dhe plotësimi i nevojave për energji përfaqësuan një sfidë për ekonominë vendase gjatë vitit 2022. Përmirësimi i situatës hidrike në hidrocentrale gjatë tremujorit të fundit të vitit kontribuoi në përbalimin e kërkesave të ekonomisë për energji dhe lehtësoi ngarkesën përkatëse për buxhetin. Përbalimi i goditjeve të ngjashme në të ardhmen nxjerr në pah rëndësinë e krijimit të rezervave fiskale në afatin më të shkurtër dhe të reformave për rritjen e kapaciteteve të prodhimit dhe tregtimit të energjisë në afatin e gjatë. Në tregjet financiare, zhvillimi kryesor i periudhës ishte rritje e normave të interesit.

### Sektori real

Norma vjetore e rritjes ekonomike, në tremujorin e katërt të 2022, rezultoi 4.7%; duke mbetur pranë vlerës së mesatares vjetore. Në këtë rritje, shërbimet dhe prodhimi kontribuuan me përkatësisht 2.6 dhe 2.2 p.p.. Rritja ekonomike u mbështet nga konsumi final, investimet e sektorit privat dhe eksportet e mallrave e shërbimeve, ndërsa tkurrja e konsumit të qeverisë dhe zgjerimi i importeve të mallrave e shërbimeve ndikuan në kah të kundërt. Të dhënat e tremujorit të katërt tregojnë që rritja ka ardhur kryesisht nga sektori i ndërtimit dhe nga "informacioni e komunikacioni", që u rritën përkatësisht me rreth 14% në terma vjetorë. Pavarësisht se kanë një peshë më të vogël, kontribut pozitiv në këtë rritje kanë dhënë edhe sektorët e "shërbimeve financiare e të sigurimit" dhe të "pasurive të paluajtshme", që u zgjeruan përkatësisht me 13% dhe 9%. Treguesi i ndjesisë ekonomike sinjalizoi një përmirësim të klimës të lidhur në mënyrë të veçantë me përmirësimin e besimit në sektorët e ndërtimit dhe të industrisë.

GDP (% sipas Tremujorëve 2016-2022)




### Tregu i punës

Zhvillimet në tregun e punës ishin pozitive me rritje të punësimit, rënie të normës së papunësisë dhe rritje të pagave. Norma e papunësisë ra në nivelin 10.8% dhe punësimi u rrit me 4.2% në terma vjetorë, kryesisht si pasojë e rritjes së numrit të të punësuarve në sektorët e shërbimeve dhe të bujqësisë. Shkalla e papunësisë për grup-moshën 30-64 vjeç ra në 7.6%, ose me 1.3 p.p. në krahasim me një vit më parë, ndërkohë që papunësia të rinjtë (15-29 vjeç), ndonëse regjistron një rritje të lehtë prej 0.9 p.p. ndaj një viti më parë, mbetet në shifra të krahasueshme me mesataren e pesëvjeçarit të fundit prej 21.5%. Rritja vjetore e pagave gjatë tremujorit të katërt arriti në 10.8%. Kjo rritje pasqyron rritjen prej 14.2% të pagave në sektorin privat dhe rritjen prej 5.6% të pagës mesatare në sektorin shtetëror. Rritja e pagave në sektorin privat është vërejtur në pothuajse të gjitha degët e prodhimit dhe shërbimeve, por ka qenë më e theksuar në sektorin e shërbimeve.

## Sektori i jashtëm

Flukset hyrëse të valutës në formën e shërbimeve të turizmit, të dërgesave të emigrantëve dhe të investimeve të huaja direkte, shënuan rritje të fortë. Gjatë tremujorit të katërt të vitit, deficitin e llogarisë korrente shënoi vlerën 0.48 miliardë euro, duke u ngushtuar me rreth 12%. Në këtë ecuri, kanë ndikuar pozitivisht rritja e eksportit të mallrave dhe të shërbimeve. Eksportet e mallrave u rritën me rreth 30%, ndërsa ato të shërbimeve me rreth 33%. Tek këto të fundit, eksportet e shërbimeve të turizmit u rritën me rreth 48%. Importet e mallrave dhe të shërbimeve ndikuan negativisht në balancën e llogarisë korrente, duke u rritur me rreth 14.1%. Vetëm importet e mallrave u rritën me 7.7%, ndërsa importet e shërbimeve dhe njëkohësisht importet e shërbimeve të turizmit u rritën me 38%. Në importet e mallrave, rritje të rëndësishme shënuan shpenzimet për "energji e lëndë djegëse", në reflektim të ecurisë së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Ecuria mjaft pozitive të flukseve hyrëse të remitancave tregon për një rritje vjetore me rreth 9%.



## Zhvillimet monetare

Rritja e çmimeve të konsumit, e cila filloi që në mesin e vitit 2021, është përshpejtuar gjatë vitit 2022, duke arritur majën rreth tremujorit të tretë të vitit, në linjë me ecurinë e çmimeve të energjisë dhe të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare.

Gjatë tre muajve të fundit të vitit, inflacioni vjetor u ngadalësua, por çmimet vijuan të mbeten të larta dhe për muajin dhjetor inflacioni vjetor shënoi vlerën 7.4%, duke qenë rreth dy herë më shumë sesa një vit më parë. Kjo ecuri e çmimeve ka reflektuar goditjet nga kahu i ofertës së huaj, të cilat janë transmetuar drejtpërsëdrejti në kostot e prodhimit dhe çmimet e konsumit. Por krahas çmimeve të importit, në inflacionin e çmimeve të konsumit në vend ka ndikuar edhe kërkesa e brendshme, e cila u mbështet në përmirësimin e kushteve të tregut të punës dhe në rritjen e pagave. Zhvillimet në tregun valutor dhe veçanërisht forcimi i lekut ndaj euros, kanë kontribuar në zbutjen e efektit të inflacionit të importuar, duke amortizuar një pjesë të rritjes së çmimeve të huaja. Banka e Shqipërisë vijoi me normalizimin e politikës monetare, që u materializua në një rritje progresive të normës bazë të interesit deri në nivelin 2.75%. Sipas deklaratave të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, normalizimi i politikës monetare po krijon kushte të përshtatshme për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda horizontit afatmesëm, pa cenuar premisat e rritjes ekonomike.

## Zhvillimet fiskale

Gjatë periudhës, politika fiskale ka qenë në tërësi konsoliduese, me përjashtim të tremujorit të fundit të vitit ku u përqendrua realizimi i shpenzimeve publike të planifikuara. Të gjithë treguesit e qëndrueshmërisë fiskale si deficitin buxhetor dhe borxhi i brendshëm dhe i jashtëm publik, në raport me PBB-në kanë shfaqur një prirje rënëse gjatë vitit 2022. Në fund të dhjetorit 2022, balanca buxhetore regjistroi një deficit prej rreth 78 miliardë lekësh kundrejt një deficitit prej 86 miliardë lekësh një vit më parë. Ngushtimi i deficitit fiskal në terma vjetorë ka ardhur për shkak të rritjes së të ardhurave. Rritja vjetore prej rreth 60 miliardë lekësh, ose me 12% në të ardhurat në buxhetin e shtetit, lidhet kryesisht me rritjen e konsiderueshme në të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të cilat u ndikuan nga dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Nga ana tjetër, shpenzimet u rritën me rreth 55 miliardë lekë ose me 9%, dhe u orientuan drejt shpenzimeve korrente të përqendruara në shpenzime për fondet speciale dhe ato për paga. Një pjesë e shpenzimeve buxhetore janë përdorur për të ndihmuar shtresat më të ndjeshme nga rritja e çmimeve të konsumit dhe të energjisë.

## 5.3 SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI

### Zhvillimet kryesore në sektorin bankar

Sistemi financiar vijon të dominohet nga sektori bankar që ka 91% të totalit të aktiveve të sistemit. Peshë e aktiveve të sistemit financiar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) është në nivelin 96.8%.

Aktivitetet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 6% në krahasim me një vit më parë. Në fakt, mbiçmimi i lekut gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, ka bërë që efekti statistikor i kursit të këmbimit në vlerën e raportuar të bilancit valutë të sektorit bankar të ishte negativ (rreth -33 mld lekë).

Sektori bankar ka zhvilluar normalisht funksionet kryesore të veprimtarisë dhe ka mbështetur ekonominë me financim. Vlera e raportuar e aktiveve u rrit me 103 miliardë lekë gjatë vitit duke arritur në rreth 1,880 miliardë lekë. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve e kanë dhënë zgjerimi i investimeve në tituj me rreth 35 miliardë lekë dhe i aktivitetit kreditues me rreth 45 miliardë lekë.

Peshë e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të bilancit, luhatet rreth vlerave respektive 53% dhe 51%, dhe kjo strukturë është paraqitur e qëndrueshme gjatë periudhës. Në krahun e aktivitetit, përdorimi i valutës është më i lartë tek kredia dhe investimet ndërbankare. Në krahun e detyrimeve, përdorimi i valutës është më i lartë tek depozitat. Prania e ndjeshme e aktivitetit në valutë, bën që treguesit në valutë të shprehur në monedhën vendase të ndikohen nga ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj euros apo valutave të tjera kryesore. Gjatë vitit 2022, ky efekt ka qenë pakësues dhe i ndjeshëm.

Depozitat dhe fondet e veta vijojnë të përbëjnë burimet kryesore të financimit të veprimtarisë së sektorit bankar, me 92% të totalit të pasivit dhe kjo strukturë ka qenë e qëndrueshme gjatë periudhës. Varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbetet e ulët dhe ka rënë më tej gjatë vitit, si pasojë e rënies së detyrimeve të bankave në formën e huave ndaj jorezidentëve.

Aktivitetet e vendosura pranë subjekteve jorezidente shënuan rritje gjatë periudhës për shkak të zgjerimit të investimeve në tituj dhe rritjes së vendosjeve në formën e llogarive rrjedhëse me bankat dhe institucionet financiare. Në fund të periudhës, pretendimet ndaj jorezidentëve ishin sa 21% e totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet ndaj jorezidentëve zinin vetëm 3% të totalit të bilancit.

Indeksi i shëndetit bankar mori vlerën 0.415 dhe tregon për një gjendje të mirë financiare të sektorit bankar në fund të vitit 2022. Në tërësi, gjatë viteve 2014-2022, indeksi i agreguar i shëndetit bankar flet për përmirësim të shëndetit dhe rritje të qëndrueshmërisë së sektorit bankar. Ky përmirësim lidhet në mënyrë të veçantë me përmirësimin e cilësisë së aktiveve dhe të niveleve të likuiditetit dhe kapitalit.

### Kredia

Teprica e kredisë në fund të periudhës, arriti në 715 miliardë lekë, duke qenë përkatësisht 6.6% më e lartë se një vit më parë. Duke përjashtuar efektin statistikor të kursit të këmbimit, që ishte negativ për 17.4 miliardë lekë, ndryshimi vjetor i kredisë në valutë do të ishte 12.2%. Portofolet e kredisë me kontributin më të madh në rritjen e tepricës totale ishin ai i kredisë afatgjatë, kredisë për individët dhe kredisë në valutë. Kredia për individë është zgjeruar me ritme më të shpejta dhe ndryshimi vjetor në fund të 2022 arriti në 11.9% ndërsa kredia për biznese u rrit më pak me 4.3%. Kredia në lekë u zgjerua me 5.9%, ndërsa ajo në valutë me 7.1%.

Ndikimin kryesor në zgjerimin e stokut të kredisë gjatë periudhës e ka dhënë shtesa nga kredia e re, e cila gjatë periudhës ishte rreth 280 miliardë lekë. Kredia e re dhënë për individët është 2% më e lartë në krahasim me një vit më parë ndërsa kredia e re e dhënë për bizneset është rreth 12% më e ulët. Rritjen më të shpejtë dhe kontributin më të madh në ecurinë e kredisë për individët e ka pasur kredia për blerje pasurish të paluajtshme (hipotekare), e cila u zgjerua me 14.2% gjatë vitit; dhe me një peshë prej rreth 70%, ajo zë peshën dërrmuese në portofolin e kredisë bankare për individët. Në rritjen e kredisë për bizneset rezidente, kontributin kryesor e ka dhënë zgjerimi i stokut të kredive për qëllime afatshkurtra (kredi-kufi dhe kapital qarkullues) të cilat u rritën me 8.1% gjatë vitit, e që përbëjnë 84% të rritjes vjetore.

## 5.3 SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI<sup>7</sup>

Kredia për jorezidentët, e akorduar kryesisht për biznese, ishte rreth 30 miliardë lekë në fund të vitit dhe zinte rreth 4% të tepcës së kredisë së sektorit bankar.

### Depozitat

Gjatë periudhës depozitat u zgjeruan me rreth 90 miliardë lekë dhe në fund të vitit shënonin 1,520 miliardë lekë. Ritmi i rritjes së depozitave është ngadalësuar, dhe për vitin 2022 tregon 5.9% nga 11.5% që ishte për vitin 2021. Kontributin më të madh në këtë rritje e ka dhënë zgjerimi i depozitave në valutë. Depozitat me afat kanë vijuar të rriten që prej tremujorit të dytë të vitit 2021, duke u zgjeruar më dukshëm gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022.

Struktura e depozitave sipas afatit dhe sektorit nuk paraqet ndryshime të ndjeshme përgjatë vitit të fundit, por struktura e depozitave sipas monedhës ka ndryshuar lehtë në favor të depozitave në valutë. Në fund të vitit 2022, këto të fundit zinin 54% të totalit të depozitave, nga 52% një vit më parë. Depozitat në valutë u rritën me 10.1% në terma vjetorë. Rreth 90% e depozitave në valutë përbëhet nga depozitat në monedhën euro. Gjatë vitit 2022, këto depozita janë shtuar me rreth 1 miliardë euro.

Një veçori e viteve paraardhëse ka qenë roli i rëndësishëm i llogarive rrjedhëse dhe i depozitave pa afat në zgjerimin e bazës së përgjithshme të depozitave, ndërkohë që ndryshimet në depozitat me afat, që zënë rreth 43% të totalit të depozitave, ishin më pak të rëndësishme dhe përgjithësisht me efekt pakësues. Gjatë gjithë vitit 2022, depozitat me afat janë bërë një kontribues i rëndësishëm në rritjen e depozitave të sektorit bankar duke u rritur me rreth 4%, pas llogarive rrjedhëse të cilat u rritën me rreth 11%. Rritja në këtë kategori ka ardhur tërësisht si rrjedhojë e rritjes së depozitave me afat në valutë për biznese dhe individë, ndërkohë që depozitat me afat në lekë u pakësuan.

Rritja e normave të interesit për depozitat e reja me afat në lekë dhe valutë duket se e ka bërë më atraktive për publikun investimin e kursimeve në depozita bankare. Normat e interesit për të gjitha llojet e depozitave të reja sipas afatit, sektorit dhe monedhës, mbeten në nivele të ulëta, por kanë shfaqur një prirje të dukshme në rritje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022. Në fund të periudhës, norma mesatare e depozitave me afat për individët në monedhën lek ishte 1.4%, nga 0.7% një vit më parë, dhe norma mesatare e depozitave me afat për individët në monedhën euro ishte 0.7%, nga 0.2% në fund të vitit 2021.

### Rezultati financiar

Rezultati i akumuluar neto financiar i sektorit bankar në fund të vitit 2022 shënoi fitim prej 21.7 miliardë lekësh, duke mbetur i pandryshuar nga një vit më parë. Qëndrueshmëria në rezultatin financiar të sektorit bankar është pasqyruar në qëndrueshmërinë e treguesve të përfitueshmërisë së sektorit bankar RoA dhe RoE, të cilët shënuan përkatësisht 1.2% dhe 12.3% nga 1.3% dhe 12.9% një vit më parë.

Sektori bankar ka regjistruar rritje të konsiderueshme në të ardhurat neto nga interesat, por kjo rritje është neutralizuar nga humbjet nga instrumentet financiare dhe rritja e shpenzimeve të veprimtarisë. Shpenzimet për provigjionimin e kredive u rritën me 3.2 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet për provigjionimin e mjeteve të tjera financiare u kthyen në rimarrje, duke zbutur në një masë të konsiderueshme efektin negativ të shpenzimeve totale për provigjione (neto) në rezultatin financiar të sektorit. Të ardhurat neto nga interesat vijojnë të përfaqësojnë zërin kryesor të të ardhurave dhe shpenzimet jo për interesa mbeten zëri kryesor i shpenzimeve. Të ardhurat nga komisionet vijojnë të mbeten të qëndrueshme dhe janë kthyer në një burim të rëndësishëm të ardhurash për sektorin bankar gjatë viteve të fundit. Aktiviteti i ndërmjetësimit financiar, i pasqyruar në ecurinë e të ardhurave neto nga interesat, regjistroi rritje, duke ruajtur prirjen e regjistruar edhe gjatë viteve 2020-2021. Rritja e rezultatit neto nga interesat për aktivitetin në valutë ishte rreth dy herë më e lartë në krahasim me rritjen në të ardhurat nga aktiviteti në lekë. Në këtë zhvillim ka ndikuar kryesisht rritja në të ardhurat nga interesat, pasi shpenzimet për interesa deri në fund të vitit ishin disi më të larta në krahasim me shpenzimet e raportuara një vit më parë.

Në vlerë, rezultati neto nga interesat rezultoi 52 miliardë lekë, ose 13% më i lartë se një vit më parë. Të ardhurat nga interesat e arkëtuara nga klientët ishin rreth 9.3% më shumë nga një vit më parë dhe arritën në rreth 35 miliardë lekë, ndërkohë që interesat e arkëtuara nga investimet në letrat me vlerë kapën një vlerë prej 24 miliardë lekësh, duke qenë gjithashtu rreth 17.3% më të larta në krahasim me të ardhurat e raportuara një vit më parë. Rritja e të ardhurave nga interesi u pasqyrua edhe në rritjen e marzhit neto nga interesat, i cili arriti në 3.5% nga 3.3% një vit

<sup>7</sup> Marrë nga Raporti i Stabilitetit Financiar 6MII2022 Seksioni 1.3

## 5.3 SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI

më parë. Rritja në marzhin neto nga interesat pasqyron rritjen më të lartë në të ardhurat nga interesat, në krahasim me rritjen vjetore prej 4% në nivelin e aktiveve mesatare që sjellin të ardhura.

Të ardhurat jo nga interesat të mbledhura nga bankat gjatë periudhës ranë në 12 miliardë lekë nga 16 miliardë lekë, pasi sektori raportoi një humbje prej 4.1 miliardë lekësh nga instrumentet financiare. Në të njëjtën kohë, shpenzimet e veprimtarisë u rritën lehtë në rreth 38.5 miliardë lekë. Kostot e veprimtarisë vijojnë të mbulojnë në mënyrë të përshtatshme nga të ardhurat e bankave. Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave mbeti i pandryshuar gjatë periudhës, në 60%, pasi rritjet e shpenzimeve të veprimtarisë dhe e të ardhurave totale kanë pasur ritme të ngjashme.

Shpenzimet për provigjione për kredi gjatë 2022 u rritën ndjeshëm kundrejt një viti më parë, nga 0.8 në 4.1 mld lekë. Në të njëjtën kohë, sektori bankar raportoi rimarrje të shpenzimeve për provigjionimin e mjeteve të tjera financiare, në vlerën e 2.6 miliardë lekëve, çka e zbuti në një masë të konsiderueshme efektin total neto të shpenzimeve për provigjione në fitimin e sektorit.

### Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit bankar për vitet 2019-2021 (mld Lekë)<sup>8</sup>

Kodi	Përshkrimi i treguesit	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Y' 21 # ne %	Y' 21 # ne %
1	Të ardhura nga interesi	50,414	53,334	60,789	5.8%	14.0%
2	Shpenzime interesi	7,623	7,363	8,775	-3.4%	19.2%
<b>3</b>	<b>Të ardhurat neto nga interesi (1-2)</b>	<b>42,790</b>	<b>45,971</b>	<b>52,014</b>	<b>7.4%</b>	<b>13.1%</b>
<b>4</b>	<b>Të ardhura jo nga interesi</b>	<b>14,967</b>	<b>16,184</b>	<b>11,815</b>	<b>8.1%</b>	<b>-27.0%</b>
4.1	Gjoha dhe komisione të arkëtueshme	10,869	13,358	14,953	22.9%	11.9%
4.2	Humbjet ose fitimet nga instrumentat financiarë	2,654	1,151	-4,098	-56.6%	-456.0%
4.3	Fitimi nga pjesëmarrjet në shoqëri të lidhura	14	263	323	1778.6%	22.8%
4.4	Të ardhura të tjera	1,430	1,412	638	-1.3%	-54.8%
<b>5</b>	<b>Të ardhurat bruto (3+4)</b>	<b>57,758</b>	<b>62,155</b>	<b>63,829</b>	<b>7.6%</b>	<b>2.7%</b>
<b>6</b>	<b>Shpenzime jo interesi</b>	<b>33,923</b>	<b>37,450</b>	<b>38,535</b>	<b>10.4%</b>	<b>2.9%</b>
6.1	Shpenzime për personelin	11,469	12,239	13,009	6.7%	6.3%
6.2	Shpenzime të tjera	22,453	25,211	25,526	12.3%	1.2%
<b>7</b>	<b>Provigjonet (neto)</b>	<b>5,404</b>	<b>1,218</b>	<b>1,500</b>	<b>-77.5%</b>	<b>23.2%</b>
7.1	Provigjonet për kreditë e humbura	7,245	841	4,091	-88.4%	386.4%
7.2	Provigjonet për mjete të tjera financiare	-1,842	377	-2,591	-120.5%	-787.3%
<b>8</b>	<b>Të ardhurat neto (përpara zërave të jashtëzakonshëm) (5-(6+7))</b>	<b>18,432</b>	<b>23,488</b>	<b>23,794</b>	<b>27.4%</b>	<b>1.3%</b>
<b>9</b>	<b>Zëra të jashtëzakonshëm</b>	<b>-1,249</b>	<b>-1,562</b>	<b>-1,357</b>	<b>25.1%</b>	<b>-13.1%</b>
<b>10</b>	<b>Taksat mbi të ardhurat</b>	<b>2,806</b>	<b>3,415</b>	<b>3,474</b>	<b>21.7%</b>	<b>1.7%</b>
<b>11</b>	<b>Të ardhurat neto (pas zërave të jashtëzakonshëm) (8-(9+10))</b>	<b>16,875</b>	<b>21,634</b>	<b>21,678</b>	<b>28.2%</b>	<b>0.2%</b>

### Kapitalizimi i veprimtarisë

Në fund të vitit 2022, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar ishte 18.1%.

Secila bankë e ka këtë tregues mbi nivelin minimal të kërkuar prej 12%. Bankat me kapital evropian dhe bankat josistemike raportojnë nivelin më të lartë të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në fund të periudhës, kapitali rregullator i bankave shënonte 170 miliardë lekë ose rreth 6 miliardë lekë më shumë në krahasim me nivelin e fundit të vitit 2021. Rritja e kapitalit rregullator ishte disi më e ulët në krahasim me vitin e mëparshëm, kryesisht për shkak të rënies së kapitalit të paguar në valutë si rezultat i ndryshimeve strukturore në sektorin bankar dhe efektit të kursit të këmbimit.


Nga ana tjetër, aktivet e peshuara me rrezik kanë arritur në nivelin e 960 miliardë lekë, duke regjistruar një rritje vjetore me rreth 27 miliardë lekë. Në raport me totalin e aktiveve, pesha e aktiveve të peshuara me rrezik paraqitet e qëndrueshme dhe është luhatur rreth nivelit 51%.

<sup>8</sup> Burimi Banka e Shqipërisë


## 5.3 SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI

Struktura e aktiv pasivit pasqyrohet në grafikët e mëposhtëm


Struktura e aktiveve të sistemit bankar 2022




Struktura e aseteve të sistemit bankar 2021



Struktura e detyrimeve të sistemit bankar 2022



Struktura e detyrimeve të sistemit bankar 2021



# PERFORMANCA NË UNION BANK





## 6.1 TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË

	në Lek '000	në Lek '000	në Eur '000	në Eur '000	Ndryshime	
	2022	2021	2022	2021	2022	2021
<b>BILANCI</b>						
Totali i Aktiveve	91,852,015	80,492,820	804,097	666,552	14.1%	12.0%
Portofoli i kredisë bruto	43,477,205	37,384,320	380,611	309,575	16.3%	11.5%
Investime në letra me vlerë	29,145,705	27,695,931	255,149	229,347	5.2%	11.4%
Balancet në banka	5,144,143	4,976,596	45,033	41,211	3.4%	18.1%
Detyrime ndaj klientëve	68,762,107	63,215,713	601,962	523,482	8.8%	13.3%
Kapitali aksionar	7,452,381	6,744,327	65,240	55,849	10.5%	16.1%
<b>PASQYRA E FITIM HUMBJES</b>						
Të ardhurat neto nga interesat	2,927,904	2,569,505	25,632	21,278	13.9%	15.2%
Të ardhurat neto nga komisionet	458,600	327,130	4,015	2,709	40.2%	26.0%
Të ardhura të tjera, net	171,049	336,012	1,497	2,782	-49.1%	10.2%
Fitimi operativ	3,557,553	3,232,647	31,144	26,769	10.1%	15.6%
Totali i shpenzimeve operacionale, përfshirë dhe provigjonet	(2,467,009)	(1,995,254)	(21,597)	(16,522)	23.6%	-10.2%
Fitimi neto para tatimit	1,090,544	1,237,393	9,547	10,247	-11.9%	115.7%
<b>STATISTIKA</b>						
Numri i punojësve	447	418			6.9%	4.5%
Numri i degëve	32	32			0.0%	0.0%
Numri i kredive aktive	25,777	25,400			1.5%	0.6%
Numri total i klientëve	230,979	189,186			22.1%	19.7%
<b>TREGUESIT KRYESORË</b>						
Kthimi në kapital (ROE)	11.4%	16.1%			7.1%	-4.7%
Kosto ndaj të ardhurave operative	53.4%	49.4%			1.0%	4.0%
Kredi, bruto ndaj depozitave	63.2%	59.1%			-0.9%	4.1%
Norma e rritjes së aktiveve	14.1%	12.0%			3.0%	2.1%
Norma e rritjes së detyrimeve ndaj klientëve	8.8%	13.3%			5.8%	-4.5%
Norma e rritjes së kredisë	16.3%	11.5%			1.7%	4.8%
Fondi i provigjoneve ndaj totalit të kredisë	4.1%	4.5%			-1.0%	-0.4%
Marzhi neto nga interesat	3.7%	3.7%			0.1%	0.0%
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	15.83%	15.28%			-0.1%	0.6%
Aktivët për punonjës	205,485	192,567			7.2%	6.7%
Aktivët për degë	2,870,375	2,515,401			12.0%	14.1%

Treguesit financiarë janë përllogaritur mbi bazën e pasqyrave financiare të Bankës, përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNFR") si entitet më vete.


## 6.1 TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË

**Aktivitet** e Union Bank në fund të vitit 2022 arritën vlerën afro 92 Miliardë Lekë duke reflektuar një rritje prej rreth 11.4 Miliardë Lekë, që është 14.1% më e lartë se viti 2021. Struktura e aktiveve të Bankës vazhdon të mbështesë dhe të mirëmbajë raporte të shëndetshme për indikatorë të rëndësishëm si Kredi ndaj Aktiveve, dhe Investime ndaj Aktiveve. Kreditë dhe paradhëniet neto ndaj Klientëve dhe institucioneve financiare përbëjnë 45.4% të totalit të aktiveve të Bankës, (44.3% në vitin 2021).

Investimet në letra me vlerë përbëjnë 31.7% të totalit të aktiveve të Bankës, (34.4% në 2021). Në investimet në letrat me vlerë janë të përfshira Bonot e Thesarit, Bonot e Qeverisë Shqiptare, si dhe disa Bono të korporatave/qeverive të huaja të cilësisë së lartë, kryesisht të rankuara në kategorinë "Investment grade".

Paraja dhe Llogaritë në Banka janë në nivelin 20.1% të totalit (në 2021 18%). Aktivitet fikse dhe të tjera zënë rreth 2.8% të aktiveve totale (në 2021: 3.3%).

Paraja dhe Llogaritë në Banka janë në nivelin 20.1% të totalit (në 2021 18%). Aktivitet fikse dhe të tjera zënë rreth 2.8% të aktiveve totale (në 2021: 3.3%).




**Detyrimet** e Union Bank në fund të vitit 2022 janë raportuar të jenë afro 84.4 Miliardë Lekë (73.7 Miliardë në vitin 2021), duke treguar një rritje vjetore prej 14.4% ose 10.7 Miliardë Lekë. Rritja e detyrimeve ka shkuar sipas planit. Struktura e tyre ka pësuar pak ndryshime krahasuar me vitin e mëparshëm: Fondet/depozitat e Klientëve zënë 81.5% të totalit të detyrimeve në fund të 2022 përkundrejt 85.7% të fundit të vitit 2021; ndërkohë detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare nga 12% që ishin më parë, raportojnë këtë vit 16.3%.

Në fund të 2022 Banka në total rezulton me një borxh të varur prej 808 Milion lekë, që është rreth 10.8% e kapitalit të saj. Banka emtoi në shtator të 2022 edhe 3 Milionë Euro të tjera Borxh të varur, i treti në një periudhë tre vjeçare, duke arritur në total në 7 Milionë Euro. Aprovimet përkatëse janë marrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"). Po ashtu, Banka e Shqipërisë ka aprovuar njohjen e Borxhit të varur të emtuar si pjesë e kapitalit rregullator të Bankës.

**Kapitali aksionar** u rrit me 708 Milionë Lekë duke shkuar në afro 7.5 Miliardë Lekë, duke shënuar 8.1% ndaj aktiveve totale të Bankës; pothuajse njësoj me një vit më parë.

Shënim: Banka përgatit dhe publikon në faqen web të saj edhe pasqyrat financiare të konsoliduara, të cilat përfshijnë edhe filialin e Landeslease, një kompani leasing që operon në Shqipëri, 100% në pronësi të Bankës.

Struktura e Detyrimeve dhe Kapitalit ndër vite




### Profitabiliteti

Fitimi neto i Union Bank në vitin 2022 kaloi shumë prej 808 Milionë Lekë si një kombinim i të ardhurave operative prej rreth 3.6 Miliardë Lekë dhe shpenzimeve operative prej rreth 2.5 Miliardë Lekë, duke shënuar rezultate mjaft të kënaqshme.

Të ardhurat neto nga interesat në vitin 2022 ishin rreth 2.9 Miliardë Lekë me një rritje prej 14% kundrejt vitit 2021. Të ardhurat neto nga komisionet u mbyllën në nivelin e 459 Milionë Lekë duke rezultuar në një rritje domethënëse prej rreth 40%. Edhe pse të ardhurat neto nga komisionet përbëjnë vetëm 13% (2021: 10%) të të ardhurave operative, kemi një vëmendje më të madhe të Bankës ndaj këtij segmenti, për të maksimizuar edhe potencialin e tregut.

Krahasuar me vitin 2021, të ardhurat totale operative u rritën me 325 Milionë Lekë ose me 10.1%, ndërsa shpenzimet operative u rritën me rreth 472 Milionë Lekë ose 23.6% (provigjonet e përfshira). Rritja e shpenzimeve operative vjen nga rritja e Bankës, rritjes së kostove në treg, investimeve të bankës në infrastrukturë si edhe qasjes prudenete në provigjonim.

Banka është bindshëm profitabël dhe treguesit operacionalë mbeten në përmirësim. Me gjithë vështirësitë e një viti të pazakontë, **kthimi nga kapitali në fund të vitit 2022 është 11.4%.**



## 6.2 SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT

**Shërbimi i mirë ndaj klientit është pika më e fortë që e ka dalluar Union Bank ndër vite në treg dhe vijon të jetë element kyç në strategjinë e bankës për t'u rritur dhe zhvilluar më tej.**

**Transparenca dhe profesionalizmi janë shtyllat kryesore ku ne mbështetemi për të komunikuar me klientët tanë në aktivitetin tonë të përditshëm.**

Për ne fokusi ndaj klientëve do të thotë të kuptojmë nevojat e tyre të vazhdueshme bankare, të njohim dhe adresojmë shqetësimet që ata kanë, si edhe të përmirësojmë vazhdimisht shërbimin dhe produktet që i ofrojmë.

Gjatë vitit 2022, Qendra e Kontaktit, përmirësimi i teknologjisë, proceseve dhe rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, do të synojë rritjen e ofertës së shërbimeve, ndërveprim të shkëlqyer me klientët në të gjitha pikat hyrëse të kontaktit, si telefon, email, etj.; sipas zgjedhjes së klientit. Migrimi i ndërveprimit të klientëve në kanalet e sugjeruara, ashtu si dhe gjenerimi i mundësive të shitjeve, duke synuar rritjen e kënaqësisë së klientit dhe mbajtjen afatgjatë të një marrëdhënieje të shëndetshme.

# BIZNESI PËR KLIENTËT INDIVIDË



## 7. BIZNESI PËR KLIENTËT INDIVIDË

**Biznesi për Klientët Individë**, në këto vite po kalon një transformim me evolucionin digjital, multichannel<sup>10</sup> dhe kërkesën për risi teknologjike që po krijon një ekosistem krejtësisht të ri.

Nevoja për të krijuar avantazhe të qëndrueshme konkurruese, duke i fituar dhe mbajtur klientët ishte një fokus i domosdoshëm për Union Bank në 2022 dhe do të vazhdojë të rritet.

Kemi nisur të ofrojmë eksperiencë në biznesin e klientëve individë – duke u fokusuar sot në një gamë të gjerë zgjidhjesh novatore për strategjinë e së ardhmes, për ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme të biznesit, si edhe për të mbajtur ritmin me transformimin dhe konkurrencën e vazhdueshme në treg.

Përtej të gjitha vështirësive të këtyre 2 viteve, përfshirë pasiguritë për të ardhmen, banka jonë rikonfirmoi misionin e saj nëpërmjet angazhimit për të qenë një institucion financiar i fortë dhe i qëndrueshëm, duke ofruar produkte të diferencuara si dhe një eksperiencë të shkëlqyer bankare për të gjithë klientët tanë.

### **Fokusi i biznesit ka qenë në nivele të ndryshme të këtyre fushave:**

- Modeli i biznesit me fokus klientin;
- Krijimi i një kombinimi të duhur produktesh të mbështetura në sjelljen dhe nevojat e klientëve;
- Rikonceptimi i degëve si qendra eksperience me fokus shitjen dhe shërbimin e shkëlqyer;
- Transformimi i kanaleve dixhitale në Omnichannel që ofrojnë përvojë të qëndrueshme, të sigurt dhe të shkëlqyer.

<sup>10</sup> Koordinimi i të gjitha kanaleve të komunikimit për të ofruar një eksperiencë sa më efektive për klientët.

# RAPORTI I PRODUKTEVE DHE SEGMENTEVE TË KLIENTËVE



## 8.1 SHËRBIME BANKARE PËR INDIVIDË

### Segmentet e Klientit

Fokusi për segmentin individë vazhdon të jetë rritja e veprimtarisë bankare të klientëve, nxitja e marrëdhënieve primare dhe afrimi i klientëve të rinj, kryesisht të moshave të reja të popullatës.

Klientët Individë mbajnë shumicën e fondeve të bankës dhe janë një pjesë shumë e rëndësishme e portofolit tonë të kredisë. 89% e bazës së klientëve janë klientë individë.

Jemi fokusuar në një qasje gjithëpërfshirëse me klientët duke forcuar marrëdhënien dhe duke rritur aktivitetin e tyre me bankën. Fokusi tek klientët Pagamarrës vazhdon të rritet duke rritur dhe përpjekjet për të krijuar marrëdhënie të drejtpërdrejta si edhe tërheqjen e klientëve të rinj. Ky segment shënoi një rritje të ndjeshme prej 23% krahasuar me një vit më parë. Kemi punuar drej alternativave të ndryshme pikërisht për këtë segment klientësh. Kemi ndërtuar paketa të personalizuar me një diversitet produktesh dhe çmime preferenciale sipas nevojave të tyre duke u mbështetur edhe në ciklin e jetës së klientëve. Gjithashtu kemi zhvilluar edhe alternativat e kreditimit duke ofruar limite më të larta dhe afate më të gjata për segmentin pagamarrës dhe në veçanti klientët e profesioneve të lira. Këta klientë të cilët për ne konsiderohen klientë parësore kanë rritur aktivitetin e tyre kreditues duke zgjeruar kështu bazën e klientëve kredimarrës. Fokusi i bankës ka qenë ofrimi i produkteve me norma të përballueshme dhe me kushte fleksibël për ta. Mbështetur nga fushata të vazhdueshme promovuese, volumet e reja të kredisë konsumatore janë rritur me 20 % vit, krahasuar me një vit më parë. Viti 2022 ka qenë një vit shumë i mirë për kredinë konsumatore, e ndikuar kjo kryesisht nga shuma e kredisë e cila është më e larta e ofruar në treg, larmia e normave fikse të interesit dhe përmirësimet e vazhdueshme.

Grupmoshat e reja janë klientët potencialë që premtojnë besnikëri ndaj çdo organizate. Ne kemi filluar të krijojmë një marrëdhënie të ndërsjellë me këtë target grup duke krijuar produkte dhe paketa të dedikuara posaçërisht për ta. Në vitin kur Tirana u shpall Kryeqyteti i Rinisë së Europës për vitin 2022, banka bashkëpunoi me Bashkinë Tiranë për të ofruar kartën e Studentit 2 në 1. Jemi banka ekskluzive që ofron një produkt kaq novator, një kartë bankare e bashkuar me kartën studentore e cila i mundëson studentëve shërbime falas dhe çmime preferenciale në një rrjet shumë të gjerë qendrash kulturore, muze, galeri, hapësira rinore e tregtare. Ky është një produkt me të cilin ne synojmë të rrisim bazën e klientëve në fazat e hershme të bankingut dhe shndërrimin e tyre në klientë aktivë / primarë.

Bashkë me Kartën e Studentit 2n1, Studentët e Tiranës përfitojnë një paketë studenti që ofron shërbimin bankar online dhe çmime preferenciale për shumë produkte të tjera bankare.

Mbetemi banka e vetme në treg që ofrojmë paketën Junior me të vetmen kartë bankare për fëmijë 0-17 vjeç, në treg. Pjesë e paketës është edhe një llogari kursimi dhe online banking duke i lejuar fëmijët të kontrollojnë dhe menaxhojnë paratë e tyre, ndërkohë që u jep prindërve mundësinë të monitorojnë aktivitetin bankar të fëmijëve të tyre. Produkti ka si synim të rrisë edukimin financiar të këtyre të rinjve.

Vazhdojmë e ruajmë fokusin drejt kategorive të caktuara të klientëve me nevoja bazë për produkte dhe shërbime bankare si pensionistët, duke ju ofruar atyre paketa me tarifa preferenciale.

Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë aktivitetin e klientëve tanë, të rrisim përdorimin e produkteve dhe shërbimeve bankare, të thithim grupe të reja klientësh, si studentë dhe klientë me profil premium dhe të përmirësojmë paketat dhe modelet e biznesit.

Jemi duke punuar për produkte të dedikuara për të gjithë klientët Emigrantë, të cilët jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërie por e shohin Shqipërinë si mundësi për të investuar në tregun e pasurive të paluajtshme, ose për të investuar kursimet e tyre në depozita me interes.

Do t'i mbështesim klientët tanë me shërbim të thjeshtë dhe eksperiencë Omnichannel për një përvojë të lehtë dhe të kënaqshme.



## 8.1 SHËRBIME BANKARE PËR INDIVIDË

### Eksperienca e klientit

Në Union Bank, ne e kemi shumë të rëndësishme përvojën dhe kënaqësinë e klientit. Gjatë vitit të fundit ne i kemi orientuar përpjekjet tona drejt përmirësimit të eksperiencës së klientit për të ofruar një shërbim të shkëlqyer nëpërmjet kanaleve dhe produkteve novatore. Për ne, vëmendja ndaj klientëve dhe adresimi i nevojave të tyre, është një nga detyrat kryesore.

Për të siguruar që po përmbushim standardet tona të larta për përvojën e klientit, kemi kryer aktivitete vjetore për të shqyrtuar dhe analizuar komentet dhe ankesat e klientëve. Këto aktivitete përfshijnë mbledhjen e reagimeve të klientëve përmes sondazheve, kanaleve të mbështetjes së klientit dhe platformave të mediave sociale, dhe më pas analizimin e të dhënave për të identifikuar fushat ku mund të përmirësohemi.

Ekipi ynë i përvojës së klientit dhe i ankesave i ndjek dhe shqyrton me prioritet çdo reagim dhe ankesë, duke i kategorizuar ato në lloje të ndryshme, siç janë çështjet e produktit/shërbimit, çështjet e transaksioneve dhe më e rëndësishmja ato të komunikimit. Ata më pas punojnë ngushtë me departamentet përkatëse për të hetuar dhe zgjidhur çdo çështje në kohë dhe në mënyrë efektive, si edhe përmirësimi i disa proceseve të brendshme për të shmangur rritjen e ankesave të klientit por edhe për të përmirësuar eksperiencën e tyre.

Gjatë gjithë vitit 2022 kemi ndërtuar një strategji konkrete për matjen dhe ndjekjen e eksperiencës së klientit. Zhvilluam një studim tregu "Usage & Attitude". Objektivi kryesor i studimit ishte përcaktimi i strategjisë Retail të bankës dhe identifikimi i mundësive të rritjes duke kuptuar sjelljen bankare të klientit, qëndrimet dhe motivimet e tij. "U&A" u zhvillua në 4 qytete kryesore të Shqipërisë me një bazë prej x përdoruesish të shërbimeve bankare. Sipas studimit, Union Bank renditet banka e parë në treg për vlerësimin e shërbimit ndaj klientit. Janë vlerësuar nga klientët procedurat e thjeshta bankare të kredimarrjes, transparenca dhe mbështetja e vazhdueshme që i ofrojmë klientëve. Do të vazhdojmë përmirësimin dhe zhvillimin e teknologjisë për të ofruar zgjidhje sa më moderne dhe novatore për platformën online.

Gjatë 2022 kemi kryer disa pyetësorë dhe sondazhe për të matur dhe kuptuar përvojën e klienteve tanë si me produktet që kanë me bankën ashtu edhe me shërbimin që ata marrin nga disa kanale.

Kemi zhvilluar 2 NPS, gadishmëria e klientëve për të na rekomanduar tek familja apo miqtë e tyre, me rezultate shumë pozitive. Çdo muaj bëjmë pyetësorë për eksperiencën e klientëve të cilët kanë marrë një kredi nëpërmjet "Dua Kredi", një degë virtuale ku nëpërmjet një telefonate çdo klient mund të aplikojë për financim. Kemi zhvilluar pyetësorë për shërbimin në degë, për produktet e kartës së kreditit dhe kursimeve, si edhe shumë e rëndësishme për ne ka qenë të kuptojmë eksperiencën e parë të klientëve tanë me bankën nëpërmjet pyetësorit për klientët e rinj dhe arsyet pse disa klientë largohen nëpërmjet pyetësorit për klientët e larguar. Të gjitha këto rezultate i analizojmë dhe kuptojmë më shumë për klientin se çfarë do dhe se si ne mund të përmirësohemi për të mbështetur kërkesat dhe nevojat e tyre.

Zhvillimet teknologjike përgjatë vitit 2022, shënuan një hap të rëndësishëm në punën tonë drejt zhvillimit dhe implementimit të platformave bashkëkohore, si BUZZ, një platformë për ndërveprimin me klientët e cila do të na mundësojë të mbajmë një komunikim të vazhdueshëm me ta për informacione të ndryshme rreth bankës, për produktet apo shërbimet tona dhe fushata të ndryshme, të gjitha këto të automatizuara. Tashmë, klientët tanë nuk kanë nevojë të kërkojnë mënyra alternative për të komunikuar me bankën, ne sigurohemi që të mund t'i adresojmë nevojat e klientëve nëpërmjet kanaleve digjitale që ata përdorin më shumë në jetën e tyre të përditshme. Qëllimi ynë ndër vite ka qenë fokusimi në nevojat e klientëve dhe ofrimi i shërbimeve të duhura në kohën e duhur. Shërbimet tona më të reja, mundësojnë që nëpërmjet kanaleve të komunikimit, klientët të jenë në dijeni në mënyrë frekvente, për sjelljen e tyre financiare, si dhe t'u ofrojmë ide se si mund të arrijnë qëllimet e tyre, ose të marrin vendime më të mira financiare.

## PRODUKTET PËR INDIVIDË

### Llogari dhe Depozita

**Llogaria e kursimit** – shënoi një rritje me 3% përgjatë vitit 2022. Ky produkt përbën një mundësi kursimi për të gjitha kategoritë e klientëve të cilët kanë kursime të vazhdueshme, në vlera relativisht të vogla, kërkojnë që fondet të jenë të vlefshme për t'i tërhequr në çdo kohë.


Nisur nga preferencat e prindërve dhe familjarëve për të çelur një llogari kursimi për fëmijet si një mundësi për të kursyer periodikisht, Banka lançoi gjatë vitit 2022 Produktin "Filizat" të dedikuar për këtë kategori klientësh.

**Depozita me afat** – kanë një vlerë sa 52% e Totalit të ndjekura nga kursimet afatgjata me 18%. Depozitat në afatet nga një deri në tre vjet ishin mbizotëruese përgjatë vitit 2022. Rritja e kursimeve në këto afate është efekt i trendit që karakterizon tregun e vendit dhe i lidhur me disa kategori specifike si emigrantët, pensionistët të cilët depozitojnë kursimet e tyre për afate më të gjata kohore.

Në drejtim të ofrimit të një larmie më të madhe produktesh në përputhje me kërkesat e konsumatoreve Union Bank ndërmori disa iniciativa ku mund të përmendet lançimi i produktit të depozitës me afat 5 vjeçar me interesa periodike, ndërkohë që u kryen rregullimet përkatëse në produktin e depozitave 25 dhe 35 mujore, pa penalitet në rast tërheqjeje.

Ndërkohë Banka jo vetëm që ofroi mundësinë e çeljes së produkteve të depozitave nga distanca nëpërmjet shërbimit të internet banking UB Online, por njëkohësisht ofroi dhe norma interesi më të favorshme se ato për depozita të çelura në degët e bankës.

Norma të përmirësuara interesi u ofruan po ashtu për klientët në moshë pensioni të cilët depozituan kursimet e tyre në Union Bank.




Të gjithë komponentët kryesorë të Fondeve të Klientëve janë rritur në vitin 2022 në përputhje me parashikimet e Bankës. Strategjia e ndjekur nga ana e Bankës, arriti nivelin e nevojshëm të fondeve, si instrumenti bazë për financimin e aktivitetit të Bankës, duke bërë të mundur suportimin e rritjes së kreditimit dhe investimeve alternative dhe duke ruajtur nga ana tjetër nivelet e duhura të likuiditetit në Bankë.

Banka ishte aktive përgjatë gjithë vitit, duke ndërmarrë fushata aktive promovuese dhe informuese mbi alternativat e larmishme të kursimit për të gjitha segmentet e klientëve nga fëmijët deri tek klientët në moshë pensioni. Kjo në një linjë edhe me synimin e bankës për të nxitur përfshirjen financiare për të gjitha kategoritë e klientëve.


Fondet gjatë vitit 2022 janë dominuar nga portofoli në valutë me 57%, ku vijon edhe në këtë vit trendi i kursimeve në Euro. Sikundër e evidentuar ndër vite me ndikim të dukshëm kjo nga remitancat e bashkëatdhetarëve që jetojnë e punojnë jashtë vendit.

## 8.1 SHËRBIME BANKARE PËR INDIVIDË

### Zhvillimi i llogarive të klientëve




### Struktura e detyrimeve ndaj klientëve




## 8.1 SHËRBIME BANKARE PËR INDIVIDË


Struktura e detyrimeve ndaj klientëve 2022



Struktura e detyrimeve ndaj klientëve 2021



Zhvillimi i depozitave me afat



## 8.1 SHËRBIME BANKARE PËR INDIVIDË

### Produktet e kartave

Përdorimi i kartave pati një rritje edhe më të lartë se në vitet e kaluara përgjatë vitit 2022. Karta e debitit pësoi një rritje rekord prej 77% në volumin e transaksioneve në Pika shitjeje apo Online dhe 32% në numrin e tyre. Të njëjtat ritme dhe rritje rekord shënoi edhe përdorimi i kartave të kreditit për blerje apo pagesa online konkretisht 81% në volum dhe 31% në numër transaksionesh. Risia e vitit 2022 ishte produkti Unik në treg i kartës financiare për Studentë, e cila në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës ofron gjithë përfitimet e kartës standarte të Studentit por shoqëruar me benefite të plota financiare që ofron një kartë debiti nga Union Bank. Ky produkt është një risi për të gjithë sektorin bankar në vend dhe njëkohësisht në përputhje me strategjitë e Union Bank për përfshirjen e moshave të reja në sektorin bankar. Karta e Studentit u ofrua si pjesë e një paketë të plotë financiare përfshirë llogarinë rrjedhëse dhe shërbimin e Online Banking, pa asnjë kosto për këtë kategori të rëndësishme për Union Bank. Po ashtu për studentët u ofrua dhe një bonus aktivizimi dhe përdorimi i kartës, gjithmonë me synim edukimin e mëtejshëm dhe përthithjen e tyre sa më herët në botën financiare.

Përgjatë gjithë vitit po ashtu u kryen aktivitetet promovuese për të shtuar numrin e kartëmbajtësve të Bankës, dhe nxitjen e transaksioneve financiare nëpërmjet kartave duke larguar më tej klientët nga përdorimi i CASH-it. Kartat e Union Bank ofrojnë teknologjinë më të fundit të pagesave të sigurta online atë 3DS2. Klientët mund të kryejnë blerje, rezervime të sigurta në tregtarë të çertifikuar nga e gjithë bota.

"Contactless", pagesat pa kontakt janë të pranishme në çdo kartë të lëshuar nga Union Bank. Një lehtësi kjo në kryerjen e pagesave në çdo pikë shitjeje brenda dhe jashtë vendit.

Në vitin 2023 do të ofrojmë dhe kartat Visa për të plotësuar funksionalitetin e ATM-ve tona, për të qenë më funksionale për gjithë kartëmbajtësit në treg, por dhe për të krijuar mundësi për produkte të tjera që sot na mungojnë.

### Kanalet Alternative

Për të mbështetur objektivat e rritjes së Bankës, si dhe për të forcuar vlerën tonë të propozimit të klientëve edhe gjatë 2022 aktivitetet e kanaleve alternative u formësuan jo vetëm për të përmirësuar përvojën e klientëve dhe uljen e kostove por dhe për të krijuar bazat për funksione të ardhshme.

Kanalet alternative si zgjedhje e pashmangshme e klientit, kanë arritur të ofrojnë një përvojë të shkëlqyer për klientin duke:

- Ndërveprimet e klientit kanë qenë të lidhura dhe të pandërprera ndërmjet gjithë pikave hyrëse në distancë.
- Janë përmirësuar proceset e brendshme në mënyrë që udhëtimi i klientit në kanalet alternative të ishte i kordinuar dhe efektiv.
- Është rritur gadishmëria nga pikëpamja e kompetencave dhe sistemeve ndihmëse në qendrën e kontaktit, si një kanal intensiv shërbimi ndaj klientit
- Optimizimi i gypit të shitjeve për të gjithë kanalet e origjinës që sjellin aplikime për produkte kreditore për klientët individ që manaxhohen nga ekipi DuaKredi.
- Marketingu digjital i përmirësuar në formën e komunikimit dhe në formën e targetimit për të gjeneruar aplikime për produkte për individ.
- Modernizimi dhe shtimi i flotës së ATM-ve për transaksionet cash si kanal me përdorim 24/7 krahasuar me degët.

### Rrjeti i ATM-ve

Rrjeti i ATM-ve vazhdimisht po modernizohet dhe optimizohet për t'i shërbyer më mirë nevojave të klientit, duke ju përshtatur zhvillimeve të fundit në treg si dhe të sigurojë mbulim sa më të gjerë të zonave qoftë rezidenciale si dhe turistike, për të rritur aksesin e klientëve në fondet e tyre në 24/7. Shërbimi në ATM mundësohet për të gjitha kartat e lëshuara ndërkombëtarisht nën markat Mastercard. Banka, nëpërmjet stafit të degëve u angazhua në edukimin intensiv të klientëve për përdorimin e ATM, duke u fokusuar në funksionin e depozitimit.

Në fund të 2022 Union Bank arriti një numër total prej 59 ATM në të gjithë vendin, 27 nga këto me funksion shtesë të depozitimit të fondeve. 26 ATM janë të riciklueshme, një mekanizëm risi në rrjetin e ATM-ve të sistemit bankar. Ndërkohë janë 24 ATM të vendosura jashtë dege duke rritur mbulimin gjeografik.

Gjatë 2022, numri i transaksioneve në të gjithë rrjetin e ATM-ve është rritur me 33% dhe volumet me 64%, krahasuar

## 8.1 SHËRBIME BANKARE PËR INDIVIDË

me 2021. Gjithashtu, rritja e zonës së mbulimit ka sjellë rritjen e transaksioneve në ATM jashtë dege me 75% krahasuar me 2021. Transaksionet me karta të huaja janë rritur 113%, krahasuar me 2021, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave. Të ardhurat nga transaksionet në ATM janë rritur 135% krahasuar me 2021.

Gjatë 2022, banka ka kryer përmirësime në funksionalitete dhe është angazhuar në edukimin e klientëve për përdorimin e ATM, kjo ka sjellë uljen e gabimeve në ATM me 14% krahasuar me 2021.

Gjatë 2023, Banka do të vazhdojë të rrisë flotën e ATM-ve me teknologjinë e riciklueshme. Gjithashtu, shërbimi në ATM do të mundësohet dhe për të gjitha kartat Visa.

### Platforma digjitale UB Online

Banka digjitale gjithnjë e më shumë është konsideruar një kanal i preferuar për pamje të detajuar të produkteve të klientit me bankën ashtu si dhe për inicimin e transaksioneve financiare. Gjithashtu platforma digjitale gjeti përdorim të gjerë gjatë 2022 si për transaksionet jo financiare ashtu si dhe një formë e sigurtë komunikimi me bankën.

Për të gjithë 2022, 49% e të gjithë transaksioneve financiare janë kryer nga UB Online. Gjatë 2022 transaksionet e inicuar nga UB Online janë rritur me 50% kundrejt 2021. Numri i klientëve që kanë qasje në bankën digjitale u rrit me 79% krahasuar me 2021, kjo rritje është 81% për klientët individ dhe 65% me klientët biznes krahasuar me një vit të kaluar. Në baza mujore, mesatarisht 50% e klientëve digjitalë aksesojnë shërbimin.

Banka do të vazhdojë të zbatojë strategjinë e vetë digjitale duke: (i) duke mbajtur një ofertë digjitale konkurruese në treg dhe (ii) fokusimi në UX të shkëlqyera. Në planin afatgjatë do të ofrohen dhe produkte kreditore të thjeshta për individët si kredi konsumatore dhe karta krediti.

### DUAKredi

Gjatë 2022, vlerat e kredive të thjeshta, kredi konsumatore dhe karta krediti për individë, të gjeneruara nga kanalet alternative zunë rreth 16.5 % të vlerës së kredisë konsumatore disbursuar për bankën. Gjatë 2022, pati një përmirësim të dukshëm në formën e komunikimit digjital ashtu si dhe targetimi për të gjeneruar aplikime të reja kreditore për klientët individ. Rritja e kapaciteteve të brendshme ashtu si dhe përmirësimi i disa proceseve optimizoi dhe rriti efikasitetin në trajtimin e rasteve që vinin nga kanalet në distancë. Edhe për 2022, banka vazhdoi të priste aplikime nga faqja e internet, rrjetit sociale të dedikuara DUAKredi, partnerë të bankës në pika shitje me pakicë si dhe rrjetit Union Net.

## 8.2 SHËRBIME BANKARE PËR BIZNESE

Union Bank ka në fokus klientët biznes dhe nevojat financiare të tyre duke ju përgjigjur nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të produkteve dhe paketave bankare që përdor sektori biznes, si në SME dhe në Biznesin e madh.

Synojmë të kemi shërbim të lartë dhe cilësor ndaj klientëve biznes, duke ofruar shpejtësi, fleksibilitet për kryerjen e transaksioneve bankare dhe qenë këshillues dhe mbështetës në planet e tyre të biznesit, investimeve.

I kushtojmë shumë rëndësi përzgjedhjes së Menaxherëve të Klientëve Biznes, trajnimit të vazhdueshëm të tyre, në mënyrë që të jemi në pritshmëritë e bizneset ndaj nesh, çfarë na jep më shumë besim për të realizuar objektivat tona të biznesit në segmentin SME.

Ky është dhe një investim mjaft i rëndësishëm për ne; punonjës të kualifikuar, të motivuar dhe të vlerësuar bëjnë një diferencë dhe janë një vlerë e shtuar. Union Bank sjellë gjithmonë risi në shërbimet bankare të klienteve biznes, duke ofruar paketa shërbimi biznesi konkurruese. Ne synojmë krijimin e marrëdhënieve afatgjata me secilin prej klientëve biznes dhe ofrimin e shërbimeve bankare të thjeshta, të përshtatëshme dhe gjithëpërfshirëse.

Nisur nga sfidat makroekonomike të viteve të kaluara dhe dinamikave të tregut, kemi qenë proaktivë për të

## 8.2 SHËRBIME BANKARE PËR BIZNESE

mbështetur biznesin në çdo hap, duke qënë një prej partnerëve kryesorë të tyre. Union Bank ofron mbështetje për të gjitha bizneset, nga ato të vogla tek ato të mëdha, duke patur ekspertizë për çdo tipologji klienti, sektori dhe duke ofruar një numër të gjerë produktesh që plotësojnë nevojat e tyre e tanishme dhe planet e tyre të mëtejshme. Përtej gamës së gjerë të produkteve, ajo çfarë na diferencon në treg është shërbimi i personalizuar dhe përmirësimi i vazhdueshëm.

Për Union Bank, klientët janë partnerët tanë të biznesit dhe i mëshojmë vlerës që kemi për një komunikim të hapur, të vazhdueshëm për të kuptuar situatat makroekonomike, impaktet e tyre dhe nevojat financiare që biznesi do të ketë, për t'ju ofruar produktin e duhur në kohën e duhur. Besimi është ai që na bën të kemi një marrëdhënie afatgjatë me klientët dhe të kemi një përqindje të vogël largimesh.

Rritja e numrit të klientëve Biznes mbi 10% dhe e portofolit të kredisë mbi 20%, janë dhe treguesit më të mirë të këtij shërbimi.

Ne vijmë gjithmonë me risi në produktet që ofrojmë duke mbështetur të gjithë sektorët e ekonomisë, klientët që operojnë në to, të cilët kanë nevojë për këshillimin dhe mbështetjen e bankës.

Union Bank është partner i Zinxhirit të Agrobiznesit dhe vit pas viti shton gamën e produkteve të dedikuara për të. Krijimi i një strukture të dedikuar për sektorin e agrobiznesit dhe produktet e dizenuara për agrogrumbullues, eksportues dhe fermerë, na mundësuan të hyjmë në këtë sektor dhe të jemi aktiv për ta mbështetur.

Gjithashtu, banka jonë i ka kushtuar vëmendje të veçantë dhe Investimeve në Energjinë e Rinovueshme nisur nga impakti pozitiv që ato kanë në mjedis si dhe në rritjen e kursimit të klientëve tanë biznes. Në sajë të lehtësive të ofruara për bizneset që e ndërmarrin këtë hap si dhe shpejtësisë në procesim, kemi qënë promotorë për nxitjen e këtyre investimeve. Investimet ESG do të jenë në fokusin e biznesit dhe këshillimit tonë për klientët dhe produktet që do të ofrojmë.

Një tjetër sektor me rëndësi për ne është edhe Turizmi, ku Union Bank ka si objektiv përmirësimin e cilësisë së bizneseve të hoteleve, ambjenteve të akomodimit dhe bujtinave si dhe të qënit bashkëpunëtor në shtimin e shërbimeve që ato ofrojnë. Angazhimi për sjelljen e risive për këtë sektor do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023, e shoqëruar me shërbim mjaft cilësor dhe duke patur në qendër kujdesin ndaj biznesit.

Në vitin 2023 dhe më tej, Union Bank do të vazhdojë ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të diferencuara për klientët biznes, duke sjelle risi të tjera për sektorët në fokus por edhe për sektorë të tjerë. Gjithashtu, Union Bank angazhohet në të qënit banka partnere e bizneseve të reja (start – up) si dhe bizneseve të drejtuar nga të rinj duke mbështetur një brez të ri të sipërmarrësve në biznes, nëpërmjet paketave të shërbimit dhe produkteve të personalizuara për plotësimin e nevojave të tyre.


## 8.3 KREDITË E DHËNA PËR KLIENTËT

Gjatë vitit 2022, volumi i kredive të reja të disbursuara për individë kanë qenë në vlerën 48.3 milionë Euro, e cila mundësoi rritjen e totalit të kredive për individë në vlerën 25.5 milionë euro.

Një fokus i shtuar për vitin 2022 ka qenë rritja e portofolit të kredive tek klientët pagamarrës dhe ato me të ardhura të larta nga paga dhe burime të tjera të qëndueshme.

Banka vazhdoi kreditimin për klientët individë gjatë gjithë vitit 2022. Kredia hipotekare pati penetrimin më të lartë si rrjedhojë e sjelljes së tregut dhe si rrjedhojë e bashkëpunimit të Union Bank prej një periudhe të gjatë me disa kompani ndërtimi të rëndësishme në Shqipëri.

Ndërkohë bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e investimeve në banesa që sigurojnë kursim të energjisë dhe përdorim efikas, u përdor maskimalisht granti i akorduar në llogaritë e klientëve huamarrës.



Njëkohësisht për vitin 2022, pati një rritje të ndjeshme të klientëve, të cilët u drejtuan tek banka për alternativa të tjera financimi të ofruara si kredi konsumatore dhe paradhënie bankare.

Për vitin 2022, Portofoli Total i kredive dhënë inividëve shënoi një rritje me 18% duke tejkaluar planet dhe objektivat e parashikuara në fillim të vitit, ndërkohë që numri i kredive u rrit me 2%.

Teprica e Kredisë për individë në fund të vitit arriti vlerën afro 19.5 miliardë Lekë ndërkohë që numri i produkteve kreditore kaloi shifrën 23 mijë me një rritje prej mbi një mijë klientesh individë të cilët aktualisht kanë një produkt kreditor në Union Bank.

Gjatë vitit 2022 Union Bank, përveç fushatave periodike promovionale, ndërmori disa aktivitete të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të ofertave të produkteve kreditore ku mund të përmenden ndër të tjera, rritjet e limiteve të kreditimit për klientët përsëritës duke përdorur rifreskim të transaksioneve nëpërmjet kanaleve elektronike, shoqëruar me një paketë të plotë produktesh të vlefshme për këtë kategori. Ofrimi i limiteve automatike të financimit për klientët me historik pozitiv kreditor, ofrimi i kredisë së dedikuar për emigrantët që kërkojnë të blejnë një pronë në vendin e tyre, me dokumentacion dhe terma lehtësuese. Mundësi financimi konsumator sipas limiteve dhe afateve më të larta në treg për kategoritë që kanë aftësi paguese për këto nivele financimi.




## 8.3 KREDITË E DHËNA PËR KLIENTËT



Union Bank vazhdoi me ofrimin e një norme interesi të kredisë për konsum me norma fikse interesi, e cila ofroi për klientët komoditetin e një pagese kësti të pandryshueshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë.

Ndërkohë një iniciative e rëndësishme e Union Bank kishte të bënte me rishikimin e interesave të kredive hipotekare ekzistuese të cilat patën luhatje të konsiderueshme në këste si rrjedhojë e rritjes së normave referencë pas periudhës fikse (Euribor, Bono Thesari, etj). Pavarësisht rritjeve standarte të përcaktuara në kontratat e kredive, Union Bank trajtoi masivisht këto kredi duke aplikuar një rishikim të përmirësuar të interesit, kjo në mënyrë që impakti tek pagesat nga klientët të ishte i reduktuar.

Struktura e Portofolit në vitin 2022 është e përbërë në raportin 45% për Individët dhe 55% për bizneset. Struktura është në një linjë me orientimin më të lartë të Bankës tek financimi i kategorisë Individë, krahasuar me mesataren e sektorit




Gjatë vitit Banka ndërmori gjithashtu fushata të vazhdueshme të promovimit të financimit konsumator dhe lehtësisë për ta përfituar atë, duke kontribuar njëkohësisht në parimin e jetesës në kohët moderne: "Kredia merret për të plotësuar edhe dëshira, jo vetëm nevoja".



## 8.3 KREDITË E DHËNA PËR KLIENTËT

Portofoli Total i kredive përgjatë vitit 2022 u rrit me 16.3% duke tejkaluar parashikimet e bëra në fillim të vitit. Teprica e Kredisë shënoi vlerën 43.5 miliardë Lekë me një rritje prej afro 6.1 miliardë Lekë, krahasuar me fundin e vitit të kaluar, ndërkohë që numri i produkteve kreditore shkon afro 26 mijë.

Struktura valutore e kredisë dhënë klientëve



### Cilësia e portofolit

Menaxhimi i portofolit në termat e cilësisë mbetet një nga prioritetet e Bankës. Ajo është konsideruar si një nga çështjet kryesore në procesin e huadhënies. Një monitorim nga afër i procesit është aplikuar si te kredia hipotekare ashtu dhe ajo konsumatore

Gjatë vitit 2022 Banka arriti të mbante një nivel mesatar të kredive me probleme më të ulët se 6.5%, ndërsa në fund të vitit tregoi 5.8% (Dhjetor 2021: 6.7%).

Fondi i provigjioneve për humbjet nga kreditë u mbyll në nivelin 4.1% të portofolit kreditor.

# ZHVILLIMI I OPERACIONEVE TË BRENDSHME

**Viti 2022** vijoi të mbetet një vit intensiv edhe përsa i takon përmirësimit dhe rritjes së efciensës së Operacioneve në Union Bank. Ka vijuar me intensitet Projekti i Upgrade të sistemit bazë operacional të bankës, në versionin më të fundit dhe inovativ të zhvilluar nga Oracle Financial Services.

**Në linjë me strategjinë e bankës me fokus tek klienti**, edhe strukturat e operacioneve qendrore janë angazhuar për të suportuar objektivat strategjike dhe iniciative biznesit nëpërmjet rishikimit të proceseve, identifikimit të teknologjive të reja për të rritur automatizimin e proceseve si Robotic Processing automation, digjitalizuar proceset e brendshme operationale, përmirësuar funksionalitetet e platformës digitale UB Online etj.

Përmirësimet në operacionet dhe funksionalitet e kartave kanë qenë po ashtu në fokus të angazhimit në strukturat e Operacioneve. Gjatë vitit 2022 përfundoi me sukses procesi i certifikimit të Union Bank nga kompania prestigjioze e kartave VISA International për leshimin dhe pranimin e kartave VISA.

# ZHVILLIMI DHE MENAXHIMI I RRJETIT



## 10. ROLI I DEGËVE DHE ZHVILLIMI I PREZENCËS FIZIKE (DEGË DHE ATM)

### Rrjeti i Degëve

Union Bank ka një rrjet prej 33 degësh në qytetet kryesore në vend. Gjatë vitit 2022 Union Bank zgjeroi rrjetin e saj të degëve, duke hapur një degë të re në Bulevardin Gjergj Fishta, për të qënë sa më pranë dhe prezent tek klientët. Rrjeti i degëve të Bankës vazhdoi transformimin e tij, jo vetëm në kuadër të formateve të degëve me zona 24/7, ATM me funksionalitet depozitimi, por dhe platforma ALL in One nga ku mund të aksesohet UB Online dhe aplikohet për produkte bankare përgjatë 24 orëve.

Gjithashtu një rëndësi të veçantë u tregua për të ofruar shërbim One Stop Shop në zonën e shërbimit të klientelës për transaksionet cash dhe financiare të tjera.

Union Bank nuk i ndali investimet në rrjetin e saj, duke ruajtur standarde të larta të shërbimit në të gjitha degët, si edhe duke trajnuar stafin për të patur një orientim drejt përmbushjes së kërkesave dhe kënaqësisë së klientëve. Gjithashtu Union Bank u fokusua në krijimin e një strategjie afatgjatë për transformimin e degëve, duke u përshtatur me lëvizjet dhe ndryshimet e tregut, me qëllim rritjen e produktivitetit, ridimensionimit të shërbimeve dhe rolit të stafit për të ofruar një ekperiencë të shkëlqyer për të gjithë klientët dhe një shitje sa më efektive.

Ky transformim përfshin thjeshtëzim të roleve në degë, duke u mundësuar klientëve disa shërbime në një vend pune, me qëllim rritjen e fleksibilitetit dhe shkurtuar kohën e qëndrimit në degë dhe rrjedhimisht duke optimizuar punën e degës.

Përgjatë vitit 2022 vazhdoi fokusi në investime për ndryshimin e hapësirave fizike të degëve, në rikostruksion të tyre, me standarde bashkëkohore dhe duke krijuar hapësira më moderne e më të orientuara me qendër klientët.

Përsa i përket punonjësve, gjatë vitit 2022 Union Bank vazhdoi fokusin në investimin dhe edukimin e vazhdueshëm të stafit të degës, për të ofruar një eksperiencë këshilluese për bazën e klientëve. Vazhduan trajnimet e ndryshme për zhvillimin e tyre profesional me fokus këshillimi dhe shërbimi efektiv kundrejt klientëve.

Prej disa vitesh Union Bank bashkëpunon me rrjetin e gjerë Union Net - Western Union duke ofruar shërbime bankare për klientët edhe në zona të vendit ku nuk ka mbulim me degë apo në orare më të zgjatura se orari zyrtar i Bankës. Falë këtij bashkëpunimi aktualisht kemi në disa nga këto agjenci punonjës që mundësojnë këshillim dhe shërbim për klientët, lidhur me nevojat e tyre financiare.

Aktualisht kemi bashkëpunim më shumë se 500 agjenci të Western Union - Union Net, ku ofrohet: pagesë kësht kredie, aplikim për kredi konsumatore, hipotekare dhe shërbimi ATM cash in/cash out.

Banka ka implementuar dhe strategjinë duke zhvilluar kanalet alternative, si edhe në ndërtimin e një rrjeti Omnichannel, gjatë viti 2022 janë zhvilluar tre modele biznesi të cilat kanë rritur prezencën tonë, ashtu si dhe shërbimin e klientit me produkte bankare jashtë dyerve tradicionale të bankës dhe jashtë orarit zyrtar.

## DEGA QENDRORE

Bulevardi "Zogu i I",  
Rr. "Sheshi Ferenc Nopçka",  
Nd. 5, H. 3, Tiranë  
Tel: +355 4 238 9085

## DEGA SHALLVARE

Rr. "Reshit Çollaku"  
Pallatet Shallvare 2/18,  
Tiranë  
Tel: +355 4 238 9169

## DEGA GARDA

Rr. "Dëshmorët e 4  
Shkurtit", Tiranë  
Tel: +355 4 238 9170

## DEGA BLOKU

Rr. "Ismail Qemali",  
Pallati nr. 32, Shk 1, Tiranë  
Tel: +355 4 238 9160

## DEGA LANA

Blv. "Bajram Curri",  
Rr. "Isuf Elezi", Nr.8/1, Tiranë  
Tel: +355 4 238 9163

## DEGA KINOSTUDIO

Rruga "Aleksandër Moisiu",  
Përballë ish- Kinostudios, Tiranë  
Tel: +355 4 238 9166

## DEGA MEDRESE

Rr. e Dibrës,  
Sheshi "Hafiz Ibrahim Dalliu",  
Tiranë  
Tel: +355 4 238 9164

## DEGA ALI DEMI

Rruga "Ali Demi"  
Tiranë  
Tel: +355 4 238 9162

## DEGA LAPRAKË

Rruga e Durrësit,  
Hyrja 1, Laprakë,  
Tiranë,  
Tel: +355 4 238 9168

## DEGA KRISTAL

Rr. "Medar Shtyllai"  
Kompleksi Kika1,  
Komuna e Parisit, Tiranë  
Tel: +355 4 238 9181

## DEGA TOPTANI

Rr. "Murat Toptani"  
(Eurocol Center), Tiranë  
Tel: +355 4 238 9158

## DEGA PIAZZA

Rr. "Ded Gjo Luli"  
Nr. 3, Tiranë  
Tel: +355 4 238 9157

## DEGA RRUGA E KAVAJËS

Rruga e Kavajës  
Nd. 50, H. 1, Tiranë  
Tel: +355 4 238 9159

## DEGA GJERGJ FISHTA

Bulevardi Gjergj Fishta  
Kompleksi Delijorgji  
Tel: +355 4 238 9130

## DEGA KAMËZ

Bulevardi "Blu",  
rrethrotullimi Kamëz  
Tel: +355 4 238 9167

## DEGA DURRËS 1

Rruga Tregtare, Durrës  
Tel: +355 4 238 9171

## DEGA DURRËS 2

Rruga "Kristaq Rama"  
Durrës  
Tel: +355 4 238 9172

## DEGA ELBASAN

Bulevardi "Qemal Stafa",  
Elbasan  
Tel: +355 4 238 9173

## DEGA KAVAJË

Shëtitorja "Josif Budo",  
Kavajë  
Tel: +355 4 238 9174

## DEGA RROGOZHINË

Lgj. Nr. 2, Pallati 82/3,  
Shk.1, Ap. 2, Rrogozhinë  
Tel: +355 4 238 9175

## DEGA FUSHË KRUIË

Sheshi "George W. Bush",  
Fushë-Krujë  
Tel: +355 4 238 9182

## DEGA LEZHË

Rr. "Besëlidhja", Lezhë  
Tel: +355 4 238 9184

## DEGA SARANDË

Rr. "Skënderbe",  
Lgj. 1, Sarandë  
Tel: +355 85 224 567

## DEGA SHKODËR

Lgj. "Vasil Shanto",  
Shkodër  
Tel: +355 4 238 9185

## DEGA KUKËS

Lgj. Nr. 5, Kukës  
Tel: +355 4 238 9180

## DEGA LUSHNJË

Shëtitorja "Kongresi i Lushnjës",  
Lushnjë  
Tel: +355 4 238 9186

## AGJENCIA DIVJAKË

Qendër Divjakë, Lushnjë  
Tel: +355 4 238 9187

## DEGA FIER

Sheshi "Fitorja", Rr. "Kastriot  
Muço", Fier  
Tel: +355 4 238 9176

## DEGA BERAT

Rr. "Antipatrea",  
Lgj. "22 Tetori", Berat  
Tel: +355 4 238 9188

## AGJENCIA POLIÇAN

Qendër, Poliçan, Skrapar  
Tel: +355 4 238 9189

## DEGA VLORË

Rr. "Sadik Zotaj", kryqëzimi me  
Rr. "Veledin Kollozi", Vlorë  
Tel: +355 4 238 9177

## DEGA POGRADEC

Lgj. Nr 1, Blv. "Rreshit Çollaku",  
Pogradec  
Tel: +355 4 238 9178

## DEGA KORÇË

Rr. "Ismail Qemali",  
Sheshi i Teatrit, Korçë



# MENAXHIMI I RREZIKUT



## 11. MENAXHIMI I RREZIKUT

Gjatë aktivitetit të saj të biznesit, Banka përpiqet të sigurojë një balancë optimale dhe të kujdesshme midis rrezikut dhe fitimit të realizuar. Për të realizuar këtë balancë, Banka ka krijuar një strukturë të përshtatshme për menaxhimin efektiv të rreziqeve duke identifikuar, matur, kontrolluar, monitoruar dhe zbutur ngjarjet që mbartin rreziqe potenciale të cilat mund të rezultojnë në humbje ose të pengojnë aftësinë e Bankës për të gjeneruar rezultate financiare të qëndrueshme. Banka kryen çdo vit rishikimin e profilit të saj të rrezikut, si dhe të politikave dhe të procedurave përkatëse.

Mbrojtja e parë e Bankës përkundrejt humbjeve nga çdo lloj rreziku bëhet e mundur nëpërmjet strukturaes së saj organizative, zbatimit të parimeve të shëndetshme të qeverisjes korporative si edhe respektimit të linjave të kontrollit të brendshëm. Të gjitha këto janë të integruara në modelin operacional të Bankës në gjitha nivelet.

Banka ka përpiluar politika dhe procedura të përshtatshme për menaxhimin e të gjithë rreziqeve që ndesh në çdo linjë biznesi në të cilën ajo operon. Politikat dhe procedurat përcaktojnë ndër të tjera edhe kriteret dhe limite për nivelin e rrezikut të pranuar. Linjat e biznesit, në bashkëpunim me strukturat e kontrollit dhe ato mbështetëse, planifikojnë aktivitetet e ushtruara dhe monitorojnë ecurinë e biznesit të Bankës për nga dimensionin e objektivave strategjike dhe operacionale por edhe vlerësimin e profilit të rrezikut dhe treguesve të tij.

Çdo departament, njësi, degë apo punonjës i Bankës janë të ndërgjegjshëm për kontributin e tyre në krijimin e vlerës së shtuar në biznes, brenda kornizave dhe niveleve të rrezikut të pranuar.

Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut i cili koordinon një sërë aktivitetesh qendrore për vlerësimin e rrezikut të Bankës dhe shërben si një qendër ekselence për promovimin e kulturës së rrezikut përgjatë gjithë linjave të biznesit zë një vend të veçantë në strukturën organizative të Bankës.

Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut raporton në mënyrë të pavarur pranë Komitetit të Kontrollit si dhe Këshillit Drejtues të Bankës, paralelisht me raportet e tjera menaxheriale.

Në nivel Drejtimi Ekzekutiv, Banka siguron një sistem të integruar të kontrollit të brendshëm duke përcaktuar përgjegjësi dhe struktura të dedikuara për fushat kryesore të veprimtarisë. Në këtë kontekst, komitetet në nivel drejtimi ekzekutiv të tilla si Komiteti i Menaxhimit të Aktiv dhe Pasivit, Komiteti i Kredisë, Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë, Komiteti i Rrezikut Operacional, Komiteti i Përputhshmërisë, Komiteti i Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës, Komiteti i Administrimit të Kolateraleve në Pronësi të Bankës, Komiteti i Menaxhimit të Rrjetit, Komiteti i Menaxhimit të Produkteve si edhe Komiteti i Teknologjisë së Informacionit kanë përgjegjësi primare në menaxhimin e risqeve të Bankës dhe vendimet taktike në këtë drejtim. Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut është gjithashtu i përfaqësuar por edhe referues në disa komitete të rëndësishme të Bankës si në Komitetin e ALCO-s, Komitetin e Rrezikut Operacional, Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë, Komitetin e Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës si edhe në Komitetin e Përputhshmërisë duke ofruar kështu një opinion të pavarur në fushat respektive. Departamenti koordinon dhe përditëson politikat e përshtatshme të rrezikut, parametrat e tij, si edhe metodologjitë në përputhje me kërkesat rregullative të Bankës së Shqipërisë, kuadrin ligjor, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Departamenti mban marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me të gjitha departamentet/njësitë e biznesit dhe drejtuesit e tjerë të Bankës. Ai zhvillon procese dhe mekanizma kontrollues efektive, praktike dhe inovatore për procesin e menaxhimit të rrezikut si dhe përgatit raportet përkatëse.

Duke konsideruar profilin dhe karakteristikat e biznesit, fushat kryesore të rrezikut të Bankës janë rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku nga normat e interesit, rreziku i kundërpatisë, rreziku i këmbimit valutor, rreziku operacional si edhe ai kibernetik. Performanca e çdo tipologjie rreziku është shpjeguar tek Pasqyrat Financiare në Raportin e Auditit. Në seksionin e mëposhtëm në pasqyrat financiare jepet një paraqitje e politikave, ku theksi kryesor është vendosur tek kontrolli dhe shmangia e rrezikut.

## 11. MENAXHIMI I RREZIKUT

### Politika e Menaxhimit të Rrezikut

Kjo politikë përshkruan risqet kryesore në të cilat Banka është ekspozuar si dhe parimet kryesore të proceseve të menaxhimit të rrezikut si dhe të skemës organizative.

### Politika e Kreditimit

Politika e Kreditimit është dokumenti bazë që përcakton parimet e menaxhimit të rrezikut të kredisë. Rreziku i Kredisë reduktohet nëpërmjet vlerësimit të kapacitetit financiar të klientit, kolateralit të mjaftueshëm si nivel i dytë mbrojtjeje, interesi i përshtatshëm bazuar në rrezik, strukturim dhe diversifikim efektiv i portofolit të kredive, kontroll i mjaftueshëm i Bankës në tërësi, etj.

Një pjesë e rëndësishme e procesit është monitorimi i vazhdueshëm si dhe përcaktimi i niveleve të përshtatshme të rezervave të caktuara për humbjet nga kreditë.

### Politika e Menaxhimit të Aktiv – Pasiveve

Politika e Menaxhimit të Aktiv-Pasiveve është dokumenti kryesor që drejton menaxhimin e aktiviteteve të aktiveve dhe pasiveve të Bankës, përfshirë të gjithë transaksionet me fondet, investimin e burimeve likuide dhe menaxhimin e risqeve të tjera financiare në bilancin e Bankës. Fushat kryesore që mbulon ky dokument janë menaxhimi i likuiditetit, menaxhimi i normave të interesit, menaxhimi i rrezikut të këmbimit valutor, etj.

Komiteti ALCO ka zhvilluar rregulla, procedura, instrumenta dhe mekanizma kontrolli për të menaxhuar në mënyrë të përshtatshme të gjithë risqet. Limitet e brendshme dhe rregullatore janë të mirëpërcaktuar dhe monitorohen rregullisht.

### Politika e Investimeve

Politika e Investimeve përcakton kriteret kryesore për menaxhimin e përgjegjshëm të investimeve financiare të Bankës në përputhje me strategjinë e saj të biznesit. Politika përcakton investimet e lejuara duke konsideruar rrezikun potencial që ato mbartin. Banka ka zhvilluar gjithashtu politika të tjera referuar investimeve dhe limiteve të rrezikut.

### Politika e Rrezikut të Kundërpartisë

Rreziku i ekspozimit me palët e tjera është trajtuar njësoj si rreziku i kredisë dhe aplikohet veçanërisht për ekspozimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare. Në këtë rast, përshtatshmëria e palëve të tjera si dhe limiteve përkatëse janë vlerësuar individualisht duke u bazuar në kriteret e caktuara dhe në metodologjinë përkatëse.

### Politika e Rrezikut Operacional

Rreziku Operacional ndodh për të gjithë produktet dhe shërbimet bankare dhe ndeshet çdo ditë me procesimin e transaksioneve. Ky lloj rreziku ndodh gjithashtu si rezultat i sistemeve të informacionit jo të përshtatshme, dështimin teknologjik, thyerjen e kontrolleve të brendshme, mashtrimeve ose ngjarjeve të paparashikuara, etj.

Kuadri i brendshëm rregullator i rrezikut operacional në Bankë (politikat dhe procedurat) përmbledh një përshkrim të qartë të rrezikut operacional përgjatë gjithë organizatës dhe një filozofi të vetëvlerësimit të proceseve të biznesit. Kjo politikë përfshin raportimin aktiv dhe monitorimin e indikatorëve kyç të rrezikut, analizat e shkakut të ngjarjeve të rrezikut operacional, përgjigjet e shpejta të incidenteve të ndodhura, vetëvlerësime të rregullta dhe frekvente, si dhe mirëmbajtje të kujdesshme dhe të përditësuara të programeve të vijueshmërisë së biznesit.

Komiteti i Rrezikut Operacional (KRO) monitoron periodikisht ngjarjet e humbjeve operationale dhe ka përcaktuar përgjegjësitë e duhura për të minimizuar humbjet dhe siguron zgjidhjet dhe mbulimet e rrezikut për aktivitetet që janë subjekt i rrezikut operacional.

## 11. MENAXHIMI I RREZIKUT

### Politika e Rrezikut Kibernetik

Banka ka rishikuar gjithë kuadrin e brendshëm rregullator për sigurinë kibernetike. Vitet e fundit është rritur shkalla e digjitalizimit në bankë. Rrjeti dhe sistemet nëpërmjet të cilëve garantohet shërbimi ndaj klientëve ka pësuar ndryshime pozitive në drejtim të digjitalizimit. Ndërkohë që rritja e nivelit të digjitalizimit të shërbimeve bankare sjellë dhe rritjen e rrezikut kibernetik. Banka në mënyrë të vazhdueshme synon që digjitalizimi i proceseve dhe shërbimeve të përshtatet më së miri në një linjë me sigurinë kibernetike të ofruar.

Banka ka shtuar ndjeshëm investimet e kryera në drejtim të rritjes së sigurisë kibernetike. Këto investime konsistojnë në mjete dhe shërbime shtesë të cilat janë të domosdoshme.

Ngelet një nga objektivat kryesore të bankës siguria e klientëve të saj si edhe mbrojtja e të dhënave të tyre personale.

### Politika e Përputhshmërisë

Në Politikën e Përputhshmërisë janë të renditura parimet bazë për t'u ndjekur nga menaxhimi dhe stafi i Bankës si edhe definimet dhe proceset kryesore mbi bazën e të cilave identifikohen dhe menaxhohen risqet kryesore përgjatë gjithë niveleve të organizatës.

Me anë të kësaj politike definojnë mënyrat më të mira me të cilat Banka siguron që të gjitha rregulloret/procedurat/politikat përkatëse të rëndësishme të jenë në përputhje me kërkesat rregullatore, ligjore si edhe me standardet më të mira lokale apo ndërkombëtare.

### Politika kundër pastrimit të parasë

Pastrimi i parave: përfshin konvertimin e qëllimshëm ose të pakujdesshëm të pasurisë, të krijuar nga "sjellja kriminale", në mënyrë që origjina kriminale e pasurisë të jetë e vështirë të gjurmohet.

Financimi i terrorizmit: Sigurimi ose grumbullimi i fondeve, me çfarëdo mënyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me qëllim përdorimin e tyre ose duke ditur se ato do të përdoren, tërësisht ose pjesërisht: për të kryer vepra për qëllime terroriste; nga një organizatë terroriste; nga një terrorist i vetëm.

Banka ka përshtatur plotësisht në kuadrin e saj të brendshëm rregullator të PPP-së kuadrin ligjor dhe rregullator të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë. Janë rishikuar politika dhe procedura të brendshme për PPP sipas amendamenteve të reja në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të miratuar në dhjetor 2021. Synohet gjithashtu zbatimi i standardeve ndërkombëtare të përcaktuara nga FATF e cila është organi global i përcaktimit të standardeve në fushën e PPP/FT.

Vlerësimet e rrezikut kryhen përmes identifikimit të faktorëve të rrezikut të PP dhe FT dhe vlerësimit të rreziqeve të identifikuara të PP dhe FT. Në vlerësimet e kryera përfshihen vlerësimi i rrezikut të klientit/transaksionit, vlerësimi i faktorëve të rrezikut, aktivitetet e biznesit ose profesionale të klientit, natyra dhe sjellja e klientit ose të pronarit përfitues, rreziku i vendit ose ai gjeografik etj.

Gjatë krijimit të marrëdhënieve me klientët, banka zbaton në mënyrë korrekte detyrimet e saj për të kryer Vigjilencën e Duhur sipas kriterëve të përcaktura në rregulloret e bankës duke ndjekur Vigjilencën e zgjeruara po atë të thjeshtuar. Raportimi i transaksioneve të dyshimta si element kryesor i kësaj fushe ndiqet me përparësi.

Trajnimet në Bankë për PPP/FT kryhen periodikisht. Trajnimet janë të përshtatura specifiku për rolin e departamentit AML si edhe trajnime të tjera të detyrueshme për të gjithë punonjësit e Bankës.

# BURIMET NJERËZORE, TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I STAFIT





## 12.2 ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Union Bank aplikon praktika të Burimeve Njerëzore, në përputhje të plotë me legjislacionin aktual të punësimit, me direktivat dhe rregullat qeveritare si dhe ato të brendshme, në lidhje me procesin e selektimit, rekrutimit, promovimit etj. Të gjitha politikat dhe praktikat janë të drejta, jo-diskriminuese, si dhe transparente për të dhënë mundësi barazie për të gjithë. Të gjithë punonjësit me kohë të plotë gëzojnë një paketë të plotë që përfshin të mira sociale, shëndetësore, apo të mira që lidhen me paaftësinë/pensionin, pushimet dhe festat, si dhe përfitime të tjera. Këto politika reflektojnë aktivitetin e përgjithshëm si biznes të Bankës lidhur me strategjinë dhe deklaratën e misionit. Planifikimi strategjik i punonjësve është i strukturuar në mënyrë të tillë që të inkurajojë zhvillimin e anëtarëve ekzistues të institucionit dhe të maksimizojë përpjekjet e tyre në eksplorimin e hapave të mëtejshëm në rrugën e tyre drejt karrierës, me kusht që ata të përmbushin dhe të shkojnë përtej detyrave aktuale.

Kultura organizative e Bankës përfshin një qasje transparente dhe proaktive në lidhje me standardet e etikës dhe ato profesionale, duke i prezantuar ato gjatë gjithë mjedisit të punës. Në termat e zhvillimit të punësimit dhe trajnimit, Banka mbështet një sjellje efikase dhe të përshtatshme, duke mbajtur me prioritet objektivat e biznesit.

Union Bank, në fund të 2022 kishte një numër total prej 447 punonjësish, me një përbërje prej 233 punonjësish në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 214 punonjës në rrjetin e degëve.

Qarkullimi total i punonjësve për vitin 2022 ishte 12.9%.

## 12.3 REKRUTIMI DHE PËRZGJEDHJA E STAFIT

Gjatë vitit 2022, procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes së stafit synoi përzgjedhjen e një stafi të kualifikuar, me eksperiencë dhe aftësi profesionale të duhura, për të përmbushur gjithë nivelet e shërbimit në bankë.

Për të mundësuar vazhdimësinë e procesit të përzgjedhjes dhe plotësimin të nevojave të biznesit është vijuar me intervista fizike me kandidatët potencialë, sigurisht edhe modaliteti online i intervistave ka vijuar rast pas rasti.

Për të mbështetur nevojat e biznesit në të gjitha fushat ku vepron, për vitin 2022 u punësuan në total 89 punonjës të rinj.

Me qëllim vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve dhe profesionistëve më të mirë për përmbushjen e nevojave të biznesit, ndiqet një proces rekrutimi i strukturuar që përmban disa faza si teste të ndryshme teknike/logjike, diskutim në grup kryesisht për pozicionet hyrëse në bankë si Shërbim Klienti, si dhe intervista individuale.

Në varësi të profilit të punës për vendin vakant, paneli është i përbërë nga Drejtuesit e Departamentit/ Degëve dhe përfaqësues nga Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Për vitin 2022 fokus ka qenë dhe promovimi dhe zhvillimi i punonjësve të brendshëm, që ka shërbyer si një mundësi zhvillimi dhe ndërtimi të një karriere të suksesshme brenda institucionit dhe në rritjen e motivimit tek punonjësit.

## 12.4 PROGRAMI I PRAKTIKËS

Union Bank nëpërmjet programit të praktikës synon të tërheqë studentë me rezultate shumë të mira, me dëshirë për të punuar dhe mësuar, dhe një vetëmotivim të lartë për t'u bërë pjesë e një mjedisi sfidues. Nëpërmjet programit të praktikës, banka mirëpret studentë nga të cilët evidentohen potenciale për punësim dhe njëkohësisht kontribuon në përgatitjen e tyre për tregun e punës. Union Bank vlerëson ambicien dhe vullnetin e të rinjve, duke iu ofruar transmetimin e përvojës nga punonjësit e saj. Po ashtu, i jepet rëndësi korrektësisë dhe përkushtimit të studentëve gjatë programit të praktikës, duke vlerësuar çdo mundësi për krijimin e një marrëdhënieje punësimi afatgjatë.

Për vitin 2022 numri total i praktikanteve ka qenë 42 studentë dhe 7 prej tyre janë punësuar në bankë.

## 12.5 TRAJNIMET DHE EDUKIMI I VAZHDUESHËM

Union Bank përveç përjasjes së saj për të tërhequr dhe përzgjedhur punonjësit më të mirë në treg, angazhohet ndaj zhvillimit dhe rritjes së aftësive profesionale dhe njohurive të tyre. Banka vlerëson programet e trajnimit dhe zhvillimit si një investim strategjik për arritjen e objektivave të biznesit.

Në Union Bank zhvillohen trajnime orientuese për të gjithë punonjësit e rinj që nga momenti kur bëhen pjesë e institucionit dhe vazhdohet më tej me trajnimin në punë, duke përfituar kështu në praktikë nga procedurat e përcaktuara dhe ekspertizat e kolegëve. Në këtë mënyrë, mundësohet një integrim sa më i lehtë dhe i shpejtë në vendin e punës.

Në lidhje me trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm gjatë punësimit, punonjësve u ofrohen mundësi të mëdha për zhvillim dhe kualifikim. Gjatë 2022, Banka ofroi një sërë programesh trajnimi dhe iniciativash të zhvillimit profesional, të cilat janë organizuar me lektorë nga burime të brendshme ose ekspertë të jashtëm. Konkretisht u zhvilluan rreth 105 seanca trajnimi, prej të cilave 36 të brendshme dhe 69 me bashkëpunëtorë të jashtëm. Plani vjetor i trajnimit reflektoi nevojat e njësive organizative të Bankës, që synojnë të rrisin apo të rifreskojnë njohuritë teknike ose kompetencat/aftësitë që nevojiten për të përballuar sfidat dhe përmbushur rezultatet dhe objektivat e vendosura. Në total 2953 ditë trajnimi janë zhvilluar në klasë dhe online dhe 100 % e stafit ka ndjekur të paktën një ditë trajnimi.

Modulet e zhvilluara mbulonin disa fusha teknike të punonjësve të rrjetit të degëve, duke përfshirë suksesin dhe efikasitetin e forcës së shitjes, produktet bankare, shërbimin UB Online, shërbimin e klientit, komunikimin dhe reagimin, aftësinë për të kryer shumë detyra në të njëjtën kohë, zgjidhjen e problemeve, rritjen e kapacitetit manaxherial dhe lidhshmëritë, etj. Janë zhvilluar një sërë trajnimesh për stafin në drejtorinë e përgjithshme kryesisht për: digjitalizimin, design thinking, digital marketing, mindfulness (vetëdija mbi mirëqënien e stafit), train the trainer, pjesëmarrje në konferenca /workshope organizuar nga BACEE, ATTF, etj. Po ashtu, janë zhvilluar edhe trajnimet e nevojshme periodike për sigurinë dhe shëndetin në punë, sigurinë e informacionit, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale, rreziku operacional dhe auditimi, përputhshmërinë dhe pastrimin e parave, rifreskim të produkteve bankare etj.

## 12.6 POLITIKAT E PAGESAVE

Komiteti i Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore është organi më i rëndësishëm në përcaktimin e incentivave dhe planit të kompensimit si pjesë e politikave të Burimeve Njerëzore. Ai miratohet nga **Këshilli Drejtues** dhe funksionimi i tij përcaktohet në rregulloren e komitetit.

Banka e konsideron këtë aspekt shumë të rëndësishëm pasi ka një ndikim domethënës në angazhimin, motivimin dhe sjelljen e punonjësve.

Banka zbaton rishikimet e pagës, duke përfshirë rishikimin fillestar, rishikimin e promovimit, rishikimin e performancës vjetore, me fokus kryesor në rishikimin e performancës me qëllim për të shpërblyer më të mirët. Të gjitha veprimet e kompensimit të performancës vijnë nga performanca e përgjithshme e Union Bank, performanca e njësisë individuale të biznesit, e matur me nivelin e arritjeve të objektivave të biznesit si dhe atyre individuale të punonjësve, e matur me procesin e vlerësimit të performancës.

Në Union Bank paketa totale e shpërblimit dhe mirënjohjes e cila përfshin pagën bazë nga njëra anë si dhe bonuset, përfitimet dhe kompesimet nga ana tjetër, shërbejnë si faktor kyç për punonjësit. Përveç pagës bazë si një përbërës fiks, Banka aplikon bonuse në raste të ndryshme, më kryesorja është e lidhur me arritjen e targetit dhe performancën në shitje. Bonusi kryesor është ai vjetor i performancës, bonusi bazuar në shitjet e tremujorit, bonuse për fushata specifike dhe bonusi i Vitit të Ri.

Anëtarët e Këshillit Drejtues paguhet me një shumë fikse vjetore për ushtrimin e funksionit si anëtar i Këshillit dhe një tarifë për ushtrimin e funksionit gjatë mbajtjes së mbledhjes së Këshillit Drejtues, paguar këto në baza tremujore. Shpërblimi për Drejtimin Ekzekutiv është i përbërë nga komponentë fiksë dhe të ndryshueshëm, bazuar në situatën financiare të Bankës, si dhe të performancës individuale të çdo divizioni.



## 12.7 RREZIKU DHE SIGURIA NË PUNË

Union Bank vlerëson dhe çmon sigurinë e punonjësve dhe e bën atë prioritet për të garantuar që Banka është një vend i sigurt për të punuar dhe për të bashkëvepruar me klientët. Gjithashtu, ka një përpjekje të vazhdueshme dhe një shfaqje përgjegjësie për ta bërë mjedisin e Bankës akoma më të sigurt, duke rritur kontrollet që mbrojnë informacionet e klientëve.

Një nga qëllimet kryesore të Bankës është të sigurojë shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e punonjësve të saj në Bankë dhe jo vetëm kaq. Përsa i përket përfitimeve, sigurimi i shëndetit i mundësuar nga Sigma InterAlbanian VIG është i rinovueshëm çdo vit për pothuajse të gjithë punonjësit, duke ofruar disa nga skemat më të mira që mbulojnë trajtimet mjekësore në një rrjet të gjerë klinikash dhe spitalësh të mirënjohura, në gjithë territorin e Shqipërisë.

# AKTIVITETET MARKETING DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE



## Programi i aktiviteteve dhe sponsorizimeve

Union Bank ka vijuar traditën ashtu si çdo vit për të qenë partnere dhe mbështetëse e aktiviteteve të lidhura me sportin, aktiviteteve vullnetare dhe çdo vit e më shumë është pranë eventeve që promovojnë vlera dhe që mbështetin veprimtari të ndryshme të lidhura me komunitetin. Gjatë vitit 2022, Banka vijoi fokusin drejt nismave që kanë në vëmendje brezin e ri, duke mbështetur jo vetëm aktiviteteve drejtuar atyre, por dhe duke i kushtuar një rëndësi të veçantë edukimit financiar dhe inovacionit. Gjithashtu Union Bank mbetet e angazhuar në mbështetjen e projekteve që promovojnë vlerat e artit dhe kulturës shqiptare.



## AKTIVITETE DHE SPONSORIZIME 2022



### Union Bank sponsor i Kombëtares Shqiptare të Futbollit

Union Bank edhe gjatë vitit 2022 ka vijuar mbështetjen e saj për Kombëtaren Shqiptare të Futbollit, si vazhdim i marrëveshjes me Federatën Shqiptare të Futbollit.

Ashtu si e ka traditë që në fillimet e aktivitetit të saj, Union Bank qëndroi besnike ndaj ekipit kuqezi nën moton #Gjithmonë me Kombëtaren, duke e suportuar atë në të gjitha sfidat dhe përballjet e organizuara gjatë të gjithë vitit.

### Union Bank mundëson rindërtimin e 4 shtëpive të dëmtuara nga tërmeti

Union Bank ka realizuar projektin e rindërtimit të 4 shtëpive të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Këto shtëpi ishin pjesë e shtëpive të dëmtuara në Njësinë Administrative Ndroq, ku dëmet e tërmetit ishin mjaft të mëdha. Këto banesa u rikonstruktuan tërësisht dhe u mobiluan me fondin e akorduar nga Union Bank në bashkëpunim edhe me Bashkinë e Tiranës. Këshilli Drejtues i Union Bank akordoi një fond për të ndihmuar familjet e dëmtuara nga tërmeti në vitin 2019 dhe këtij fondi iu bashkuan edhe kontributet e qytetarëve, klientëve dhe stafit të Union Bank.

Znj. Veipi gjatë ceremonisë së inaugurimit theksoi: "Jemi shumë të kënaqur që ky projekt përfundoi me sukses, duke bërë të mundur që këto familje të jetojnë në shtëpitë e tyre në kushte normale e komode. Prandaj dhe Union Bank e ndoqi këtë proces në çdo hap duke ju përmbytur të gjitha kërkesave dhe standardeve të nevojshme."

### Union Bank dhuron 600 pemë ulliri në kompleksin Mangalem 21

Union Bank ka dhuruar 600 pemë ulliri, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shtimin e hapësirave të gjelbërta cilat u mbollën në kompleksin e banimit Mangalem 21, ndërtuar nga kompania e ndërtimit Kontakt shpk. Projekti i dhurimit të pemëve të ullirit u realizua së bashku me këtë kompani me synimin e përbashkët për një jetë të shëndetshme në komunitet me gjelbërim dhe ajër të pastër.

Ky është një kontribut afatgjatë për banorët e këtij kompleksi, të cilët do të kenë mundësi të jetojnë jo vetëm në një kompleks modern banimi, por dhe të rrethuar nga gjelbërimi dhe ajri i pastër.

### Union Bank shton në flotën e saj 10 makina 100% elektrike

Union Bank gjatë vitit 2022 shtoi në flotën e saj të automjeteve 10 makina 100% elektrike, me synimin për ta shtuar këtë numër në vijim, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në reduktimin e emetimeve të karbonit dhe mbrojtjen e mjedisit. Makinat 100% elektrike reduktojnë me 100% përdorimin e karburantit dhe nuk emetojnë CO2, duke qenë zgjidhja më efektive për një ambient të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë.

### Union Bank seancë dhurim gjaku në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar

Union Bank ashtu si çdo vit, iu bashkua thirrjes për pjesëmarrje në seancën e dhurimit të gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemikë, duke përbushur nevojat e tyre për gjak, dhe duke vijuar të japë shembullin pozitiv për të gjithë ata që dëshirojnë të kontribuojnë në këtë kauzë të rëndësishme. Seanca e dhurimit u realizua në datë 13 qershor pranë ambienteve të Union Bank, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe në asistencën e mjekëve të palodhur të Bankës Kombëtare të Gjakut.

### Union Bank mbështet aktivitetin "Të drejta të barabarta për mundësi të barabarta"

Union Bank mbështeti për të dytin vit radhazi aktivitetin "Të drejta të barabarta për mundësi të barabarta" të organizuar nga shoqata "RESS-Egnatia", në bashkëpunim me Bashkinë e Elbasanit dhe Këshillin e Qarkut Elbasan.

Ashtu si dhe vitin e kaluar, ky event i organizuar kishte në qendër të tij angazhimin dhe përfshirjen e fëmijëve me çrregullim të spektrit autik (ÇSA) në aktivitete sociale dhe sportive. Rreth 200 fëmijë patën mundësi që për dy ditë rresht të merrnin pjesë në gara sportive dhe lojra të ndryshme, nën kujdesin e prindërve dhe instruktorëve të specializuar.

### Union Bank sponsor zyrtar i Colour Day Festival

Union Bank ishte sponsor zyrtar i Colourday Festival, festivalit rinor më të madh të organizuar në zemër të Tiranës, i cili u zhvillua gjatë muajit qershor në sheshin "Nënë Tereza".

Me një vizibilitet të lartë në media dhe rrjete sociale dhe mijëra pjesëmarrës, në këtë festival u organizuan aktivitete të shumëllojshme argëtuese për të gjitha moshat, lojra, shumë ngjyra dhe mbi 40 artistë shqiptarë e të huaj të cilët performuan në skenën e festivalit.

### Union Bank dhe Bashkia Tiranë marrëveshje për Kartën e Studentit 2 në 1

Union Bank solli në muajin tetor për herë të parë në treg Kartën e Studentit 2 në 1 në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe Agjencinë e Rinisë pranë saj.

Karta e Studentit 2 në 1 është një kartë unike që ofrohet për herë të parë për studentët, dhe është kartë debiti dhe njëkohësisht kartë studenti. Karta e studentit 2 në 1 u vjen në ndihmë studentëve që ta përdorin atë si kartë debiti si pagesa, blerje, etj., si dhe njëkohësisht të përftojë nga uljet që ofron si Kartë Studenti. Ajo është një produkt inovativ, që përshtatet jo vetëm me nevojat e studentëve por shërben dhe si një fillim i mirë në edukimin e tyre financiar dhe bankar.

Karta e Studentit 2 në 1 është zgjedhja më e mirë për studentët që studiojnë në të gjitha universitetet e Tiranës.

### Union Bank organizator i konkursit "Hackathon" në bashkëpunim me Protik Innovation Center

Union Bank në bashkëpunim me Protik Innovation Center organizuan konkursin 3-ditor "Hackathon". Në këtë aktivitet morën pjesë studentë, të cilët patën mundësi të propozojnë idetë e tyre për zhvillimin e sistemeve të bankës si dhe të njihen nga afër me stafin e profesionistëve nga Union Bank. Studentët pjesëmarrës në këtë projekt të ndarë në grupe, duke u konsultuar nga afër me stafin teknik të Union Bank, patën mundësinë të zhvillonin dhe prezantonin zgjidhje software të krijuara nga vetë ata, me qëllim automatizimin e proceseve të caktuara apo përmirësimin e eksperiencës së klientit për produkte dhe shërbime që banka ofron. Projektet e studentëve kaluan në një proces vlerësimi, nga i cili u përzgjedhën dy projekte fituese, të cilat u vlerësuan për origjinalitetin, zgjidhjen e ofruar si dhe prezantimin e projekt-idesë.

### Union Bank mbështetëse e "Good Start UP School" Shkodra

Union Bank ishte mbështetës i çmimeve për tre skuadrat fituese me idetë më të mira të prezantuara në "Good Start UP School" Shkodra, i cili u zhvillua në qytetin e Shkodrës me pjesëmarrjen e të rinjve nga 5 Bashkitë e Qarkut Shkodër. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte fuqizimi i të rinjve drejt sipërmarrjeve të suksesshme dhe përgatitja e tyre, duke nxitur rritjen e bizneseve të reja dhe absorbimin e metodologjive dhe praktikave më të mira të vendeve Europiane. Union Bank mbetet e angazhuar të mbështesë aktivitete të cilat kanë në fokus të rinjtë duke ju dhënë të gjithëve mundësinë për të zhvilluar dhe aplikuar idetë e tyre inovative në fushën e biznesit, si dhe në çdo fushë tjetër me interes për ta.

### Union Bank mbështetës i konkursit "Ndërto të ardhmen"

Union Bank ishte sponsor i Konkursit "Ndërto të Ardhmen" për diplomat më të mira të studentëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, i cili u organizua gjatë panairit "Build and Live Smart Expo 2022" organizuar nga Expocity Albania.

Union Bank mundësoi çmimet për 3 diplomat më të mira të paraqitura në këtë konkurs duke mbetur e angazhuar të mbështesë studentët në rrugëtimin e tyre për një të ardhme të suksesshme.

### Union Bank partner dhe pjesëmarrës në AgroTech Expo 2022

Union Bank ishte Partner Gold dhe pjesëmarrës në panairin AgroTech Expo 2022 që u organizua në dt. 24-26 nëntor në qendrën e panairove Expocity Albania. Union Bank është partner i zinxhirit të agrobiznesit agro duke ofruar produkte të dedikuara që Union Bank për të qenë sa më pranë nevojave të agrobizneseve dhe fermerëve, për investim dhe zgjerimin e aktivitetit të tyre.

### Union Bank sponsor i aktivitetit për fëmijë "Festojmë së bashku Krishtlindjen"

Union Bank ishte mbështetës i aktivitetit "Festojmë së bashku Krishtlindjen" i cili u zhvillua në formën e një maratone performancash artistike me pjesëmarrje të grupeve të të rinjve dhe fëmijëve artistë nga shkollat dhe qendrat artistike të Tiranës, të cilët kërcyen, kënduan dhe recituan, duke shprehur talentin dhe dëshirat e tyre.

### Union Bank sponsor i spektaklit muzikor "Tinguj Ballkani"

"Tinguj Ballkani" spektakli muzikor i mbështetur nga Union Bank i organizuar në datën 11 maj, solli në skenë për publikun e qytetit të Beratit, këngët dhe vallet e ballkanit nga nxënësit e talentuar të shkollës së mesme artistike "Ajet Xhindole".

Ky projekt i realizuar me sukses në bashkëpunim me Bashkinë Berat dhe Zyrën Arsimore Vendore të këtij qyteti, kishte për qëllim promovimin e traditës, historisë dhe kulturës së vendeve ballkanike në Shqipëri.

**DËSHIRONI T'I JEPNI MBËSHTETJEN TUAJ LIVE SKUADRËS SË ZEMRËS?**

*#gjithmonemeKombetaren*



**UNIONBANK**

*#gjithmonemeKombetaren*

*#pakushte*



**KARTAT UNION BANK**

**FESTONI DHE FITONI NË ÇDO BLERJE**

**1% CASHBACK PËR ÇDO BLERJE**

\*Kjo ofertë është e vlefshme deri në 31 dhjetor 2022.

unionbank.al +35542389111




**OFERTË PËR TË GJITHË MËSUESIT**

**Interes për kredi konsumatore**

- 0% Komision disbursimi
- 0 Komision për kartë krediti

unionbank.al +955 4 238 9111




**KREDIA AGRO**

**FINANCOJMË ZINXHIRIN E AGROBIZNESIT**

unionbank.al +35542389111




**KREDIA KONSUMATORE**

**FINANÇIM PËR ÇDO DËSHIRË TUJËN**

- Financim deri në 3 milion Lekë
- Këste mujore fikse
- Aprovim i menjëhershëm

unionbank.al 0800 0800






**PAKETA BIZNES PLUS**

**KRIJUAR PËR BIZNESIN TUAJ**

**PËRFITO KARTË KREDITI AUTOMATIKE**

- Llogari rrjedhëse
- Kartë Debiti
- UB Online

unionbank.al • +355 4 238 9111

**DEPOZITA PROGRES**

**ZGJIDHJA MË E MIRË PËR JU**

- Interes progresiv 5% në Lek dhe 3,6% në Euro
- Afati dori në 5 vite

unionbank.al • +355 4 238 9111

**PËRFITO 0 KOMISION ME KARTËN E RE TË KREDITIT**

**Përfitoni:**

- 0 komision leshimi për kartat e kreditit në Lek
- 0 komision mirëmbajtjeje për vitin e parë, për kartat e kreditit në Eur

unionbank.al • +355 4 238 9111

**Kartë Debiti & Kartë Studenti**

**#Jetplotngjyra**

AGJENCIA E RINISË TIRANA

**OFERTË PËR TË GJITHA GRATË**

**Interes për kredi konsumatore**

- 0% Komision disbursimi
- 0 Komision për kartë krediti

unionbank.al • +355 4 238 9111

**DEPOZITA INVEST**

**PËR JU QË KËRKONI MË TË MIRËN**

- Investoni fondet deri në 5 vite
- Përfitoni interesin çdo 6 muaj në llogari

unionbank.al • +355 4 238 9111

**LARMI ALTERNATIVASH INVESTIMI**

**Depozitoni fondet tuaja në Euro**

- Depozita me afat
- Llogari kursimi
- Llogari rrjedhëse

unionbank.al • +355 4 238 9111

**KREDIA KONSUMATORE**

**PËR ÇDO DËSHIRË TUAJËN**

- Financim deri në 3 milion lekë
- Këste mujore fikse
- Aprovim i menjëhershëm

unionbank.al • 0800 0800

**Kartë Studenti & Kartë Debiti**

**#Jetplotngjyra**

- Pagues me Kartën e Debitit
- Përfito uljet me Kartën e Studentit

AGJENCIA E RINISË TIRANA

# PLANET PËR VITIN 2023



## 14.1 PLANET STRATEGJIKE

Viti 2022 ishte një vit sfidues, e megjithatë Union Bank vijoi me sukses ecurinë dhe rritjen e aktivitetit bankar. Viti 2023 vendos përballë nesh objektiva më ambiciozë. Më kujdes ndaj një inflacioni që tashmë është më prezent dhe pritet të ketë zbutje por jo kthim në termat bazë të vendosura si objektiv nga Banka e Shqipërisë, ne do të vijojmë rritjen e kujdesshme duke maksimizuar elementët e fortë që banka ka ndërtuar në vite; një shërbim cilësor me fokus tek klienti, dhe një punë të vazhdueshme për të qenë gjithmonë të rëndësishëm në treg.

Sot gjithmonë e më shumë klienti kërkon një shërbim të shpejtë dhe duke qenë se shumica e shërbimeve bankare nuk kërkojnë prezencën e klientit në degë, ne po punojmë për realizimin e një **degë digjitale** duke pasur gjithmonë në fokus zhvillimet teknologjike, por edhe mbrojtjen nga risqet që ato mbartin.

Forcimi i Bankës ndaj **rrezikut kibernetik** sot është primar më shumë se kurrë. Në bashkëpunim dhe me aktorë të sektorit financiar dhe të mbrojtjes ndaj këtij rreziku, kemi investuar në shtimin njohurive në këtë sektor me prezencë në konferenca dhe diskutime me anëtarët e Shoqatës së Bankave. Gjithashtu kemi investuar në teknologji për të rritur mbrojtjen ndaj këtij rreziku, në trajnimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e punonjësve si dhe kemi rritur komunikimin për edukimin e klientëve në këtë drejtim.

Ky është një rrezik që prek të gjithë sektorin, prandaj dhe ka nevojë për fokus dhe mbrojtje në shumë drejtime, veçanërisht në edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për të kuptuar këtë rrezik dhe për të mos krijuar panik, në mënyrë që ky rrezik të ndalohet në kohë.

Procesi i automatizimit të shërbimeve, i cili ka filluar në vitin 2022, mbetet prioritet dhe do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023. Banka ka ndërmarrë një proces përmirësimi konstant që do të reflektohet si në anën strukturore ashtu edhe në një investim në trajnime për një grup të gjerë punonjësish.

**Fokusi tek punonjësit**, si partnerë të rëndësishëm në zhvillim, në vitin 2023 do të pasqyrohet në një rol më aktiv e në ndryshim të manaxhimit të nivelit të mesëm dhe shumë nivele ekspertësh që synojnë zhvillimin e karrierës në Union bank. Gjithashtu këtë vit planifikojmë për këtë grup punonjësish fillimin e një programi për Inovacion Konstant, i cili do të ketë në fokus komunikimin e vazhdueshëm të strategjive në këtë nivel, me qëllim rritjen e produktivitetit dhe të cilësisë, më shumë bashkëpunim, trajnime dhe skema më transparente shpërblymi dhe vlerësimi.

**Fokusi tek klienti**, një fjalë kyçe dhe prezence që orienton të gjithë strategjinë tonë, krijimin dhe ofrimin e produkteve si dhe komunikimin me klientët në vitin 2022, do të vijojë të ketë të një fokus dhe kujdes të veçantë edhe gjatë vitit 2023. Inflacioni solli një rritje të normave të interesit të kredisë si për kreditë e reja, por edhe për kreditë ekzistuese me normë të ndryshueshme, të cilat u prekën më shumë nga ri-çmimi i normës bazë. Këto ndryshime prekën pa dallim si klientë individë ashtu edhe klientë biznes duke u reflektuar në një rritje të konsiderueshme të kështit mujor të kredisë. Për këtë arsye, dhe me qëllimin që të mbrojmë klientin por edhe bankën në afatgjatë, Union Bank mori një vendim të brendshëm që i ngarkonte klientët me një rritje më të ulët të kështit, duke mbajtur në proporcion pjesën tjetër. Të sigurtë që klientët e kanë vlerësuar këtë iniciativë të bankës, jemi të bindur se kjo ka forcuar më tej lidhjen tonë me ta, por gjithashtu ka shtuar dhe kapacitetet analitike dhe vendimmarrëse në bankë.

**Zhvillimi teknologjik** mbetet zëri i dytë më i fortë në strategjinë tonë. Në fillim të vitit 2023 banka përfundoi një proces të gjatë dhe të rëndësishëm siç është kalimi në një sistem më të zhvilluar të Sistemit Kryesor të Bankës (CBS upgrade). Kjo u shoqërua me forcimin e divizionit të IT, shtimin e një strukture të re për manaxhimin e projekteve në këtë fushë si dhe aplikimin e metodologjisë Agile në projekte zhvillimi. Projekt tjetër shumë i rëndësishëm është kalimi në një variant më të ri të Platformës Digjitale të UB Online dhe implementimi i një infrastrukture më të zhvilluar në pajisjet kompjuterike dhe sistemin e tyre operativ.

<sup>9</sup> RPA- Robotic Process Automation.

## 14.1 PLANET STRATEGJIKE

Projekte të rëndësishme për ruajtjen e të dhënave (Data Warehouse) si dhe Module të reja për proceset e kreditimit dhe të marrëdhënieve me klientë biznesi fillojnë këtë vit. Qëllimi kryesor i këtyre projekteve është përmirësim dhe shpejtësi në procese, ruajtje e të dhënave dhe përdorimi i tyre në shumë dimensione, të cilat janë shumë të rëndësishme për një bankë të shekullit të 21-të ku efienca dhe cilësia e analizës janë të rëndësishme për vendime cilësore.

**Zhvillimi i punonjësve tanë** dhe fokusi tek ta është një nga kolonat kryesore të vizionit tonë. Krijimi i marrëdhënies afatgjatë me punonjësit është shumë i rëndësishëm prandaj dhe sjell nevojën për një përmirësim të politikës së zhvillimit të burimeve njerëzore. Ky proces përmirësimi ka kaluar disa etapa, dhe pritshmëritë janë që të sjellë një transparencë për pozicionet e punës, por dhe një shtysë për investim tek vetja nga të gjithë punonjësit tanë, në një ambient ku këto mundësi kanë hapësirë për t'u konkretizuar në një plan zhvillimi personal. Në vitin 2022 trajnimet e stafit u rritën në mesatarisht 6.9 ditë trajnimi për punonjës në vit dhe do të vijojë në këtë trend edhe në 2023. Është fakt tashmë që burimet njerëzore janë sfida më e madhe pas pandemisë. Mënyra e të punuarit në brezin e ri kërkon qasje të reja, breza të ndryshëm kanë kulturë të ndryshme pune çfarë bën që burimet njerëzore të kenë më shumë fokus dhe politikat për to të jenë fleksibël duke ofruar përfitime dhe mënyra pune që kanë në thelb njohjen e punonjësit. Një nga vlerat kryesore në Union Bank është të qenit proaktiv dhe të gatshëm për të vlerësuar atë që tregu na tregon, prandaj dhe e shohim realitetin me qartësi dhe e vlerësojmë me shumë përgjegjësi.

**Zhvillimi i kanaleve alternative** vijon të mbetet në fokusin tonë duke rritur numrin e ATM në 71 gjatë vitit 2023. Gjithashtu kemi investuar në një numër më të madh ATM që do të vendosen në zonat turistike, rreth 50 të tilla dhe planifikojmë deri në 100 ATM vitin tjetër, falë një bashkëpunimi me kompani me ekspertizë në këtë fushë dhe në rajon, bashkëpunim ky që do të bëjë të mundur një rritje të konsiderueshme të numrit të ATM-ve në vend, duke i dhënë më shumë akses klientëve tanë për të kyer veprime bankare në to.

Prezenca jonë vjen në një rrjet më të gjerë gjeografik edhe falë bashkëpunimit me Unionin Financiar Tiranë, i cili ka bërë të mundur që banka të vijë më afër klientëve edhe në ato zona ku Union Bank nuk është prezente me degë, si psh në zonën e Astirit, Kuçovë, Paskuqan, etj. Bashkëpunimi me UFT presim të kristalizohet këtë vit në një paketë shërbimesh për klientët tregtar duke ofruar më shumë mundësi shpërndarje të POS -ve (Point of Sale ) jo vetëm nëpërmjet kartave por dhe një portofoli digjital për të ulur kostot dhe rritur numrin e klientëve që përdorin kanalet alternative.

Të qenit pjesë e një grupi financiar ofron më shumë mundësi për ne nëpërmjet bashkëpunimit me kompani si Unioni Financiar Tiranë apo Paylink, duke e bërë Union Bank një mekanizëm zhvillimi në treg, që e sjell ndryshimin shpejt por dhe me kosto më të ulët për tregun.

## 14.2 PLANET DHE PERFORMANCA FINANCIARE

Union Bank synon të jetë një bankë dinamike në Shqipëri, e qëndrueshme financiarisht, me rritje konsistente dhe të kujdesshshme nga pikëpamja e rrezikut, lehtësisht e prekshme nga çdo qytetar dhe biznes shqiptar duke ofruar produkte dhe shërbime të një niveli shumë të lartë me një mbulim nëpërmjet një rrjeti të gjerë degësh, e alternuar plotësisht me kanalet alternative të rrjetit të ATM dhe mobile banking multifunksional.

Drejtimet kryesore, ku mbështetet edhe strategjia e zhvillimit dhe rritjes së Bankës, si dhe pritshmëritë për një ambient ekonomik relativisht stabil me një profil rreziku për sistemin financiar me tendenca rënëse, mbështesin pritshmëritë e rritjes së qëndrueshme të aktivitetit, ku parashikimet për të dhënat financiare të Union Bank për vitet në vazhdim pritet të mbeten të qëndrueshme.

## 14.2 PLANET DHE PERFORMANCA FINANCIARE

Viti 2023 pritet të shënojë arritje progresive në shumë aspekte të biznesit të Bankës, me lënien pas të efekteve të pandemisë, me qartësimin e impaktit të krizës së luftës në Ukrainë dhe menaxhimin e situatës inflacioniste në moderim të saj. Në këtë perspektivë, zhvillimet dinamike në tregjet e huaja dhe efektet e tyre në tregun vendas, e veçanërisht në sistemin bankar, do të vazhdojnë të mbeten në fokus të menaxhimit dhe Bordit drejtues.


Në përfundim të 2023, pjesa e tregut të Bankës pritet të kalojë nivelin e 5%, rritja e asetëve të Bankës gjatë 2023 pritet të jetë me mbi 85 milionë Euro, dhe fitimi rreth 9 milionë Euro, me një kthyeshmëri mbi kapitalin aksionar (ROE) me mbi 14%. Në vitet në vazhdim, kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROE) pritet të stabilizohet përkatësisht në range 14.7-15.2% çka tregon një performancë të pritshme të shëndoshë të Bankës edhe për vitet në vijim, duke realizuar fitime që do të suportonin rritjen e mëtejshme të Bankës.

Drejtoria e Bankës do të ndjekë strategjinë e mirëpërcaktuar tashmë, dhe do të zbatojë planet taktike për të arritur objektivat në një mjedis ekonomik dinamik dhe konkurrues. Banka do të vlerësojë gjithashtu mundësitë e tregut duke ju përgjigjur në kohë efekteve të pritshme nga ristrukturimi i vazhdueshëm i sektorit bankar, që e ka çuar numrin e bankave në 11, nga 16 që ishin para 4 vitesh.

Niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit parashikohet në nivele të larta, mbi 15.7% për vitin 2023 duke e kaluar nivelin e 17.5% në fund të vitit 2027, me synim respektimin në çdo kohë të kërkesave të brendshme dhe ato të vendosur nga Banka e Shqipërisë. Pavarësisht nga rritja e pritshme e aktivitetit të huadhënies, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit është rezultat i kredihënies cilësore dhe efijencës së Bankës, çka sjell fitim të mjaftueshëm për mbështetjen e rritjes së aktivitetit të saj. Në këtë aspekt Banka parashikon të kapitalizojë shumicën dërrmuese të fitimeve të saj dhe të vijojë edhe me emetimin e boxhit të varur, në nivelin 3.5-5 milionë Euro në vitet në vazhdim.

Po ashtu, Banka është, vazhdon dhe parashikon që të mbetet likuide përtej treguesve rregullator, duke ruajtur buffers që parashikojnë të përballojnë stres-teste konservative, tregues të cilët planifikohen dhe ndiqen në mënyrë periodike nga ana e saj.

Treguesit operacionalë të Bankës vijojnë përmirësimin e tyre ndër vite, siç paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm (vlerat në Euro '000)



## 14.2 PLANET DHE PERFORMANCA FINANCIARE

### Aktivitet

Totali i aktiveve të Bankës pritet të rritet me afro 11% gjatë vitit 2023. Synimet kryesore janë nga njëra anë përmirësimi i strukturës së bilancit drejt aktiveve që mbartin/sjellin interesa, raportit hua/depozita dhe marzhet e interesit neto, duke mbajtur në anën tjetër nivelin e likuiditetit dhe duke mbështetur rritjen e huadhënies dhe investimet në letrave me vlerë në nivelet e planifikuara.

Në anën tjetër gjatë vitit 2023 do të vazhdojnë projektet thelbësore që synojnë të zgjerojnë infrastrukturën IT të Bankës (hardware dhe software), përfshirë edhe finalizimin e përditësimit e sistemit bankar kryesor (core system) dhe automatizimin e programeve për monitorim dhe raportim të rreziqeve. Këto projekte shërbejnë dhe mbështesin planet e biznesit, monitorimin e rreziqeve dhe ndihmojnë në automatizimin dhe modernizimin e shumicës së operacioneve kryesore bankare në Zyrën Qendrore dhe në të gjithë rrjetin e degëve.

Në vitet në vazhdim, fokusi do të mbetet në rritjen e aseteve të Bankës, me rreth 10-11% në vit, brenda parametrave të cilësisë së kërkuar, duke ruajtur rrjetin e degëve dhe konsoliduar zhvillimin e kanaleve alternative, për të qenë sa më afër klientëve por edhe si një ndër kolonat e strategjisë së rritjes.

### Huadhënia

Për vitin 2023 Union Bank parashikon ta mbyllë me një rritje vjetore me mbi 13% Portofolin e saj të Huasë. Në vitet në vazhdim, rritja pritet të mbetet dyshifrore, në nivelin 12.5-13.5%.

Rritja e parashikuar synon të konsolidojë portofolin ekzistues si dhe të zgjerohet në klientë të rinj, duke gjeneruar rritje me fokus në segmentet e konsumatorit dhe në Bizneset e Vogla e të Mesme. Kujdesi i veçantë do të tregohet me cilësinë e portofolit i cili ka rëndësi parësore në ruajtjen e stabilitetit dhe përfitueshmërisë së Bankës. Performanca e huadhënies pritet të ndikohet nga kushtet makroekonomike dhe globale që kanë ndikuar së fundmi drejtëpërdrejtë në një rritje të çmimeve për bizneset dhe konsumatorët, duke luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen por edhe cilësinë e portofolit.

Në këtë kuadër, Banka vlerëson dhe monitoron rregullisht të gjitha ekspozimet dhe rreziqet, duke synuar edhe që të ruajë cilësinë e mirë të portofolit të kredisë.

Fushatat e marketingut, krahas strategjive të tjera të shitjes do të bëjnë përpjekje maksimale për të mbështetur objektivat e rritjes, veçanërisht drejt segmenteve të kredive konsumatore, hipotekare por edhe atyre të biznesit. Huadhënia parashikohet të jetë tek individët dhe bizneset, në shërbim të klientelës ekzistuese dhe asaj të re. Procesi i huadhënies do të vazhdojë të mbështesë të gjithë sektorët e ekonomisë, brenda limiteve sektoriale të vendosura nga Banka, duke rritur përpjekjet e shitjeve të kryqëzuara (cross-sell).

### Financimi

Banka financohet kryesisht nëpërmjet fondeve të klientëve në formën e depozitave, nëpërmjet një bazë të gjerë retail, me një diversitet monedhash dhe maturimesh, dhe shpërndarje gjeografike. Për vitin 2023 rrjeti i Union Bank synon të rrisë Fondet e Klientëve me rreth 10%. Segmentet që do të pësojnë rritjen më të madhe në terma absolute, pritet të jetë ai i depozitave me afat dhe i llogarive rrjedhëse, me fokus pak më të madh në depozitat me afat. Kjo pasi rritja e normave të interesit ka bërë që depozitat me afat të kenë një rol më të rëndësishëm në zgjerimin e fondeve në krahasim me trendin e viteve të mëparshme.

Struktura e fondeve do të monitorohet gjithashtu me shumë kujdes, veçanërisht monedhave Euro dhe Lek, të cilat mund të kenë një ndikim të drejtëpërdrejtë në strukturën e aktiv/pasivit të Bankës dhe për rrjedhojë edhe të investimeve dhe rezultatit të saj. Së fundmi rritja e investimeve të publikut në letra me vlerë, bën që një vëmendje e veçante ti kushtohet fondeve në Lek. Banka ka një strukturë të balancuar në raportin Lekë-valutë (43%-57%), raport i cili mundëson diversifikim dhe rritjen e kreditimit dhe investimeve në tituj në valuta të ndryshme, këto në varësi të oportuniteteve dhe në kuadër të përmirësimit struktural të aseteve të Bankës.

## 14.2 PLANET DHE PERFORMANCA FINANCIARE

Strategjia e çmimit të produkteve është e lidhur ngushtë me qëllimet kryesore të Bankës për rritje të bazës së saj të klientelës, rritjes së vazhdueshme të pjesës së tregut dhe nevojën për të mbështetur investimet/kreditimin, paralelisht këto me profitabilitetin dhe vetëqëndrueshmërinë e saj. Politika e çmimeve të produkteve do të monitorohet ngushtësisht në mënyrë që të ruhet diferenca mbështetëse e përfitueshmërisë tek marzhi neto i interesave, një sfidë tjetër kjo që vjen me rritjen e kostos së fondeve dhe shtimit të interesit të klientëve në alternativa të tjera investimi.

Fushatat dhe përpjekjet e parashikuara në mbështetje të rritjes së këtij komponenti bazë të aktivitetit, për zbatimin e strategjisë, së pari do të konsistojnë në mbështetjen e gamës kryesore të produkteve, dhe më tej në përmirësimin dhe gjetjen e mënyrave për krijimin e karakteristikave të reja ose hibride të produkteve.

Krahas depozitave të klientëve, Banka synon edhe marrjen e disa linjave kreditore afatmesme për financim të aktivitetit kredihënies si dhe përdorimi i mundësive të ofruara në tregut të parasë, kjo e fundit kryesisht për të menaxhuar likuiditetin dhe optimizuar kostot.





# Përmbajtja

OPINIONI I AUDITUESIT TË PAVARUR		
PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR		
		1
PASQYRA E VEÇANTË E FITIM HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE		
		2
PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR		
		3
PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE		
		4
1.	HYRJE	5
2.	BAZA E PËRGATITJES	6
3.	NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHËNIMET SHOQËRUESE	7
4.	POLITIKAT KRYESORE KONTABËL	7
5.	PËRDORIMI I VLERËSIMEVE, GJYKIMEVE DHE SUPOZIMEVE	25
6.	ARKA DHE LLOGARI ME BANKËN QENDRORE	27
7.	DEPOZITA DHE LLOGARI ME BANKAT	28
8.	LETRAT ME VLERË TË INVESTIMIT	29
9.	HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT	32
10.	INVESTIME NË FILIALE	37
11.	AKTIVE TË PATRUPËZUARA	38
12.	AKTIVE TË TRUPËZUARA	39
13.	AKTIVET ME TË DREJTË PËRDORIMI DHE DETYRIME PËR QIRATË	40
14.	INVESTIMI NË PASURI TË PALUAJTSHME	41
15.	AKTIVE TË MARRA NË PRONËSI	42
16.	AKTIVE TË TJERA	43
17.	DETYRIME NDAJ BANKËS QENDRORE	43
18.	DETYRIME NDAJ BANKAVE DHE INSTITUCIONEVE FINANCIARE	44
19.	DETYRIME NDAJ KLIENTËVE	45
20.	DETYRIME TË TJERA	47
21.	BORXH I VARUR	47
22.	KAPITALI AKSIONAR	48
23.	TË ARDHURAT NGA INTERESAT	49
24.	SHPENZIMET PËR INTERESA	49
25.	TË ARDHURAT NGA KOMISIONET	49
26.	SHPENZIMET PËR KOMISONE	49
27.	SHPENZIMET NETO PËR ZHVLERËSIM TË AKTIVEVE FINANCIARE	50
28.	FITIMI NGA SHITJA E AKTIVEVE FINANCIARE TË MATURA ME KOSTON E AMORTIZUAR	50
29.	RËZULTATI NETO NGA VEPRIMET VALUTORE	50
30.	TË ARDHURA TË TJERA, NETO	50
31.	SHPENZIME PERSONELI	51
32.	SHPENZIME TË TJERA ADMINISTRATIVE	51
33.	TATIMI MBI FITIMIN	52
34.	ANALIZA E MATURITETIT TË AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE	54
35.	INFORMACION SHITESË MBI PASQYRËN E FLUKSIT TË PARASË	55
36.	VEPRIMET ME PALËT E LIDHURA	55
37.	ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME	58
38.	ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR	60
39.	PARAQITJA DHE VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË	82
40.	MENAXHIMI I KAPITALIT	83
41.	NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	84

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Union Bank sh.a.

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të veçanta

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Union Bank sh.a. (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e veçantë e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2022, pasqyrën e veçantë e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e veçantë e ndryshimeve në kapitalin aksionar dhe pasqyrën e veçantë e flukseve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

### Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Informacione të tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2022 të Union Bank sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2022, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare të veçanta dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2022 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare të veçanta nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të veçanta, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare të veçanta apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

## **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Veçanta**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## **Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të veçanta.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare të veçanta, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të veçanta, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të veçanta, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Union Bank sh.a., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar**  
Dega në Shqipëri

*Ernst & Young Albania*  
31 maj 2023  
Tiranë, Shqipëri



**Mario Vangjel**  
Auditues Ligjor


*Mario Vangjel*

PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR

Vlerat në'000 Lekë

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Aktivët</b>			
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	6	13,332,652	9,482,635
Depozita dhe llogari me bankat	7	5,144,143	4,976,596
Investime në letra me vlerë – VDFH (Tregtimi)	8	72,867	-
Investime në letra me vlerë - VDATGJ	8	679,413	851,106
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	8	28,393,425	26,844,825
Hua dhe paradhënie për klientet	9	41,679,420	35,695,462
Tatim fitim i parapaguar	33	38,071	-
Aktive të tjera	16	317,771	431,428
Aktive të marra në pronësi	15	239,040	324,344
Investim në pasuri të paluajtshme	14	429,105	468,283
Investime në filiale	10	161,002	161,002
Aktive të patrupëzuara	11	325,169	231,235
Aktive të trupëzuara	12	476,122	469,059
Aktive me të drejtë përdorimi	13.1.1	514,985	527,648
Aktive tatimore të shtyra	33	48,830	29,197
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>91,852,015</b>	<b>80,492,820</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	17	6,868,994	2,693,411
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	18	6,855,970	6,121,767
Detyrime ndaj klientëve	19	68,762,107	63,215,713
Detyrime të tjera	20	518,565	531,797
Detyrime për qiratë	13.1.2	585,825	629,364
Detyrime tatimore	33	-	68,575
Borxh i varur	21	808,173	487,866
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>84,399,634</b>	<b>73,748,493</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	22	3,883,813	2,717,813
Primi i aksioneve	22	175,600	175,600
Rezerva ligjore dhe të tjera	22.1	941,502	894,676
Rezerva për vlerën e drejtë		(107,726)	1,937
Fitimi i akumuluar		2,559,192	2,954,301
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>7,452,381</b>	<b>6,744,327</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>91,852,015</b>	<b>80,492,820</b>

Këto pasqyra të veçanta financiare janë aprovuar nga Drejtimi Ekzekutiv me 27 mars 2023 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

  
 Suela Bokshi  
 Zv/ Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



  
 Arten Zikaj  
 Drejtor i Divizionit të Financës

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 84, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave të veçanta financiare.

**PASQYRA E VEÇANTË E FITIM HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE**

Vlerat në '000 Lekë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga interesat	23	3,645,570	3,189,305
Shpenzime për interesat	24	(717,666)	(619,800)
<b>Të ardhura neto nga interesat</b>		<b>2,927,904</b>	<b>2,569,505</b>
Të ardhura nga komisionet	25	565,172	432,909
Shpenzime për komisionet	26	(106,572)	(105,779)
<b>Të ardhura neto nga komisionet</b>		<b>458,600</b>	<b>327,130</b>
Shpenzimet neto nga zhvlerësimi i aktiveve financiare	27	(384,668)	(217,540)
Fitimi neto nga tregëtimi	28	(3,076)	-
Fitim nga shitja e aktiveve financiare -VDATGJ	8	-	33,730
Rezultati neto nga veprimet valutore	29	20,151	112,330
Ndryshimi i vlerës së drejtë të investimeve në pasuri të paluajtshme	14	(19,598)	204
Të ardhura nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme	13.2	1,801	17,327
Të ardhura nga dividendi	10	27,000	38,571
Të ardhura të tjera, neto	30	125,173	134,054
Ndryshimi i vlerës së realizueshme të aktiveve të marra në pronësi	15	(9,214)	(10,823)
Shpenzime të tjera për provigjone		-	(25,358)
Amortizimi i aktiveve të trupëzuara	11	(47,605)	(43,611)
Amortizimi i aktiveve të trupëzuara	12	(89,887)	(68,827)
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	13.2	(153,388)	(145,530)
Shpenzime personeli	31	(774,176)	(651,852)
Shpenzime të tjera administrative	32	(988,473)	(831,917)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>1,090,544</b>	<b>1,237,393</b>
Tatimi mbi fitimin	33	(172,827)	(203,943)
<b>Fitimi vitit</b>		<b>917,717</b>	<b>1,033,450</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse, neto nga tatimi		(109,663)	(23,696)
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>808,054</b>	<b>1,009,754</b>

Këto pasqyra të veçanta financiare janë aprovuar nga Drejtimi Ekzekutiv me 27 mars 2023.

Pasqyra e veçantë e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 84, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave të veçanta financiare.

**PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR**

Vlerat në '000 Lekë

Shënime	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore dhe të tjera	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i akumuluar	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2021</b>	<b>2,717,813</b>	<b>175,600</b>	<b>769,162</b>	<b>25,633</b>	<b>2,121,365</b>	<b>5,809,573</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	1,033,450	<b>1,033,450</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimi	-	-	-	(23,696)	-	<b>(23,696)</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(23,696)</b>	<b>1,033,450</b>	<b>1,009,754</b>
<b>Veprimet me pronarët regjistruar direkt në kapital</b>						
Kontribut për rritjen e kapitalit	-	-	-	-	-	-
Krijimi i rezervave të tjera	22.1	-	125,514	-	(125,514)	-
Dividentet e shpërndarë	22	-	-	-	(75,000)	<b>(75,000)</b>
<b>Totali i kontributeve të dhe për pronarët</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>125,514</b>	<b>-</b>	<b>(200,514)</b>	<b>(75,000)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>2,717,813</b>	<b>175,600</b>	<b>894,676</b>	<b>1,937</b>	<b>2,954,301</b>	<b>6,744,327</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	917,717	<b>917,717</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimi	-	-	-	(109,663)	-	<b>(109,663)</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(109,663)</b>	<b>917,717</b>	<b>808,054</b>
<b>Veprimet me pronarët regjistruar direkt në kapital</b>						
Kontribut për rritjen e kapitalit	1,166,000	-	-	-	(1,166,000)	-
Krijimi i rezervave të tjera	22.1	-	46,826	-	(46,826)	-
Dividentet e shpërndarë	22	-	-	-	(100,000)	<b>(100,000)</b>
<b>Totali i kontributeve të dhe për pronarët</b>	<b>1,166,000</b>	<b>-</b>	<b>46,826</b>	<b>-</b>	<b>(1,312,826)</b>	<b>(100,000)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>3,883,813</b>	<b>175,600</b>	<b>941,502</b>	<b>(107,726)</b>	<b>2,559,192</b>	<b>7,452,381</b>

Këto pasqyra të veçanta financiare janë aprovuar nga Drejtimi Ekzekutiv me 27 mars 2023. Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapitalin aksionar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 84, të cilat janë pjesë përberese të këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

**PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE**

Vlerat në '000 Lekë

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>Flukset e parasë nga aktiviteti operativ:</b>		
Fitimi para tatimit	1,090,544	1,237,393
<b>Rregullime për zërat jo-monetare:</b>		
Të ardhura nga interesat	23 (3,645,570)	(3,189,305)
Shpenzime për interesat	24 717,666	619,800
Amortizimi i aktiveve të trupëzuara	12 89,887	68,827
Amortizimi i aktiveve të patrupëzuara	11 47,605	43,611
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	13.1 153,388	145,530
Të ardhura nga dividendi	10 (27,000)	(38,571)
Humbje neto nga zhvlerësimi i kredive	27 384,668	217,540
Ndryshimi i vlerës së realizueshme të aktiveve të marra në pronësi	15 9,214	10,823
Ndryshimet e vlerës së drejtë të investimeve në pasuri	14 19,598	(204)
Të ardhura nga çregjistrimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	13.2 (421)	(10)
Fitimi/humbje nga ndryshimi në vlerën e drejte	5,157	-
Provizione për shpenzime të tjera	24 (17,961)	25,358
Efektet e rivlerësimit	510,800	(59,820)
Fitimi neto nga shitja dhe fshirja e aktiveve të trupëzuara	(287)	4,797
Fitim/humbja neto nga shitja e aktiveve të marra në pronësi	40,062	11,081
	<b>(622,650)</b>	<b>(903,150)</b>
<b>Ndryshimet në:</b>		
Depozita dhe llogari me bankat	(1,373,304)	(1,202,742)
Hua dhe paradhënie për klientët	(6,282,449)	(4,260,434)
Aktive të tjera	131,549	(24,088)
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	734,149	790,831
Detyrime ndaj klientëve	5,536,022	7,401,045
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	4,168,788	(753,215)
Detyrime të tjera	12,049	61,437
Arkëtime nga shitja e aktiveve të marra në pronësi	65,482	73,482
Interesi i arkëtuar	3,576,413	3,160,704
Interesi i paguar	(696,708)	(611,927)
Tatim fitimi i paguar	(279,775)	(115,690)
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktiviteti operativ</b>	<b>4,969,566</b>	<b>3,616,253</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese:</b>		
Blerja e aktiveve të patrupëzuara	11 (141,539)	(118,796)
Blerja e aktiveve të trupëzuara	12 (105,336)	(151,096)
Arkëtime nga shitja e aktiveve të trupëzuara	8,673	8,442
Arkëtime nga shitja e investimeve në pasuri	26,500	-
Rritje në investimin në letra me vlerë	35 (1,784,001)	(2,826,140)
Dividentë të arkëtuar	10 -	38,571
Arkëtime nga investimet në qira neto	6,661	6,379
<b>Paraja neto e përdorur për aktivitetet investuese</b>	<b>(1,989,042)</b>	<b>(3,042,640)</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese</b>		
Dividentë të paguar	22 (100,000)	(75,000)
Ripagimet e detyrime për qira	13 (152,427)	(140,797)
Borxhi i varur	35 316,570	235,640
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese</b>	<b>64,143</b>	<b>19,843</b>
<b>Rritje neto në para dhe ekuivalentet e saj gjatë vitit</b>	<b>3,044,667</b>	<b>593,456</b>
Efkti i rivlerësimit të parasë dhe ekuivalentëve të saj	(376,669)	23,311
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit</b>	<b>8,222,824</b>	<b>7,606,057</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit</b>	<b>10,890,822</b>	<b>8,222,824</b>

Këto pasqyra të veçanta financiare janë aprovuar nga Drejtimi Ekzekutiv më 27 mars 2023.

Pasqyra e veçantë e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 84, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

**1. HYRJE**

Union Bank Sh.a. (“Banka”) është një institucion financiar i regjistruar si bankë tregtare më 9 janar 2006 bazuar në Vendimin nr. 101, datë 28 dhjetor 2005 të Bordit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (BSH). Aktiviteti i Bankës i nënshtrohet Ligjit nr. 8269 datë 23 dhjetor 1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 9662 datë 18 dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” si dhe në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Banka është një bankë tregtare, e cila ofron shërbime bankare për individë dhe kompani në Republikën e Shqipërisë. Banka është regjistruar si shoqëri aksionare me numër regjistrimi 33563 datë 26 maj 2005, datë në të cilën Banka filloi aktivitetin e saj tregtar. Banka mori licencën për aktivitete bankare më 9 janar 2006.

Bazuar në marrëveshjen e shitblerjes të nënshkruar më shtator 2014, në 22 dhjetor 2014, Banka bleu 100% të aksioneve të Landeslease Sh.a. (“Filiali”), dhe është aksionari i vetëm i këtij institucioni financiar. Filiali është një shoqëri lizingu shqiptar, e regjistruar si një shoqëri aksionare, e cila u regjistrua dhe filloi të operonte më 5 prill 2005.

Më 1 nëntor 2018, Banka nënshkroi një marrëveshje shitblerjeje me aksionarët e Bankës Ndërkombëtare Tregtare sha (‘BNT’) për blerjen 100% të aksioneve të BNT, një bankë shqiptare, e regjistruar si shoqëri aksionare më 1996 dhe e licencuar më 20 shkurt 1997. Blerja u finalizua më 20 mars 2019, pas marrjes së miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë në datën 18 mars 2019. Rregjistrimi i aksioneve të BNT në qendrën Kombëtare të Biznesit u krye me 27 mars 2019. Bashkimi ligjor dhe operacional u finalizua në datën 1 gusht 2019 (“Data e Bashkimit”).

Këto pasqyra janë pasqyra financiare të veçanta të Bankës (“Mëma”). Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare të veçanta kërkohet nga legjislativi tatimor vendas. Përveç këtyre pasqyrave, Banka përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me kërkesat e SNRF 10. Ato pasqyra financiare të konsoliduara janë të Bankës dhe Filialit të saj (së bashku “Grupi”). Pasqyrat financiare të Filialit përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara duke filluar nga data në të cilën fillon ushtrimi i kontrollit të Bankës mbi të e deri në datën në të cilën ky kontroll pushon së ekzistuari (shih Shënimin 2.5).

Më 31 dhjetor 2022 Banka operonte me një rrjet prej 32 degësh dhe agjencish (31 dhjetor 2021: 32) në të gjithë Shqipërinë. Selia qendrore e Bankës ndodhet në Tiranë, Shqipëri

**Drejtuesit dhe administrimi i Bankës më 31 dhjetor 2022***Bordi Drejtues (Këshilli Mbikëqyrës)*

Edmond Leka	Kryetar
Niko Leka	Zv.Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anëtar
Henry Russell	Anëtar
Flutura Veipi	Anëtar (dhe Drejtor i Përgjithshëm)
Gazmend Kadriu	Anëtar
Teuta Baleta	Anëtar
Kreshnik Dibra	Anëtar

*Komiteti i Kontrollit*

Teuta Baleta	Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anëtar
Sonila Bicaku	Anëtar

Znj. Teuta Baleta u emërua Kryetar i Komitetit të Kontrollit më 24 janar 2022.

*Drejtimi Ekzekutiv*

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm
Suela Bokshi	Zv/Drejtor i Përgjithshëm dhe Drejtor i Divizionit të Operacioneve



## **2. BAZA E PËRGATITJES**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat e veçanta financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

### **2.2 Baza e përgatitjes**

Banka paraqet pasqyrën e saj të veçantë të pozicionit financiar sipas likuiditetit bazuar në synimin dhe aftësinë e perceptuar të Bankës për të rikuperuar/shlyer pjesën më të madhe të aktiveve/detyrimeve të zërit përkatës të pasqyrës financiare. Një analizë në lidhje me rikuperimin ose shlyerjen brenda 12 muajve nga data e raportimit (aktuale) dhe më shumë se 12 muaj pas datës së raportimit (jo-aktuale) është paraqitur në Shënimin 34.

Pasqyrat financiare të veçanta të Bankës janë përgatitur mbi bazën e kostos historike me përjashtim të Pasurive të paluajtshme të mbajtura për investim, Letrat me Vlere me VDFH dhe Letrat me vlerë me VDAGJ të cilat matën me vlerën e drejtë dhe inventarëve të kolateraleve të marra në pronësi të cilat matën me më të voglën midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

### **2.3 Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit**

Këto pasqyra financiare të veçanta të Bankës janë paraqitur në Lek Shqiptar (Lek), e cila është monedha funksionale e Bankës. Gjithë informacioni i paraqitur në Lek është rumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur është shprehur ndryshe.

### **2.4 Vijueshmëria**

Drejtimi i Bankës ka vlerësuar aftësinë e tij për të vazhduar në vijimësi dhe është i kënaqur që ka burimet për të vazhduar biznesin për të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, drejtimi nuk është në dijeni për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar si vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare të veçanta vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e parimit të vijueshmërisë.

### **2.5 Pasqyrat financiare të veçanta**

Banka e regjistron investimin në Filialin e saj (Shënimi 1 dhe Shënimi 10) me kosto. Banka njej dividendet e marrë nga Filiali në fitim ose humbje në pasqyrat e saj financiare të veçanta kur e drejta për të marrë dividendet është përmbushur. Banka ka aplikuar të gjitha SNRF-të në fuqi në paraqitjen e shënimeve sqaruese në pasqyrat financiare të veçanta.

Banka plotëson kriteret e përjashtimit të SNRF 10 për të mos përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara që përfshijnë filialet e saj, pasi konsolidohet më tej nga mëma (aksionari fundor), Unioni Financiar Tirana.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në baza të veçanta (të pakonsoliduara), në përputhje me legjislacionin tatimor në Republikën e Shqipërisë. Banka vullnetarisht përgatit pasqyra financiare të konsoliduara që përfshijnë dhe filialin e saj, të cilat mund të gjenden në adresën elektronike të Bankës: <https://unionbank.al/>. Informacion mbi treguesit financiarë kryesorë të filialit para konsolidimit jepet në shënimin 10.

Filialet janë investime të kontrolluara nga Banka. Banka ‘kontrollon’ një investim nëse është i ekspozuar ndaj, apo ka të drejta mbi kthimin e ndryshueshëm nga përfshirja në investim dhe ka mundësinë për të ndikuar mbi këtë kthim nëpërmjet pushtetit të tij mbi investimin. Banka rivlerëson nëse ka kontroll nëse ka ndryshuar një apo më shumë nga elementët e kontrollit. Këto përfshijnë rrethana në të cilat të drejtat mbrojtëse të patura (psh. ato që rezultojnë nga një marrëdhënie kredidhënie) bëhen të rëndësishme dhe bëjnë që Banka të këtë pushtet mbi investimin.

Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare të veçanta duhet t’i lexojnë së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankës për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2022, në mënyrë që të sigurojnë një informacion të plotë mbi pozicionin financiar, rezultatet operacionale dhe ndryshimeve në pozicionin financiar të Bankës si një të tërë.

### **2.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën ndodh rishikimi dhe në periudhat e ardhshme që afektohen/preken nga këto ndryshime.

## **2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)**

### **2.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

Drejtimi beson se vlerësimet dhe supozimet bazë janë të duhura dhe se, si rrjedhojë, pasqyrat financiare të veçanta paraqesin saktë pozicionin dhe rezultatin financiar në veçanti, informacionin rreth elementëve kryesorë të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël të Bankës, që kanë efekt të rëndësishëm në shumatat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta janë përshkruar në shënimin 5.

## **3. NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHËNIMET SHOQËRUESE**

### **3.1 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara**

Standarde dhe interpretime të tjera aplikohen për herë të parë në 2022, por ato nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

Banka nuk ka filluar aplikimin përpara datave efektive të ndonjë standardi, interpretimi apo rishikimi tjetër të dalë, por ende të pa hyrë në fuqi.

## **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL**

Banka ka aplikuar në mënyrë konsistente politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

### **4.1. Filiali dhe konsolidimi**

Filialet janë entitete të kontrolluara nga Banka. Banka përgatit pasqyrat financiare të veçanta dhe të konsoliduara në përputhje me SNRF-të. Filiali mbahet me kosto në pasqyrat financiare të veçanta. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë të përgatitura në mënyrë vullnetare nga Banka pavarësisht se Banka përmbush kriteret përjashtuese të SNRF-ve për përgatitjen e tyre, pasi pasqyrat financiare të Bankës konsolidohen nga aksionari fundor.

### **4.2. Transaksionet në monedhë të huaj**

Veprimet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Zërat monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitim/humbja nga monedhat e huaja për zërat monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e axhustuar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që matën me vlerë të drejtë, janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Diferencat që vijnë nga kurset e këmbimit e prej konvertimeve janë njohur përgjithësisht në pasqyrën e veçantë të të ardhurave gjithpërfshirëse. Fitimet/ humbjet neto nga këmbimi përfshijnë të gjitha diferencat nga kurset e këmbimit që kanë të bëjnë me transaksionet spot me datë likuidimi dy ditë pune pas datës së veprimit, megjithëse këto transaksione njihen në datën e likuidimit.

### **4.3. Interesat**

Sipas SNRF 9, të ardhurat nga interesat regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit ("NEI") për të gjithë instrumentet financiarë të matur me koston e amortizuar, instrumentet financiarë të dizenuar me Vlerë të Drejtë në fitim humbje ("VDFH"). Të ardhurat nga interesi për instrumentet financiare që sipas SNRF 9 maten me Vlerë të Drejtë në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ("VDATGJ"), gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Shpenzimet për interesa për të gjitha detyrimet financiare të matur me koston e amortizuar, gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Norma efektive e interesit është norma me të cilën skontohen ekzaktësisht pagesat e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare ose arkëtimet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, ose kur është e përshatshme për një periudhë me të shkurtër, duke arritur në vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar.

#### **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **4.3. Interesat (vazhdim)**

NEI (dhe për këtë dhe kosto e amortizuar e një aktivi) përllogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim apo prim në blerje, komisionet dhe kosto të tjera që janë pjesë integrale e NEI-t. Banka njih të ardhurat nga interesat duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një normë konstant kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Për këtë njih efektin e normave të ndryshme të interesit të aplikuar në faza të ndryshme, dhe karakteristika të tjera të ciklit të jetës së produktit (duke përfshirë parapagimet, gjobat dhe komisionet).

Nëse pritshmëritë në lidhje me flukset e parasë për aktivin financiar rishikohen për arsye të tjera përveç të rrezikut të kredisë, rregullimi regjistrohet si një rregullim pozitiv apo negativ në vlerën e mbartur të aktivit në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar kundrejt një rritje apo ulje të të ardhurave/shpenzimeve nga/për interesi/a, e përllogaritur duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Për instrumentet financiare me normë të ndryshueshme, rivlerësimi periodik i flukseve të parasë që reflekton lëvizjet në normat e interesit të tregut gjithashtu ndikon normën efektive të interesit, por kur instrumentet janë njohur si fillim me vlerë të barabartë me principalin, rivlersimi i pagesave të ardhshme të interesit nuk ndikon në mënyre të ndjeshme vlerën e mbartur të aktivit ose pasivit.

##### ***Interesat dhe të ardhura të ngjashme***

Të ardhurat neto nga interesi përbëhen nga të ardhurat nga interesat dhe shpenzimet për interesa të përllogaritura duke përdorur si metodën e normës efektive të interesit dhe metoda të tjera për to. Këto shpalosen të veçanta në pasqyrën e të ardhura dhe shpenzimeve si për të ardhurat, ashtu edhe shpenzimet për interesat për të dhënë një informacion simetrik dhe të krahasueshem. Në shpenzimet/të ardhurat nga interesat e përllogaritura duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, Banka përfshin vetëm ato interesa të instrumentëve financiare që paraqitën në këtë shenim.

Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën bruto të aktivive financiare të cilat nuk janë të zhvlerësuar. Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye quhet si në “Klasa 3”, Banka i përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit mbi vlerën neto të aktivit financiar. Nëse aktivi financiar përmirësohet dhe nuk është më i zhvlerësuar, Banka e kthen mënyrën e përllogaritjes së të ardhurave nga interesi mbi vlerat bruto të tij.

Për aktivet financiare të blera apo të krijuara të zhvlerësuar (“POCI”) (siç shpjegohet në shënimin 4.12.1), Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke përllogaritur NEI-in të rregulluar dhe me pas duke e aplikuar atë normë mbi koston e amortizuar të aktivit.

NEI i rregulluar është norma e interesit e cila, në njohjen fillestare, skonton flukset e ardhshme të parashikuara (duke përfshirë dhe humbjen kreditore) në vlerën e amortizuar të aktivit POCI. Më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, Banka nuk ka në portofolin e saj ndonjë aktiv POCI.

##### **4.4. Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione**

Banka fiton të ardhura nga komisionet nga një shumëllojshmeri shërbimesh të cilat ia ofron klientëve të saj. Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione që janë pjesë e normave efektive të interesave të një aktivi apo detyrimi financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Komisionet dhe tarifat për të cilat Banka merr përsipër detyrimin për të kryer një shërbim, apo një detyrim performues, ndaj klientëve, njihen si të ardhura nga shërbimet bankare bazuar në SNRF15. Të ardhura nga Kontratat me Klientët. Kushtet e punës për shërbimet bankare (kontratat) zakonisht nuk përfshijnë detyrime performimi të shumëfishta të bashkuara në një vlerësim dhe për pasojë nuk ka një gjykim të rëndësishëm të alokimit të çmimit të transaksionit. Për me tëpër, shërbimet bankare të ofruara nga Banka kanë një kohëzgjatje me pak së një vit ose rinovohen në bazë vjetore (për shembull mirëmbajtja e llogarive). Për pasojë, Banka ka përdorur përshtatshmërinë praktike të standardit dhe nuk ka nevojë të paraqesë informacion rreth shumës së agreguar të çmimit të lidhur me pjesën e pakënaqur të detyrimeve të performancës.

Detyrimet e performancës përbushen ose në një moment në kohë, ku e ardhura nga komisioni njihet kur shërbimi është kryer dhe transferuar tek klienti, ose përgjatë kohës gjatë së cilës Banka përbush shërbimin gjatë një periudhë të dakorduar dhe klienti e merr shërbimin gjatë gjithë kësaj kohe, dhe e ardhura njihet gjatë gjithë periudhës në fjalë. Përkatësisht, të ardhurat nga komisionet njihen si më poshtë:

#### **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **4.4. Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione (vazhdim)**

- Të ardhurat nga komisionet të fituara nga shërbimet që sigurohen gjatë një periudhë të caktuar kohe Komisionet e fituara për ofrimin e shërbimeve gjatë një kohë të caktuar njihen gjatë kësaj kohë. Këto komisione përfshijnë komisionet për mirëmbajtje llogarie, karta, shërbim E-banking, komisione për letrat e kredisë ose garancive bankare dhënë klientëve.

- Të ardhura nga komisionet të fituara nga shërbimet financiare dhe nga ekzekutimi i transaksioneve Këtu përfshihen komisione të fituara nga urdhërat e pagesave apo transfertave të klientëve dhe shërbimeve të tjera bankare të ofruara klientëve. Këto komisione apo komponentë të tyre që janë të lidhur me një zhvillim të caktuar, njihen në të ardhura kur kryhen shërbimet me të cilat janë të lidhura.

##### **4.5. Humbje neto nga çregjistrimi i aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar ose me VDATGJ**

Humbja neto nga çregjistrimi i aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar ose me VDATGJ përfshin humbjen (ose fitimin) njohur në shitjen ose çregjistrimin e aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar, përllëgaritur si diference midis vlerës kontabël (përfshirë këtu dhe zhvlerësimin) dhe arkëtimeve të marra.

##### **4.6. Të ardhura nga dividendët**

E ardhura nga dividendi njihet kur vendoset e drejta për të marrë pagesën e tij.

##### **4.7. Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin e vitit përmban tatimin e vitit aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e veçantë të fitim ose humbjeve të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

###### **4.7.1. Tatimi aktual**

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e arkëtueshme në lidhje me fitimin ose humbjen e tatueshme për vitin, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe ndonjë axhustim për tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

###### **4.7.2. Tatimi i shtyrë**

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që rezultojnë midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare të veçanta. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin në momentin e njohjes fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitimin/humbjen kontabël dhe as atë të tatueshëm.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën Banka pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë është matur me normat e tatimit që pritet të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur detyrimi është likuiduar apo aktivi është realizuar, bazuar në normat tatimore e ligjore në fuqi në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompesojnë njëra-tjetren kur ka një të drejtë ligjore të zbatueshme për të kompesuar aktivitet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatimet mbi të ardhurat të vëna nga i njëjti autoritet i taksave.

Taksat shtesë që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Banka njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendët.

Nje aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet/kreditet e mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme, deri në masën që është i mundur që të kemi të ardhura të tatueshme kundrejt të cilave ky aktiv tatimor pritet të përdoret. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo periudhë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka mundësi që përfitimi i lidhur nga tatimi të mund të realizohet.

#### **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **4.7. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

###### **4.7.3. Ekzpozimet tatimore**

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse taksa apo interesa shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozimet dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacionet e reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

##### **4.8. Instrumentet financiare – Njohja fillestare**

###### **4.8.1. Data e njohjes**

Aktivitet dhe detyrimet financiare, me përjashtim të kredive e paradhënies dhënë klientëve dhe detyrimeve ndaj klientëve, fillimisht njihen në datën e tregtimit që është data në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Kjo përfshin mënyrën standarde të tregtimit: blerje ose shitje e aktiveve financiare që kërkojnë dorëzimin e aktiveve brenda një afati kohor, përgjithësisht të përcaktuar me rregullore apo konventë në treg. Huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve njihen kur fondet janë transferuar në llogaritë e klientëve. Banka njeh detyrimet ndaj klientëve kur fondet janë transferuar në Bankë.

###### **4.8.2. Matja fillestare e instrumenteve financiare**

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga termat e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për të menaxhuar këto instrumentë, siç përshkruhet në Shënimin 4.9.1.1. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, me përjashtim të rasteve të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruar si aktive që maten me vlerën e drejtë nepërmjet fitimit ose humbjes (“VDFH”), për cilat kostot e transaksionit shtohen apo zbriten nga kjo vlerë. Llogaritë e arkëtueshme matën me çmimin e transaksionit. Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen e fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Banka regjistron fitimin ose humbjen e Ditës së parë, siç përshkruhet më poshtë.

###### **4.8.3. Fitimi ose humbja e ditës së parë**

Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti ndryshon nga vlera e drejtë në njohjen fillestare dhe vlera e drejtë bazohet në teknika vlerësimi që përdorin vetëm inputet e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Banka njeh diferencën midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregtimit. Në ato raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë shtyhet në kohë dhe njihet vetëm në fitim ose humbje kur inputet bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

###### **4.8.4. Kategoritë e aktiveve dhe detyrimeve financiare**

Banka klasifikon të gjitha aktivitet e saj financiare në bazë të modelit të biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe si dhe kushteve kontraktuale të aktiveve, të matura me:

- Koston e amortizuar (shih Shënimet 4.19, 4.20 dhe 4.21)
- VDATGJ (shih Shënimin 4.21)
- VDFH (shih Shënimin 4.21)

Banka klasifikon dhe mat portofolin për tregëtim me VDFH. Banka mund të caktojë instrumentë financiare në VDFH, dhe për këto eliminon ose ulë ndjeshëm mospërputhjet e matjes ose të njohjes.

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç angazhimeve të huasë dhe garancive financiare, si të matura me koston e amortizuar të shpjeguar në Shënimet 4.11.2.2.

#### **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **4.9. Aktivet dhe detyrimet financiare**

##### **4.9.1. Depozita dhe llogari me bankat, Hua dhe paradhënie për klientët, Letra me vlerë të investimit me kosto të amortizuar**

Banka mat Depozita dhe llogari me bankat, Hua dhe paradhënie për klientët dhe Letrat me vlerë të investimit me koston e amortizuar vetëm nëse të dyja kushtet e mëposhtme janë përmbushur:

- Aktivi mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale; dhe
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në datat e specifikuar flukse monetare të cilat përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe interesit për shumën e papaguar të tij (SPPI).

Detajet e këtyre kushteve jepen më poshtë.

##### **4.9.1.1. Përcaktimi i modelit të biznesit**

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që reflekton më mirë mënyrën së si menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit.

Modeli i biznesit i Bankës nuk vlerësohet bazuar në instrumente individuale, por në nivel portofolësh të grupuara dhe bazohet në faktorë të vëzhgueshëm si:

- Mënyra e vlerësimit dhe raportimit të performancës e modelit të biznesit dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi tek personeli drejtues të njësisë ekonomike,
- Rreziqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe aseteteve financiare të mbajtura në atë model biznesi) dhe, në veçanti, mënyrën së si menaxhohen ato rreziqe
- Si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi i tyre bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara apo në flukset monetare kontraktuale të mbledhura)
- Frekuenca e pritshme, vlera dhe koha e shitjeve janë gjithashtu aspekte të rëndësishme të vlerësimit të modelit të biznesit të Bankës

Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenare të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenaret e "rastit me të keq" ose "rastin e stresit". Nëse flukset e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritshmeritë fillestare të Bankës, Banka nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo origjinuara ose ato të blera në vazhdim.

##### **4.9.1.2. Testi SPPI**

Si një hap i dytë i procesit të klasifikimit, Banka vlerëson kushtet kontraktuale të aktiveve financiare për të identifikuar nëse ata përmbushin testin SPPI. 'Principalit' për qëllim të këtij testi përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare dhe mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivitetit financiar (për shembull, nëse ka shlyerje të principalit ose amortizimin e primit / skontos).

Elementet me të rëndësishëm të interesit në kuadër të marrëveshjes së huadhenies janë zakonisht konsiderata për vlerën kohore të parasë dhe rrezikut të kredisë. Për të bërë vlerësimin SPPI, Banka zbaton gjykimin dhe shqyrton faktorët relevantë si monedha në të cilën është shprehur aktivi financiar dhe periudha për të cilën është përcaktuar norma e interesit.

Ne të kundërt, kushtet kontraktuale që paraqesin një ekspozim me pak së minimumi ndaj rreziqeve ose paqëndrueshmëri në flukset monetare kontraktuale që nuk kanë lidhje me një marrëveshje bazë të huadhenies, nuk krijojnë flukse kontraktuale të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi tëpricen e huasë. Në raste të tilla, aktivi financiar kërkohet të matet në VDFH.

##### **4.9.2. Instrumentet financiare të mbajtur për tregtim**

Banka i klasifikon aktivitetet financiare si të mbajtura për tregtim kur ato janë blerë kryesisht për fitim afatshkurtër nëpërmjet aktiviteteve tregtare ose janë pjesë e një portofoli instrumentesh financiare që menaxhohen së bashku, për të cilat ka dëshmi të një modeli të gjenerimit të fitimi afatshkurtër. Aktivitetet e mbajtura për tregtim regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhurat neto nga tregtimi. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në të ardhurat neto nga tregtimi sipas kushteve të kontratës, ose kur vendoset e drejta për pagesë. Të përfshira në këtë klasifikim janë letrat me vlerë të borxhit që janë blerë kryesisht për qëllime të shitjes në periudhën afatshkurtër.

#### **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **4.9. Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

###### **4.9.3. Instrumentet financiare të matur me VDATGJ**

Banka klasifikon instrumentet financiare si të matur me VDATGJ kur të dy kushtet e mëposhtme përmbushen:

- Aktivi mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është si mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale si dhe për shitje
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar përmbushin testin SPPI.

Matja e mëpasshme e aktiveve me VDATGJ bëhet me vlerën e drejtë me fitimin dhe humbjen që rezultojn nga ndryshimi në vlerën e drejtë që njihet në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse. Të ardhurat nga interesat dhe fitimet nga kurset e këmbimit njihen në të ardhurat dhe shpenzimet në të njëjtën mënyrë si ato të aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar siç shpjegohet në Shënimin 4.3.

Përlllogaritja e ECL për aktivet financiare të matur me VDATGJ shpjegohet në Shënimin 4.12.3. Kur Banka ka me shumë së një investim në të njëjtën letër me vlerë, ato konsiderohen si të shitur sipas parimit “i pari që hyn është i pari që del”. Në çregjistrimin e tyre, fitimet ose humbjet kumulative që më parë janë njohur në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse, riklasifikohen nga këtu në të ardhurat dhe shpenzimet.

###### **4.9.4. Borxhi i emtuar dhe fonde të tjera hua**

Pas matjes fillestare, borxhi i emtuar dhe fondet e tjera hua me pas maten me koston e amortizuar. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose primi në fondet e emtuara, dhe kostot që janë pjesë integrale e NEI. Shpalojet për borxhin e emtuar të Bankës përcaktohen në Shënimin 21.

##### **4.10. Riklasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare**

Nëse modeli i biznesit sipas të cilit Banka mban aktivet e saj financiare ndryshon, aktivet financiare të prekura nga ky ndryshim riklasifikohen. Kërkesat e klasifikimit dhe matjes që lidhen me kategorinë e re zbatohen në mënyrë prospektive që nga dita e parë e periudhës së parë të raportimit pas ndryshimit në modelin e biznesit që rezultojn në riklasifikimin e aktiveve financiare të Bankës. Gjatë vitit ushtrimor dhe periudhës së mëparshme kontabël nuk ka pasur ndryshime në modelin e biznesit sipas të cilit Banka mban aktivet e saj financiare dhe për këtë arsye nuk janë bërë riklasifikime. Detyrimet financiare nuk riklasifikohen.

##### **4.11. Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare**

###### **4.11.1. Çregjistrime nga modifikimet thelbësore**

Banka çregjistron një aktiv financiar, të tillë si një hua për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegociuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua e re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Huatë e reja të njohura klasifikohen si Klasa 1 për qëllimet e matjes ECL, përveç nëse kredia e re, konsiderohet të jetë POCl.

Gjatë vlerësimit nëse do të çregjistrohet një hua për një klient, ndër të tjera, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në monedhën e huasë
- Futja e një tipari të instrumentit të kapitalit
- Ndryshimi në kundërparti
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të përmbushë me kriterin e SPPI

Nëse modifikimi nuk rezultojn në flukse të mjeteve monetare që janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk rezultojn në çregjistrimin. Bazuar në ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të skontuara me NEI fillestare, Banka regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën paregjistruar në humbjes nga zhvlerësimi.

###### **4.11.2. Çregjistrime të tjera përveç së ato nga modifikimet thelbësore**

###### **4.11.2.1. Aktive financiare**

Nje aktiv financiar (ose, kur është e mundur, një pjesë e një aktiviteti financiar ose pjesë e një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktiviteti financiar kanë skaduar. Banka, gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ajo ka transferuar aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

#### **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **4.11. Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)**

##### **4.11.2 Çregjistrime të tjera përvec se ato nga modifikimet thelbesore (vazhdim)**

##### **4.11.2.1. Aktivet financiare (vazhdim)**

Banka ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar; ose
- Ajo ruan të drejtat për flukset e mjeteve monetare, por ka marrë detyrimin për të paguar plotësisht flukset monetare të marra pa vonesa materiale për një palë të tretë nën një marrëveshje 'kalimtare'.

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për të paguar këto flukse monetare në një ose më shumë njësi ekonomike ('përfituesit eventuale'), kur të gjitha tri kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Banka nuk ka asnjë detyrim të paguajë shumat për përfituesit eventuale, përveç nëse ka arkëtuar shumën ekuivalente nga aktivi origjinal, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën për rimarrjen e plotë të shumës së huasë plus interesin e përlllogaritur me normat e tregut
- Banka nuk mund të shesë ose të vendosë si kolateral aktivin fillestar përveçse si siguri për marrësit eventuale

Banka duhet të dorezojë çdo fluks parash që mbledh në emër të përfituesve eventuale pa vonesë materiale. Përveç kësaj, Banka nuk ka të drejtë të riinvestojë flukse të tilla të parasë, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalente të parasë duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së arkëtimit dhe datës së dërgesës së kërkuar për përfituesit eventuale.

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit; ose
- Banka nuk ka transferuar as ruajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit, por ka transferuar kontrollin e aktivitetit

Banka e konsideron kontrollin të transferuar nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij për një palë të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Nëse Banka as nuk ka transferuar e as nuk ka mbajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet dhe ka mbajtur kontrollin e aktivitetit, aktivi vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, rast në të cilin, Banka njih edhe një detyrim të lidhur me të. Aktivitetet e transferuara dhe detyrimi i lidhur me të matën në një bazë që reflekton të drejtat dhe detyrimet që Banka ka mbajtur. Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e një garancie mbi aktivin e transferuar matet me vlerën me të ulët midis vlerës kontabël fillestare të aktivitetit dhe shumën maksimale të konsideratës që mund t'i kërkohej Bankës të paguajë.

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) në aktivin e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet në vlerën që Banka do të kërkohej të paguajë gjatë riblerjes.

##### **4.11.2.2. Detyrimet financiare**

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë substanciale, zëvendësimi ose modifikimi i tillë trajtohet si një çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

#### **4.12. Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

##### **4.12.1. Vështrim i Përgjithshëm i parimeve të ECL**

Banka ka regjistruar një fond zhvlerësimi për humbjet e pritshme të kredisë për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në VDFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, në këtë pjesë të gjitha të quajtura si 'instrumente financiare'. Instrumentet e kapitalit nuk janë subjekt i zhvlerësimit sipas SNRF 9.



**4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)****4.12. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)****4.12.1. Veshtrim i Përgjithshëm i parimeve të ECL (vazhdim)**

Fondi i zhvlerësimit ECL bazohet në humbjet e kredisë që pritet të lindin gjatë jetës së aktivitetit (humbja e pritshme e kredisë për jetë ose LTECL), përveç nëse nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, fondi bazohet në humbjen e pritshme të kredisë në 12 muaj (12mECL) siç është shënuar në Shënimin 4.12.2. Politikat e Bankës për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë janë paraqitur në Shënimin 38.1.2.2.

Me përjashtim të aktiveve financiare POCI (të cilat janë konsideruar më poshtë), ECL-të kërkohet të maten nëpërmjet një fondi për humbje në një shumë të barabartë me:

- ECL 12-mujore, dmth ECL gjatë gjithë jetës që rezultojnë nga ato ngjarje dështimi në instrumentet financiare që janë të mundshëm brenda 12 muajve pas datës së raportimit; ose

LTECL, dmth ECL gjatë jetës që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të dështimit gjatë jetës së instrumentit financiar.

Banka mat fondin e humbjeve në një shumë të barabartë me LTECL, përveç për sa vijon, për të cilën ato maten si ECL 12 mujore:

- Letrat me vlerë të investimit të cilat përcaktohen të kenë rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit; dhe
- Instrumente të tjera financiare në të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja e tyre fillestare.

Si LTECL ashtu dhe 12mECL janë llogaritur në baza individuale ose në bazë kolektive, në varësi të natyrës së portofolit të instrumenteve financiare. Politika e Bankës për grupimin e aktiveve financiare të matura në baza kolektive është shpjeguar në Shënimin 38.1.3.1.

Banka ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim, në fund të çdo periudhë raportuese, nëse rreziku i kredisë i një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e dështimit që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar. Kjo shpjegohet më tej në Shënimin 38.1.2.3. Bazuar në procesin e mesipërm, Banka grumbullon kreditë e saj në Klasën 1, Klasën 2, Klasën 3 dhe POCI, siç përshkruhet më poshtë:

- Klasa 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Banka njih një zhvlerësim në bazë të 12mECL. Kreditë e Klasës 1 gjithashtu përfshijnë kredi ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Klasa 2.
- Klasa 2: Kur një kredi ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi, Banka regjistron një fond për LTECL-të. Kreditë e Klasës 2 gjithashtu përfshijnë kredi, ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Klasa 3.
- Klasa 3: Huatë që konsiderohen të zhvlerësuara plotësisht (siç janë shënuar në Shënimin 38.1.2.1). Banka regjistron një fond për LTECL-të.
- POCI: Aktivitet e blera ose të origjinuara të zhvlerësuara ("POCI") janë aktivitet financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Aktivitet POCI regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një NEI të rregulluar. ECL-të njihen ose rimerren vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme të kredisë.

Për aktivitet financiare për të cilat Banka nuk ka shpresa të arsyeshme për rikuperimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e aktivitet financiar zvogëlohet. Ky konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i aktivitet financiar.

Banka ka klasifikuar të gjitha aktivitet financiare të zhvlerësuara të përfituara nëpërmjet kombinimit të biznesit në të njëjtin klasifikim si më parë dhe jo si POCI, sa kohë që Banka ka blerë dhe më pas është bashkuar me një biznes si një i tërë.

#### 4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.12. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

###### 4.12.2. Përlllogaritja e ECL-ve

Banka llogarit ECL-të në bazë të skenareve të ponderuar me probabilitet e ndodhjes për të matur mungesat e flukseve të pritshëm të arkëtimeve, të skontuara në një përaftrim me NEI. Një mungesë e arkëtimeve të pritshme është diferenca midis flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të pritshme dhe atyre që njësisë ekonomike pret të arkëtoje.

Mënyra e llogaritjeve ECL është përshkruar më poshtë dhe elementet kryesore janë si vijon:

- PD – *Mundësia e dështimit* (“PD”) është një vlerësim i mundësisë së dështimit gjatë një horizonti kohor të dhënë. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësimit, nëse aktivi nuk është rregjistruar më parë dhe vazhdon të qëndrojë në portofolin e Bankës. Koncepti i PD-së shpjegohet më tej në Shënimin 38.1.2.4.1.
- EAD – *Ekspozimi në Dështim* (“EAD”) është një vlerësim për ekspozimin në një datë të ardhshme dështimi, duke marrë në konsideratë ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë parapagimet e principalit dhe interesit, të skeduluara në kontratë apo jo, tërheqjet e pritshme në angazhime për financim të dhëna, dhe interesa të rrjedhur nga pagesat e pakryera. EAD shpjegohet më tej në Shënimin 38.1.2.4.3.
- LGD – *Dështimi në humbje* (“LGD”) është një vlerësim i humbjes që del në rastin kur ndodh një dështim në një kohë të dhënë. Ai bazohet në diferencën midis flukseve kontraktuale të arkëtimeve dhe atyre që huadhënësi pret të arkëtojë, duke përfshirë dhe realizimet e atyre që vijnë nga ndonjë kolateral i marrë. Zakonisht shprehet në përqindje të EAD-se. LGD shpjegohet më tej në Shënimin 38.1.2.4.4. Këto parametra rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara brenda Bankës dhe të dhëna të tjera historike. Ato janë rregulluar për të pasqyruar informacionin e për ndikimet të elementëve potenciale të ardhshëm siç shpjegohet në Shënimin 38.1.2.4.2. Humbjet nga zhvlerësimi dhe rimarrjet janë llogaritur dhe tregohen veçmas nga humbjet e modifikimit ose fitimet që llogariten si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivitetit financiar.

Mekanika e metodës ECL është përmbledhur më poshtë:

- Klasa 1: 12mECL llogaritet si pjesë e LTECL -ve që përfaqësojnë ECL-të që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Banka llogarit fondin e 12mECL bazuar në pritshmërinë e një mospagimi që ndodh në 12 muajt pas datës së raportimit. Këto probabilitete të dështimit të pritur 12-mujor aplikohen mbi një EAD të parashikuar dhe shumëzohen me LGD-në e pritshme.
- Klasa 2: Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi i saj, Banka regjistron një fond për LTECL. Mekanika është e ngjashme me ato të shpjeguara më sipër, por PD-të dhe LGD-të vlerësohen gjatë gjithë jetës së instrumentit. Mungesat e arkëtimeve të pritura të parave skontohen me NEI origjinale.
- Klasa 3: Për huatë që konsiderohen si të zhvlerësuara (siç përcaktohet në Shënimin 38.1.2.1), Banka njeh LTECL për këto kredi. Metoda është e ngjashme me atë për aktivet e Klasës 2, me PD të vendosur në 100%. Kjo llogaritje është bërë për tre skenarë (një skenar bazë, një optimist dhe një pesimist).
- POCI: Aktivet POCI janë aktive financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Banka njeh vetëm ndryshimet kumulative në LTECL-të që nga njohja fillestare, skontuar nga NEI e rregulluar.
- Angazhimet e huasë dhe letrat e kreditit: Gjatë vlerësimit të ECL-ve për angazhimet e huazuara, Banka vlerëson pjesën e pritshme të angazhimit të huasë që do të tërhiqet gjatë jetës së tij të pritshme. ECL pastaj bazohet në vlerën aktuale të mungesave të pritura në flukset e mjeteve monetare nëse kredia është tërhequr. Mungesat e arkëtimeve të pritshme skontohen me NEI e pritshme të huasë. Për kartat e kreditit dhe kreditë rrotulluese që përfshijnë si një hua dhe një angazhim të patërhequr, ECL llogariten dhe paraqiten së bashku me huanë. Për angazhimet e kredisë dhe letrat e kreditit, ECL njihet brenda Provizioneve.
- Kontratat e garancisë financiare: Detyrimi i Bankës sipas secilës çdo garanci matet me vlerën me të lartë të shumës së njohur fillimisht, pakësuar me amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe provizioneve ECL. Për këtë qëllim, Banka vlerëson ECL-të bazuar në vlerën aktuale të pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin për një humbje kredie që ajo shkakton. Mungesat e arkëtimeve skontohen me një normë interesi të rregulluar nga rreziku që lidhet me ekspozimin. ECL-të që lidhen me kontratat e garancisë financiare njihen brenda Provizioneve.

#### 4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.12. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

##### 4.12.3. Instrumentet e matura me vlerën e drejtë përmes ATGJ

ECL për instrumentet e borxhit të matura në VDATGJ nuk ul vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila mbetet në vlerën e drejtë. Në vend të kësaj, një shumë e barabartë me zhvlerësimin që do të lindte nëse aktivet mateshin me koston e amortizuar njihet në ATGJ si një shumë e akumuluar e zhvlerësimit, me një ngarkesë korresponduese për fitimin ose humbjen. Humbja e akumuluar e njohur në ATGJ riciklohet në fitim dhe humbje me çregjistrimin e aktiveve.

##### 4.12.4. Informacion për ngjarje që priten të ndodhin

Në modelet e saj ECL, Banka mbështetet në një gamë të gjerë të informatave të ardhshme, si input ekonomike, si:

- Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto (“PBB”)
- Normat e papunesisë
- Inflacioni
- Kurset e këmbimit, etj

##### 4.12.4. Informacion për ndodhi që priten të ndodhin (vazhdim)

Inputet dhe modelet e përdorura për llogaritjen e ECL-ve nuk mund të kapin gjithnjë karakteristikat e tregut në datën e pasqyrave financiare. Për të pasqyruar këtë, rregullime cilesore bëhen herë pas herë si rregullime të përkohshme, kur dallimet e tilla janë dukshëm materiale. Informata të hollësishme rreth këtyre inputeve dhe analizës së ndjeshmerisë jepen në Shënimin 38.1.2.4.2.

##### 4.12.5. Paraqitja e fondit për zhvlerësim ECL në pasqyrën e pozicionit financiar

Fondet e zhvlerësimit për ECL janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës si më poshtë:

- Aktivet financiare të matura me koston e amortizuar: si zbritje nga vlera kontabël bruto e aktivitet;
- Kontratat e angazhimeve të huasë dhe kontratat e garancive financiare: përgjithësisht si një provizion;
- Kur një instrument financiar përfshin si një komponent të tërhequr dhe një komponent të patërhequr angazhimi, dhe Banka nuk mund të identifikojë ECL-ne për komponentin e angazhimit të kredisë veças nga ato për pjesën e tërhequr: Banka paraqet një fond të kombinuar zhvlerësimi për të dy komponentet. Shuma e kombinuar paraqitet si një zbritje nga vlera kontabël bruto e komponentit të tërhequr.

#### 4.13. Përmirësimet e kredisë: vlerësimi i kolateralit dhe garancitë financiare

Për të zbutur riskun e kredisë në aktivet financiare, Banka kërkon përdorimin e kolateraleve, kurdo që është e mundur. Kolaterali është i formave të ndryshme, si depozita, letra me vlerë, garanci, pasuri e patundshme, të drejta dhe inventare.

Kolaterali, përveç atij të sekuestruar, nuk regjistrohet në pasqyrat financiare të Bankës.

Flukset e pritshme nga përmirësimet e kredisë të cilat, në bazë të SNRF-ve, nuk kërkohen të njihen me vete dhe që konsiderohen pjesë e kushteve kontraktuale të një instrumenti i cili është subjekt i zhvlerësimit, përfshihen në matjen e atij zhvlerësimi. Në këto kushte, vlera e drejtë e kolateralit ndikon për llogaritjen e ECL-ve. Kolaterali zakonisht vlerësohet të paktën në lindjen e kredisë dhe në varesi të llojit të tij, rivlerësohet një herë në vit ose një herë në tre vjet. Megjithatë, disa kolaterale, për shembull, depozitat apo letrat me vlerë vlerësohen në bazë ditore. Detajet e ndikimit të përmirësimeve të kredisë të Bankës, shpalosen në Shënimin 38.1.4.

Për aq sa është e mundur, Banka përdor të dhënat e tregjeve aktive për të vlerësuar aktivet financiare të mbajtura si kolateral. Aktivet e tjera të cilat nuk kanë vlera tregu të matshme, vlerësohen duke përdorur teknikat e vlerësimit. Kolaterale jo-financiare, si pasuritë e patundshme, vlerësohen në bazë të të dhënave të siguruar nga palë të treat, si agjentë imobiliare, ose bazuar në indeksin e çmimeve të shtëpive.

Garancitë e mbajtura përfshihen në matjen e kredisë ECL kur ose ato specifikohen në Kushtet kontraktuale të kredisë ose përndryshe janë pjesë përbërëse e kredisë, në atë që ato formonin një pjesë të bazës mbi të cilën kredia u dha.

#### **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **4.14. Kreditë e ristrukturuara dhe të modifikuara**

Banka në disa raste bën modifikime në Kushtet fillestare të kredisë si një përgjigje ndaj veshirësive financiare të kredimarrësit, në vend që të sekuestroje kolateralet e kredisë. Banka e konsideron një hua të ristrukturuar kur këto modifikime bëhen si rezultat i veshirësive financiare aktuale apo të pritshme të kredimarrësit dhe që Banka në të kundërt nuk do të kishte rënë dakord për to, nëse kredimarrësi do të kishte një situatë të shëndetshme financiare. Treguesit e veshirësive financiare përfshijnë shkelje të kufijve të treguesve financiare të dakorduar në marrëveshje, ose shqetësime të të ngritura nga Departamenti i Riskut të Kredisë. Ristrukturimi mund të përfshijë dhe riskedulime të pagesave të dakorduara si dhe dakordesinë për kushte të reja të huasë. Pas ringocimit të kushteve të reja, zhvlerësimi matet duke përdorur normën fillestare NEI të përlllogaritur përpara modifikimit të kushteve. Politikat e Bankës për monitorimin e huave të ristrukturuara ndihmojnë në rritjen e sigurisë që arkëtimet e ardhshme të jenë të mundshme të kryhen.

Vendimet për çregjistrimin dhe riklasifikimin midis Klasës 2 dhe Klasës 3 merren në baza individuale. Nëse këto procedura identifikojnë një humbje në lidhje me një hua, ajo shpaloet dhe menaxhohet si një hua e ristrukturuar në Klasën 3 deri në mbledhjen e plotë të saj apo në fshirjen e saj nga librat kontabël.

Kur një hua është ristrukturuar ose modifikuar por nuk është çregjistruar, Banka gjithashtu rivlerëson nëse ka patur një rritje të rëndësishme të rrezikut të saj të huasë, siç tregohet në Shënimin 38.1.2.2.

Banka gjithashtu konsideron nëse aktivi duhet të klasifikohet në Klasën 3. Një herë që një aktiv është klasifikuar si ristrukturim, ai do të qëndrojë i tillë për të paktën një periudhë provë prej 24 muajsh.

Detajet për aktivet e ristrukturuara shpalosen në Shënimin 38.1.2.1.

Nëse modifikimet janë thelbësore, kredia çregjistrohet siç tregohet në Shënimin 4.11.

##### **4.15. Kompesimi**

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompesuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si për shembull ato të aktivitetit tregtar të Bankës.

##### **4.16. Fshirja**

Aktivitet financiare fshihen pjesërisht ose tërësisht vetëm kur Banka ka ndaluar ndjekjen e rikuperimit. Për fshirjen e kredive, Banka ndjek kërkesat rregullatore, ku huatë e tilla duhet të klasifikohen në kategorinë “E humbur” të rrezikut të kredisë, me më shumë se 365 ditë në vonesë për dy vitet e fundit dhe një fond provigjioni prej 100% për to. Megjithatë, Banka mund të mos e kryejë fshirjen në rast se:

1. bazuar në analizën e situatës financiare të kredimarrësit dhe cilësisë së kolateralit, gjen mundësinë për shlyerjen/ ripagimin e kredisë në fjalë.
2. huatë në procesin e ristrukturimit, për të cilat në çdo rast, nuk mund të kalojnë periudhën 6 mujore nga dita që kanë plotësuar kushtet për t’u fshirë.

Nëse shuma që duhet të fshihet është më e madhe se fondi i zhvlerësimit të akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtesë e këtij fondi i cili me pas zerohet ndaj vlerës kontabël bruto.

##### **4.17. Matja me koston e amortizuar**

Kosto e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

##### **4.18. Matja e vlerës së drejtë**

‘Vlera e drejtë’ është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka akses në atë datë.

Për të treguar se si janë nxjerrë vlerat e drejta, instrumentet financiare janë riklasifikuar bazuar në një hierarki të teknikave të vlerësimit, siç përmbledhet më poshtë:

#### 4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.18. Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

- Niveli 1: Ato ku inputet e përdorura në vlerësim janë çmimet e kuotuar të parregulluara në tregjet aktive për një instrument identik në të cilat Banka ka qasje në datën e matjes.
- Niveli 2: Kjo kategori përfshin instrumentë të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar të tregut në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak së aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet ku teknikat e vlerësimi përfshijnë inpute të cilat nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pavëzhgueshme mund të ketë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme, ku rregullime të rëndësishme të pavëzhgueshme ose supozime janë të nevojshme për të reflektuar diferencat midis instrumenteve.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmim të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë së transaksionet në lidhje me aktivin apo detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të çmimeve në baza të vazhdueshme.

Nëse nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin të inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të kishin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni. Vlera e drejtë tregohet në Shënimin 39.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - dmth vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë.

Nëse Banka përcakton së vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe së vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik e as nuk është e bazuar në një teknike vlerësimi e cila përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencen midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë është njohur në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetëgjatësinë e instrumentit, por jo me vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Në qoftë së një aktiv ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofruar dhe një çmim të kërkuar, atëherë Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata në çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra në çmimin e kërkuar. Vlera e drejtë e një llogarie kursimi nuk është më pak se shumica e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë kur mund të kërkohej pagimi i shumës. Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë të cilës ky ndryshim ka ndodhur.

##### 4.19. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë para në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar.

##### 4.20. Depozita dhe llogari me bankat dhe Hua dhe paradhënie për klientet

“Depozita dhe llogari me bankat” dhe “Hua dhe paradhënie për klientet” në pasqyrën e pozicionit financiar, përfshijnë hua dhe paradhënie të matura me koston e amortizuar (Shënimi 4.8.4). Fillimisht ato maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe me pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njeherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv thelbësisht të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo të anasjellta), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivi i lidhur me të nuk njihet në pasqyrat e veçanta financiare të Bankës.

#### 4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.21. Letra me vlerë investimi

“Letra me vlerë investimi” përfshijnë letra me vlerë që matën me koston e amortizuar ose ato që maten me vlerë të drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ose ato që maten me vlerë të drejtë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 4.8.4). Letrat me vlerë investimi maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Letrat me vlerë që mbahen VDATGJ, më pas matën me vlerën e tyre të drejtë, duke rregjistruar fitim humbjen që krijohen nga ndryshimi i vlerës së tyre të drejtë në “të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse”. Letrat me vlerë që mbahen për tregtim, më pas matën me vlerën e tyre të drejtë, duke rregjistruar fitim humbjen që krijohen nga ndryshimi i vlerës së tyre të drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### 4.22. Qiratë

Banka vlerëson në lindjen e kontratës nëse një kontratë është apo përmban një qira. Që do të thotë nëse kontrata jep të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohë në këmbim të një shume.

##### 4.22.1. Banka si qiramarrëse

Banka zbaton një qasje të vetme për njohjen dhe matjen e të gjitha qirave me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të vogël. Banka njeh detyrimin për qiratë për të kryer pagesat e qirave dhe të drejtën e përdorimit të aktivitetit që përfaqëson të drejtën për të përdorur aktivin bazë.

##### 4.22.1.1. Aktiv me të drejtë përdorimi

Banka njeh aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (data në të cilën aktivi bazë është i vlefshëm për t’u përdorur). Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto, duke i zbritur ndonjë amortizim të akumuluar apo ndonjë humbje nga zhvlerësimi, dhe të rregulluar për ndonjë rimatje të detyrimit për qira. Kosto e aktivitetit me të drejtë përdorimi përfshin vlerën e detyrimit për qira të njohur, kostot e drejtpërdrejta fillestare të kryera, dhe pagesat e qirave të kryera në apo para datës së fillimit të qirasë, pakësuar me çdo stimuj qiraje të marrë. Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet në bazë lineare gjatë jetës së qirasë. Aktivitetet me të drejtë përdorimi paraqiten brenda Shënimit 13.1.1.

##### 4.22.1.2. Detyrimet për qira

Banka njeh detyrimin për qira në datën e fillimit të qirasë, të matur si vlerë aktuale e pagesave për t’u kryer të qirave gjatë gjithë jetës së qirasë. Pagesat e qirave përfshijnë pagesat fikse (pakësuar me ndonjë stimul të marrë për qiratë), pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen në një indeks ose një normë, dhe pagesat e pritshme sipas vlerës së mbetur të garancive. Pagesat e qirasë gjithashtu përfshijnë dhe çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Banka ka siguri në arsyeshme në ushtrimin e tij dhe pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë reflekton ushtrimin e një opsioni për përfundimin e qirasë. Qiratë e ndryshueshme të cilat nuk varen nga një indeks apo normë, njihen si shpenzime të periudhës në të cilën ndodh ngjarja apo kushtet për shkaktimin e tyre.

Banka në përlllogaritjen e vlerës aktuale të pagesave të qirasë përdor normën rritëse të huamarrjes në datën e fillimit të qirasë, pasi norma e interesit e përcaktuar e qirasë nuk mund të jetë lehtësisht e gjetshme. Pas datës së fillimit, vlera e detyrimit për qira rritet për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë dhe pakësohet për të reflektuar pagesat e kryera të qirasë. Përveç kësaj, vlera kontabël e detyrimit për qira rimatet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatet e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (psh. ndryshim i pagesave të ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa të qirave) ose ndryshim në vlerësimin e opsionit për të blerë aktivin bazë. Kur detyrimi për qira rimatet në këtë mënyrë, rregjistrohet dhe një rregullim korrespondues i vlerës kontabël të aktivitetit me të drejtë përdorimi, ose regjistrohet në fitim humbje në rast se vlera kontabël e aktivitetit me të drejtë përdorimi është zero.

Detyrimet për qiratë paraqiten në një zë me vete në bilancin e veçantë të Bankës dhe shpalosen në Shënimin 13.1.2.

##### 4.22.1.3. Qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët

Banka zbaton lehtësirat e njohjes për qiratë afatshkurtra për qiratë e disa degeve të saj (ato qira që kanë maturimin deri në 12 muaj nga data e fillimit dhe nuk kanë një opsion për blerje). Po ashtu zbaton dhe lehtësirat e njohjes për disa pajisje zyre të cilat janë konsideruar si me vlerë të ulët. Pagesat e qirasë për qiratë afatshkurtra dhe ato të aktiveve me vlerë të ulët njihen si shpenzime gjatë afatit të kontratave të qirave përkatëse.

**4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)****4.22. Qiratë (vazhdim)****4.22.2. Banka si qiradhënëse**

Qiratë në të cilat Banka nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësise së aktivitetit bazë klasifikohen si qira operationale. Të ardhurat nga këto qira njihen në bazë lineare përgjatë jetës së qirasë dhe përfshihen në të ardhurat në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për shkak të natyrës së tyre operationale. Kostot fillestare direkte të bera për të negociuar dhe përfunduar një qira operationale i shtohen vlerës kontabël të aktivitetit bazë dhe njihen si shpenzim gjatë jetës së qirasë në të njëjtën bazë si e ardhura e qirasë. Të ardhurat nga qiratë në kontigjence njihen në periudhën në të cilën ato janë fituar.

**4.22.3. Nënqiraja**

Banka në disa raste është nënqiradhënëse (qiradhënësi i ndërmjetëm) i aktivitetit me të drejtë përdorimi. Si një qiradhënësi i ndërmjetëm, Banka e klasifikon nën qiranë si një qira financiare apo operationale si më poshtë:

- Nëse qiraja kryesore është qira afatshkurtër që Banka, si qiramarrëse, e ka njohur si të tillë, nënqiraja klasifikohet si qira operationale,
- Në të kundërt, nënqiraja klasifikohet duke iu referuar aktivitetit me të drejtë përdorimi që vjen nga qiraja kryesore, dhe jo duke iu referuar aktivitetit bazë. Një qira klasifikohet si qira financiare nëse transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë nga aktiviteti me të drejtë përdorimi që rrjedhin nga qiraja kryesore; në të kundërt, ajo klasifikohet si një qira operationale.

Për nënqiratë të klasifikuara si qira financiare, Banka çregjistron Aktivitetin me të drejtë përdorimi dhe një Investimin neto në nënqira; çdo diferencë midis Aktivitetit me të drejtë përdorimi dhe investimit neto në nënqira, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në datën e fillimit, Investimi neto në nënqira financiare matet me një vlerë të barabartë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të Aktivitetit me të drejtë përdorimi bazë përgjatë afatit të qirasë.

Investimi neto në qira paraqitet nën “Aktive të tjera” në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar.

Për nënqiratë e klasifikuara si qira operationale, Banka njeh të ardhurat nga qiraja financiare në baza lineare përgjatë afatit të qirasë. Aktiviteti respektiv i dhënë me qira përfshihet në pasqyrën e pozicionit financiar bazuar në natyrën e tij.

**4.23. Aktive të qëndrueshme të trupëzura****4.23.1. Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara maten me kosto pakësuar me amortizimin e akumuluar dhe ndonjë zhvlerësim të akumuluar për humbje.

Kosto përfshin shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin dhe koston e materialeve dhe punën direkte, kosto të tjera direkt të atribuueshme në bërjen e aktivitetit të gatshëm për punë, dhe kur Banka ka detyrimin për të hequr një aktiv apo ta restaurojë atë, kosto e vlerësuar e çmontimit dhe heqjes së pjesë si dhe restaurimi i vendit në të cilin ato ndodhen. Programet kompjuterike që janë pjesë e funksionimit të pajisjes në të cilën ato janë instaluar, kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Në rast se pjesë të një aktiviteti kanë afate përdorimi të ndryshme, ato regjistrohen si njësi më vete (përbërësit kryesorë) të aktiveve të trupëzuara.

Të ardhurat apo humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një aktiviteti të trupëzuar (llogaritur si diferencë midis arkëtimit nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël të aktivitetit) njihen si të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit humbjeve.

**4.23.2. Kostot e mëpasshme**

Kostot e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike që i atribuohen atyre do të rrjedhin te Banka në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes regjistrohen në shpenzimet kur ndodhin.

**4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)****4.23. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara (vazhdim)****4.23.3. Amortizimi**

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara amortizohen duke filluar nga dita që ato janë vënë në përdorim, ose përsa i përkët aktiveve të ndërtuar vetë, nga dita e përfundimit dhe e bërjes gati për përdorim. Amortizimi llogatitet për të gjithë jetën e aktivitetit mbi koston e asetit minus vlerën e tij të mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit humbjeve.

Amortizimi i vitit është llogaritur sipas metodës së vlerës së mbetur në përputhje me normat e mëposhtme:

	<b>Norma vjetore</b>
Pajisje kompjuterike	25%
Pajisje zyre	20%
Pajisje elektronike dhe elektrike	20%
Instalime	20%

Përmirësimet në ambjentet e marra me qira nga Banka amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë kohës me të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së tyre. Afati i përdorimit të këtyre përmirësimeve varion nga 3 në 15 vjet. Aktivitetet në proces nuk amortizohen. Metodat e amortizimit, jeta dhe vlera e tyre e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe axhustohen në rast se ka nevojë.

**4.24. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara**

Programet kompjuterike të blera nga Banka maten me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin kur është i aplikueshëm. Shpenzimet e mëpasshme në programe kompjuterike kapitalizohen vetëm nëse ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të aktivitetit për të cilin bëhen. Të gjitha shpenzimet e tjera regjistrohen kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim humbje gjatë jetës së dobishme të aktivitetit, duke u nisur nga data në të cilën është i vlefshëm për punë. Aktivitetet në proces nuk amortizohen.

Programet kompjuterike amortizohen sipas metodës së vlerës së mbetur me normë vjetore amortizimi 25%, ndërkohë aktivitetet e tjera të patrupëzuara, që përfshijnë liçenca dhe komisione të paguara për qasje në sisteme elektronike e shërbime të përdorura nga Banka, amortizohen sipas metodës lineare me normë vjetore amortizimi 15%.

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e tyre e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe axhustohen në rast se ka nevojë.

**4.25. Investime në pasuri të paluajtshme**

Investimet në pasuri të paluajtshme janë aktive të mbajtura ose për të fituar të ardhura nga qiraja ose për rivlerësim të vlerës së tyre ose për të dyja, por jo për përdorim në prodhim apo furnizim me të mira materiale, shërbime apo për qëllime administrative. Banka mban investime në pasuritë e paluajtshme si pasojë e përfitimit të tyre nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve mbi kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve. Pasuritë e paluajtshme për investim maten fillimisht me kosto dhe më pas me vlerën e drejtë, ku çdo ndryshim i tyre njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në zërin “të ardhura të tjera”.

Çdo fitim apo humbje e gjeneruar gjatë shitjes së pasurive të paluajtshme të mbajtura për investim (të llogaritur si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të këtij aktivi) njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Në rast se përdorimi i këtij aktivi ndryshon në mënyrë të tillë që riklasifikohet si aktiv i trupëzuar ose aktiv i mbajtur për shitje, vlera e drejtë e tij në momentin e riklasifikimit bëhet kosto e tij për regjistrimet kontabël të mëpasshme.

**4.26. Inventarët dhe aktivitetet e marra në pronësi**

Inventarët dhe aktivitetet e marra në pronësi fillimisht maten me kosto dhe më pas me më të voglën e koston dhe vlerës neto të realizueshme (“VNR”). Kosto përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kosto të tjera që mund të ndodhin për të sjellë inventarin në vendndodhjen aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë një situatë normale biznesi, pakësuar me kostot e vlerësuar për realizimin dhe ato të vlerësuar të nevojshme për të bërë shitjen.

Inventarët përfshihen në Aktive të tjera në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar. Banka mban inventarët në formën e inventarëve për konsum. Inventarët për konsum janë materiale të blera me qëllim konsumin e tyre gjatë ofrimit të shërbimeve bankare.



#### **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **4.26. Inventarët dhe aktivet e marra në pronësi (vazhdim)**

Kolaterale të marra në pronësi janë pasuri të paluajtshme të përfituara nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve mbi kreditë dhe paradhëniet e klientëve. Për transferimet nga Investime në pasuri të paluajtshme që mbahen me vlerë të drejtë tek Inventaret, si kosto për kontabilizimin në këtë kategori do të jetë vlera e drejtë në datën në të cilën bëhet transferimi.

Çdo zvogëlim në VNR njihet si një shpenzim në periudhën në të cilën ky zvogëlim ndodh; çdo rimarrje njihet në pasqyrën e veçantë të të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën rimarrja ndodh.

##### **4.27. Humbje nga zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare**

Vlera kontabël e aktiveve jofinanciare të Bankës, përveç tatimeve të shtyra, rishikohen çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Në rast se ka një tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në rast se vlera kontabël e aktivitetit është më e madhe se vlera e tij e rikuperueshme.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë duke zbritur koston për shitje. Në përcaktimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara të pritshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerën në kohë të parasë në treg dhe risqet specifike të aktivitetit. Humbjet për zhvlerësim njihen në pasqyrën e veçantë të fitim humbjeve.

Humbja për zhvlerësim kthehet mbrapsht deri në masën që vlera kontabël nuk kalon vlerën e mbartur të aktivitetit, neto nga zhvlerësimet e amortizimet, e cila do të ishte në rast se nuk do të ishin njohur humbje nga zhvlerësimi.

##### **4.28. Depozitat, marrëveshjet e riblerjes dhe borxhi i varur**

Depozitat, marrëveshjet e riblerjes dhe borxhi i varur janë burimet e Bankës për financim.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo), marrëveshja kontabilizohet si një detyrim financiar, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

##### **4.29. Provizionet**

Provizioni është njohur nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të mjeteve monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, rreziqet specifike ndaj detyrimit. Efektet e vlerës kohore nëpërmjet skontimeve njihen si kosto financiare.

##### **4.30. Garancitë financiare, letërkreditë dhe angazhimet e patërhequra për kreditë**

Si pjesë e biznesit të saj, Banka lëshon garanci financiare, të përbërë nga letra kredie, garanci dhe pranime.

Garancitë financiare fillimisht njihen në pasqyrat financiare (brenda Provigjoneve) me vlerë të drejtë, duke qënë primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës sipas secilës garanci matet me vlerën më të madhe mes shumës së njohur fillimisht pakësuar me amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe një fond zhvlerësimi ECL siç përcaktohet në Shënimin 37.

Primi i marrë njihet në pasqyrën e të ardhurave në Të ardhurat nga komisionet në përpjesëtim të drejtë gjatë jetës së garancisë.

Angazhimet për kredi dhe letrat e kredive janë angazhime nën të cilat, gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, Bankës i kërkohej të ofrojë një hua me terma të paracaktuar për klientin. Ngjashëm me kontratat e garancisë financiare këto kontrata janë në kuadër të kërkesave të ECL.

Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare, letrave të kreditit dhe angazhimeve të kredisë, ku huatë e dakorduara për t'u ofruar janë në terma të tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlerat nominale të këtyre instrumentëve së bashku me ECL-të përkatëse janë shpalosur në Shënimin 37.

#### 4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.31. Kapitali

Elementet e Kapitalit janë kapitali aksionar, primet e aksioneve dhe rezervat. Rezervat përfshijnë rezervat ligjore dhe të përgjithshme (Shënimi 22.1), rezervën nga bashkimi dhe rezervën nga vlera e drejtë. Rezerva për vlerën e drejtë përfshin ndryshimin neto në vlerën e drejtë për instrumentet e klasifikuara si VDATGJ, pakësuar me zhvlerësimin për ECL. Lëvizjet në elementet e kapitalit janë treguar në Shënimin 22.

##### 4.32. Përfitimet e punonjësve

###### *Planet e përcaktuara të kontributeve*

Detyrimet për kontributet për planet e përcaktuara të pensioneve njihen si një shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute të detyrueshme për sigurimet shoqërore për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

###### *Përfitimet afatshkurtra*

Detyrimet afatshkurtra për përfitimet e punonjësve maten në një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime kur ofrohet shërbimi. Një provigjon është njohur për shumën që pritet të paguhet si bonus afatshkurtër në para ose planeve me ndarje fitimi nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi, dhe detyrimi mund të matet me besueshmëri.

##### 4.33. Adaptimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara

Standardet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standardeve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve kontabël janë efektive për periudhën aktuale, por adaptimi i tyre nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Bankës:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjata materiale; SNK 37 Provizionet, Detyrimet e kushtëzuara dhe Aktivët e kushtëzuara si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshime)** - Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me leje për aplikim të mëparshëm IASB ka lëshuar ndryshime me standarde të ngushta në Standardet e SNRF si më poshtë:
  - **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)** përditësojnë një reference në SNRF 3 në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit.
  - **SNK 16 Aktivët e trupëzuara (Ndryshimet)** ndalojnë që një Bankë të zbrisë nga kostoja e aktiveve të trupëzuara shumat e marra nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa Banka po përgatit aktivin për përdorimin vetjak. Në vend të kësaj, një Bankë do të njohë të ardhurat e tilla të shitjeve dhe koston e lidhur në fitim ose humbje.
  - **SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara (Ndryshimet)** specifikojnë së cilat kosto përfshin një Bankë në përcaktimin e koston së përmbushjes së një kontrate për qëllimin e vlerësimit nëse një kontratë është përmbushur apo jo.
  - **Përmirësimet Vjetore 2018-2020** bëjnë ndryshime të vogla në SNRF 1 Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia dhe Shembuj ilustrues shoqëruar të SNRF 16 Qiratë.
- **SNRF 16 Qiratë-Covid 19 Koncesionet e Qirasë përtej datës 30 qershor 2021 (Amendament):** Amendamenti zbatohet për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 prill 2021, me aplikim të mëhershëm të lejuar, duke përfshirë në pasqyrat financiare të paautorizuara ende për publikim në datën e lëshimit të amendamentit. Në mars 2021, Bordi ndryshoi kushtet e dobisë praktike në SNRF 16 që ofron lehtësim për qiramarrësit nga zbatimi i udhëzimit të SNRF 16 mbi modifikimet e qirasë për koncesionet e qirasë që lindin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid-19. Pas ndryshimit, leverdia praktike tani zbatohet për koncesionet e qirasë, për të cilat çdo reduktim në pagesat e qirasë prek vetëm pagesat që fillimisht duhet të paguhet më 30 qershor 2022 ose para datës 30 qershor 2022, me kusht që të plotësohen kushtet e tjera për aplikimin e leverdisë praktike. Drejtimi ka vlerësuar se ndryshimi nuk do të ketë ndikim.

##### 4.34. Impakti i standardeve të reja ende të pa adaptuara

Standardet e reja dhe të rishikuara dhe interpretimet që janë lëshuar por që ende nuk janë efektive deri në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave të Bankës, janë dhënë më poshtë. Banka ka për qëllim të adaptojë këto standarde të reja dhe të rishikuara, nëse janë të aplikueshme, kur të bëhen efektive.

**4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)****4.34. Impakti i standardeve të reja ende të pa adaptuara (vazhdim)**

- **SNRF 17: Kontratat e sigurimit** - Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikim më të hershëm të lejuar, me kusht që njësia ekonomike të zbatojë gjithashtu SNRF 9 Instrumentet Financiare në ose përpara datës kur zbaton për herë të parë SNRF 17. Ky është një gjithëpërfshirës standard i ri i kontabilitetit për kontratat e sigurimit, që mbulon njohjen dhe matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit të lëshuara, si dhe për garancitë dhe instrumentet financiare të caktuara me kontrata pjesëmarrjeje diskrecionale. Banka nuk lëshon kontrata në objektin e SNRF 17; prandaj zbatimi i tij nuk ka ndikim në performancën financiare, pozicionin financiar ose flukset monetare të Bankës.
- **Ndryshime në SNRF10 Pasqyra Financiare të Konsoliduara Dhe SNK 28 Investime në Sipërmarrje të Përbashkëta – Shitja ose Kontributi në Aktive ndërmjet Investitorit dhe ortakut apo ndërmarrjes së përbashkët** - Ndryshimet adresojnë një mospërputhje të pranuar midis kërkesave në SNRF 10 dhe atyre në SNK 28, në trajtimin e shitjes ose kontributit të aktiveve midis një investitori dhe ortakut të tij ose ndërmarrjes së përbashkët. Pasoja kryesore e ndryshimeve është që një fitim ose humbje e plotë të njihet kur një transaksion përfshin një biznes (pavarësisht nëse është i vendosur në një filial apo jo). Një fitim ose humbje e pjesshme njihet kur një transaksion përfshin aktive që nuk përbëjnë një biznes, edhe nëse këto aktive janë të vendosura në një filial.
- **Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i detyrimeve si Korrentë dhe Jo-korrentë (Ndryshimet)** - Ndryshimet janë efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024, me aplikim më të hershëm të lejuar dhe do të duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8. Objektivi i ndryshimeve është të qartësojë parimet në SNK 1 për klasifikimi i detyrimeve si korente ose afatgjata. Ndryshimet sqarojnë kuptimin e një të drejte për të shtyrë shlyerjen, kërkesën që kjo e drejtë të ekzistojë në fund të periudhës raportuese, që qëllimi i menaxhimit të mos ndikojë në klasifikimin aktual ose jo-aktual, se opsionet nga pala tjetër që mund të rezultojnë në shlyerje nga transferimi i instrumenteve të kapitalit të vet të njësisë ekonomike nuk ndikojnë në klasifikimin aktual ose afatgjatë. Gjithashtu, ndryshimet specifikojnë se vetëm marrëveshjet me të cilat një njësi ekonomike duhet të pajtohet në ose përpara datës së raportimit do të ndikojnë në klasifikimin e një pasivi. Gjithashtu kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese shtesë për detyrimet afatgjata që rrjedhin nga marrëveshjet e huasë që i nënshtrohen marrëveshjeve që duhet të respektohen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit. Menaxhmenti ka vlerësuar ndryshimet dhe nuk ka ndikim në pasqyrat financiare
- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikës së SNRF 2: Shpalosja e politikave të Kontabilitetit (Ndryshimet):** Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023 me leje për aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet ofrojnë udhëzime për zbatimin e gjykimeve të materialitetit në dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Në veçanti, ndryshimet në SNK 1 zëvendësojnë kërkesën për të shpalosur politikat kontabël 'të rëndësishme' me një kërkesë për të shpalosur politikat kontabël 'materiale'. Gjithashtu, udhëzime dhe shembuj ilustrues janë shtuar në Deklarimin e Praktikës për të ndihmuar në zbatimin e konceptit të materialitetit kur bëhen gjykime rreth dhënies së informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Meqenëse ndryshimet në deklaratën e praktikës 2 ofrojnë udhëzime jo të detyrueshme për zbatimin e përkufizimit të materialit në informacionin e politikave kontabël, një datë efektive për këto ndryshime nuk është e nevojshme. Banka aktualisht është duke rishikuar dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave të saj kontabël për të siguruar konsistencën me kërkesat e amenduara në vijim.
- **SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet):** Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikim më të hershëm të lejuar dhe zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe. Ndryshimet prezantojnë një përkufizim të ri të vlerësimeve kontabël, të përcaktuara si shuma monetare në pasqyrat financiare që janë subjekt i pasigurisë në matje. Gjithashtu, ndryshimet sqarojnë se cilat janë ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe si ndryshojnë këto nga ndryshimet në politikat kontabël dhe korrigjimet e gabimeve. Menaxhmenti ka vlerësuar ndryshimet dhe nuk ka ndikim në pasqyrat financiare.
- **SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet)** - Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023 me aplikim të mëhershëm të lejuar. Në maj 2021, Bordi nxori ndryshime në

#### 4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.34. Impakti i standardeve të reja ende të pa adaptuara (vazhdim)

SNK 12, të cilat ngushtojnë objektin e përjashtimit të njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikojnë se si kompanitë duhet të llogarisin për tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e çaktivizimit. Sipas ndryshimeve, përjashtimi i njohjes fillestare nuk zbatohet për transaksionet që, në njohjen fillestare, krijojnë diferenca të përkohshme të barabarta të tatueshme dhe të zbritshme. Ai zbatohet vetëm nëse njohja e një aktivi me qira dhe pasivi i qirasë (ose pasivi i çaktivizimit dhe komponenti i aktivitetit të çmontimit) sjellin diferenca të përkohshme të tatueshme dhe të zbritshme që nuk janë të barabarta.

- **SNRF 16 Qiratë: Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe kthim me qira (ndryshimet)** - Ndryshimet janë efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024, me aplikim më të hershëm të lejuar. Ndryshimet synojnë të përmirësojnë kërkesat që përdor një shitës-qiramarrës në matjen e detyrimit të qirasë që lind nga një transaksion shitje dhe kthimi me qira në SNRF 16, ndërkohë që nuk ndryshon kontabilitetin për qiratë që nuk lidhen me transaksionet e shitjes dhe të kthimit me qira. Në veçanti, shitësi-qiramarrësi përcakton "pagesat e qirasë" ose "pagesat e qirasë të rishikuara" në mënyrë të tillë që shitësi-qiramarrësi të mos njohë asnjë shumë të fitimit ose humbjes që lidhet me të drejtën e përdorimit që ruan. Zbatimi i këtyre kërkesave nuk e pengon shitësin-qiramarrësin të njohë, në fitim ose humbje, çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë. Një shitës-qiramarrës e zbaton ndryshimin në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 për transaksionet e shitjes dhe kthimit me qira të kryera pas datës së aplikimit fillestar, duke qenë fillimi i periudhës vjetore të raportimit në të cilën një njësi ekonomike zbatoi për herë të parë SNRF 16. Nuk pritet asnjë ndikim nga amendament pasi Banka nuk hyn në transaksione të tilla.

#### 5. PËRDORIMI I GJYKIMEVE, VLERËSIMEVE DHE SUPOZIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF kërkon nga drejtimi që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën ndodh rishikimi dhe ato të ardhshme të cilat mund të preken nga ky ndryshim. Drejtimi diskuton me Komitetin e Auditimit, zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kritike kontabël të Bankës dhe aplikimin e tyre, si dhe supozimet e bera në lidhje me paqartësitë kryesore të vlerësimit. Informacioni rreth pasigurisë së supozimeve dhe vlerësimeve që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material brenda vitit të ardhshëm financiar, dhe rreth gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare të veçanta është sqaruar më poshtë.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shih Shënimin 38).

##### 5.1. Vlerësimi i modelit të biznesit

Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare varen nga rezultatet e testeve SPPI dhe modelit të biznesit të Bankës. Banka përcakton modelin e biznesit në një nivel që reflekton mënyrën sesi grupe të aktiveve financiare menaxhohen së bashku për të arritur një objektiv të caktuar të biznesit. Ky vlerësim përfshin gjykime që reflektojnë të gjithë evidencat e vlefshme duke përfshirë dhe mënyrën e vlerësimit të performancës së një aktivi dhe matjen e saj, rreziqet që ndikojnë performancën e aktiveve financiare dhe se si këto menaxhohen, dhe si menaxherët e aktiveve kompesohen. Banka monitoron aktivet financiare të matura me koston e amortizuar të cilat janë çregjistruar para datës së maturimit për të kuptuar arsyen e këtij çregjistrimi dhe nëse arsyet janë konsistente me objektivin e biznesit për të cilin është mbajtur ky aktiv. Shitjet e rastësishme të aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar afër maturitetit të tyre nuk konsiderohen si një ndryshim në këtë model biznesi. Monitorimi është pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të Bankës për të parë nëse modeli i biznesit nën të cilin mbahen pjesa e mbetur e aktiveve financiare vazhdon të jetë i përshtatshëm dhe nëse nuk është i tillë, nëse ka patur një ndryshim në modelin e biznesit dhe në këtë mënyrë në vazhdim të ndryshojë klasifikimin e këtyre aktiveve.

## **5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE, GJYKIMEVE DHE SUPOZIMEVE (VAZHDIM)**

### **5.2. Zhvlerësimi**

Matja e humbjes nga zhvlerësimi nën SNRF 9 për të gjitha kategoritë e aktiveve financiare kërkon një gjykim, veçanërisht në vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve të arkëtimeve të pritshme dhe vlerave të kolateraleve gjatë përcaktimit të humbjes së zhvlerësimit dhe përcaktimit të rritjes të rëndësishme në rrezikun e kredisë. Këto vlerësime drejtohen nga një numër faktorësh, ndryshimet e të cilëve mund të çojnë në nivele të ndryshme të fondeve të zhvlerësimit.

Përlllogaritjet për ECL që bën Banka janë rezultat i modeleve komplekse me një sërë supozimesh që kanë të bëjnë me zgjedhjen e inputeve të ndryshme dhe varesinë e tyre nga njëri-tjetri.

Elementet e modeleve për ECL që konsiderohen një gjykim dhe vlerësim kontabël përfshijnë:

- Kriteret e Bankës për të vlerësuar nëse ka patur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë dhe nëse fond i zhvlerësimit do duhet të matet si LTELC dhe vlerësimet cilësore,
- Segmentimi i aktiveve financiare kur ECL e tyre vlerësohet në baza kolektive,
- Zhvillimi i modeleve për ECL, duke përfshirë formula të ndryshme dhe zgjedhjen e inputeve,
- Përcaktimin e lidhjes midis skenarëve makroekonomik dhe inputeve ekonomike si nivelet e PBB dhe vlerave të kolateraleve, dhe efektin në PD-të, EAD-të dhe LGD-të,
- Përzgjedhjen e skenarëve makroekonomik që pritet të ndodhin për të përcaktuar inputet ekonomike në modelet e ECL-së.

Një vlerësim për të parë nëse një investim në borxhin qeveritar është zhvlerësuar mund të jetë i ndërlikuar. Në bërjen e një vlerësimi të tillë, Banka e konsideron vlerësimin e tregut të kreditimit, siç pasqyrohet në yield-in e obligacioneve, vlerësimet e agjencive të klasifikimit të kreditimit, aftësia e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për lëshimin e borxhit të ri, probabiliteti i ristrukturimit të borxhit duke rezultuar në humbje të mbajtësit nëpërmjet faljes vullnetare apo të detyrueshme së borxhit dhe mekanizmat ndërkombëtare të mbështetjes për të siguruar mbështetjen e nevojshme si “huadhënës i fundit” në atë vend po ashtu si dhe synimin, pasqyruar në deklaratat publike, në lidhje me gatishmerinë e qeverive dhe agjencive për të përdorur këto mekanizma. Kjo përfshin një vlerësim si për thellësinë e këtyre mekanizmave dhe, pavarësisht qëllimit politik, nëse ka kapacitet për të përmbushur kriteret e kërkuara.

### **5.3. Vlera e drejtë**

#### **5.3.1. Vlera e drejtë e instrumentëve financiar**

‘Vlera e drejtë’ e një instrumenti financiar është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në një treg primar në datën e matjes, nën kushtet aktuale të tregut, pavarësisht faktit nëse çmimi është drejtpërdrejt i kuotuar apo vlerësohet nëpërmjet teknikave të matjes. Kur vlera e drejtë e një aktivi financiar të regjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të derivohet nga tregjet aktive, ajo përcaktohet duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi që përfshijnë përdorimin e modeleve të vlerësimit të përshkruara në Shënimin 37. Inputet në këto modele, aty ku munden, merren nga tregjet aktive, por në rastet kur këto nuk janë të mundshme, përcaktimi i vlerës së drejtë bëhet nëpërmjet vlerësimit. Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë transparencë të paktë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon shkallë të ndryshme të gjykimit në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik.

#### **5.3.2. Vlera e drejtë e aktiveve jofinanciare**

Vlera e drejtë e investimeve në pasuri të paluajtshme dhe Vlera neto e realizueshme e kolateraleve të sekuestruara përcaktohet nga vlerësues pasurie të jashtëm ose të brendshëm, të cilët kanë kualifikime të duhura të njohura profesionale dhe njohuritë e nevojshme të vendndodhjes dhe kategorise të pronës që vlerësohet. Matja e vlerës së drejtë për të gjitha pronat në këto kategori, bazuar në teknikat e vlerësimit të përdorura (Shënimi 4.18), klasifikohen si Niveli 3 i vlerës së drejtë. Përveç vlerësimeve të pasurive disa vlerësime bëhen për të përcaktuar mundësinë e shitjes së aktiveve nën kategorinë e aseteve.

**5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE, GJYKIMEVE DHE SUPOZIMEVE (VAZHDIM)**

**5.4. Përcaktimi i afatit të qirasë për kontratat me opsinin e rinovimit dhe të përfundimit para afatit (Banka si qiramarrëse)**

Banka përcakton afatin e qirasë si periudha e paanullueshme e qirasë së bashku me periudhat e mbuluara nga një opsin për të zgjatur qiranë nëse ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë, ose periudhave të mbuluara nga një opsin për të përfunduar qiranë nëse ka sigurinë e arsyeshme për të mos e ushtruar atë. Banka ka disa kontrata që kanë opsionet për të zgjatur apo përfunduar afatin e qirasë. Banka bën gjykime gjatë vlerësimit nëse është e sigurt në mënyrë të arsyeshme nëse do të ushtrojë apo jo opsionet për të zgjatur apo përfunduar qiratë. Kjo do të thotë që konsideron të gjithë faktorët e rëndësishëm që krijojnë një nxitje ekonomike për Bankën për ushtruar ose rinovimin ose përfundimin. Pas datës së fillimit, Banka rivlerëson afatet e qirave nëse ka patur ndonjë ngjarje të rëndësishme ose ndryshim në rrethana që janë në kontrollin e saj që ndikojnë mundësinë e saj për të ushtruar ose jo opsinin e rinovimit apo përfundimit (psh. përmirësime të rëndësishme të ambientëve ose përshtatje të rëndësishme në aktivitet të marrë me qira).

**5.5. Përcaktimi i normës rritëse të huamarrjes**

Banka nuk mund të përcaktojë normën e interesit të nënkuptuar të qirasë, për këtë, ajo përdor normën rritëse të huamarrjes ('IBR') për të matur detyrimet për qiratë. IBR është norma e interesit që Banka do kishte paguar për të marrë hua në afate të ngjashme fondet e nevojshme për të përfunduar një aktiv në vlerë të njëjtë me vlerën e aktivitet me të drejtë përdorimi në një ambient të ngjashëm ekonomik. Për këtë IBR reflekton atë çfare Banka 'do duhej të paguajë', e cila kërkon një vlerësim kur mungojnë normat e vëzhgueshme në treg ose kur ato do duhet të rregullohen për të reflektuar kushtet e qirasë (psh, kur qiraja është në monedhë të ndryshme nga ajo e normave të listuara). Banka vlerëson IBR duke përdorur inputet e vëzhgueshme (siç janë normat e interesit në treg) kur ato janë të mundshme dhe i duhet të bëjë disa rregullime specifike për to.

**6. ARKA DHE LLOGARI ME BANKËN QENDRORE**

Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore janë të detajuara si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Arka	2,522,137	1,863,078
<i>Banka Qendrore:</i>		
Llogari rrjedhëse	5,050,924	2,286,709
Rezerva e detyrueshme	5,764,378	5,335,429
Interesi i përllogaritur	549	131
Fond për zhvlerësim	(5,336)	(2,712)
<b>Totali</b>	<u><b>13,332,652</b></u>	<u><b>9,482,635</b></u>

Rezerva e detyrueshme përfaqëson një minimum shumë të depozituar të mbajtur në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë. Kjo rezervë nuk është për përdorim ditor, megjithatë bazuar në rregulloret e aplikueshme, gjatë muajit Banka mund të përdorë deri në 70% (2021:70%) të rezervës së detyrueshme në LEK, duke siguruar që gjendja mesatare mujore e llogarive me Bankën Qendrore (llogaritë rrjedhëse plus rezerva e detyrueshme) të mos jetë më poshtë së niveli i rezervës së detyrueshme. Kjo rezervë përllogaritet si një përqindje mbi llogaritë e klientëve të Bankës. Norma e rezervës është e ndryshme në varesi të monedhës dhe maturimit të depozitave të klientëve. Norma e rezervës së detyrueshme është:

- 7.5% për depozitat në Lek të klientëve me një maturim fillestar deri në 12 muaj,
- 5.0% për depozitat në Lek të klientëve me një maturim fillestar mbi 12 muaj por deri në 24 muaj,
- 12.5% për depozitat në monedhë të huaj, kur raporti i “ Depozitave në monedhë të huaj me totalin e depozitave” është deri në 50%,
- 20% për depozitat në monedhë të huaj, kur raporti i “ Depozitave në monedhë të huaj me totalin e depozitave” është me i madh së 50%.

**6. ARKA DHE LLOGARI ME BANKËN QENDRORE (VAZHDIM)**

Nje analizë e ndryshimeve në vlerën bruto dhe vlerat korresponduese të humbjeve të pritshme jepet më poshtë:

	Klasa 1	
	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Vlera e mbartur bruto më 1 janar</b>	<b>9,485,347</b>	<b>8,425,127</b>
Aktive të reja	4,440,852	1,790,660
Aktive të maturuar ose paguar	(216,051)	(654,648)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(372,160)	(75,792)
<b>Vlera e mbartur bruto më 31 dhjetor</b>	<b>13,337,988</b>	<b>9,485,347</b>

	Klasa 1	
	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>ECL më 1 janar</b>	<b>2,712</b>	<b>3,366</b>
Aktive të reja	2,624	206
Aktive të maturuar ose paguar	-	(860)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	-	-
<b>ECL më 31 dhjetor</b>	<b>5,336</b>	<b>2,712</b>

**7. DEPOZITA DHE LLOGARI ME BANKAT**

Depozitat dhe llogaritë me bankat janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
<b>Llogari rrjedhëse:</b>		
Jo-rezidentë	2,258,503	4,073,038
	<b>2,258,503</b>	<b>4,073,038</b>
<b>Depozita:</b>		
Rezidentë	280,000	-
Jo-rezidentë	2,263,060	-
	<b>2,543,060</b>	-
Llogari të tjera (Jo-rezidentë)	366,441	905,889
Interesi i përlllogaritur	4,640	-
Zhvlerësimet për humbjet e pritshme	(28,501)	(2,331)
<b>Totali</b>	<b>5,144,143</b>	<b>4,976,596</b>

Llogari të tjera përfaqësojnë llogari te bllokuara ("escrow") në bankë të cilat përdoren si kolateral për garancitë e lëshuara.

Të gjithë aktivet në depozita dhe llogari me bankat janë në Klasën 1 dhe nuk ka patur transferime ndërmjet klasave që nga fillimi i periudhës krahasuese. Një analizë e ndryshimeve në vlerën bruto dhe vlerat korresponduese të humbjeve të pritshme jepet më poshtë:

	Klasa 1	
	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
<b>Vlera e mbartur bruto më 1 janar</b>	<b>4,978,927</b>	<b>4,219,628</b>
Aktive të reja	2,969,370	2,204,924
Aktive të çregjistruar ose paguar	(2,519,586)	(1,477,317)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(256,067)	31,692
<b>Vlera e mbartur bruto më 31 dhjetor</b>	<b>5,172,644</b>	<b>4,978,927</b>

## 7. DEPOZITA DHE LLOGARI ME BANKAT (VAZHDIM)

	Klasa 1	
	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
<b>ECL më 1 janar</b>	<b>2,331</b>	<b>5,889</b>
Aktive të reja	26,815	871
Aktive të çregjistruar ose paguar	(523)	(4,495)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(122)	66
<b>ECL më 31 dhjetor</b>	<b>28,501</b>	<b>2,331</b>

## 8. LETRAT ME VLERË TË INVESTIMIT

Më poshtë jepet një analizë e letrave me vlerë të Bankës të matura me VDATGJ dhe me kosto të amortizuar

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
<b>Instrumentë borxhi me VDFH:</b>		
Bonde të qeverisë Shqiptare mbajtur për tregtim	72,867	-
<b>Totali i instrumentëve me VDFH</b>	<b>72,867</b>	<b>-</b>
<b>Instrumentë borxhi me VDATGJ:</b>		
Bonde të qeverisë Shqiptare	679,413	851,106
<b>Totali i instrumentëve me VDATGJ</b>	<b>679,413</b>	<b>851,106</b>
<b>Instrumentë borxhi me kosto të amortizuar:</b>		
Bono Thesari Shqiptare	1,756,344	2,399,844
Bonde të qeverisë Shqiptare	24,114,708	23,004,731
Bonde të qeverive të huaja	583,620	522,891
Bonde korporative	2,019,388	977,361
Zhvlerësimet për humbjet e pritshme	(80,635)	(60,002)
<b>Totali i instrumentëve me kosto të amortizuar</b>	<b>28,393,425</b>	<b>26,844,825</b>

Instrumente borxhi të mbajtura për tregtim janë bonde të qeverisë Shqiptare të blera nga Banka. Vlera nominale e këtyre instrumenteve është 80,000 mijë Lekë. Gjatë vitit 2022, Banka shiti disa nga këto letra me vlerë dhe gjeneroi një fitim prej 1,055 mijë Lekë, përfshirë në Fitimin neto nga tregtimi në paqyrën e fitim humbjes.

Gjatë vitit 2021, Banka shiti 5 milionë euro letra me vlerë investimi VDATGJ dhe si rezultat u bë një transferim prej 33,730 mijë Lekë nga fitimet e përcaktuara nga ATGJ (të ardhura të tjera gjithpërfshirëse) në paqyrën e të ardhurave. Gjatë vitit 2022 nuk pati ndonjë shitje të tillë.

Detajet e këtyre instrumentëve më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 prezantohen më poshtë:

	31 dhjetor 2022				
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interes i përlllogaritur	Efekti i rivlerësimit	Vlera kontabël
Qeveria Shqiptare	818,187	(12,723)	3,343	(129,394)	679,413
<b>Totali</b>	<b>818,187</b>	<b>(12,723)</b>	<b>3,343</b>	<b>(129,394)</b>	<b>679,413</b>
	31 dhjetor 2021				
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interes i përlllogaritur	Efekti i rivlerësimit	Vlera kontabël
Qeveria Shqiptare	863,244	(14,928)	3,308	(518)	851,106
<b>Totali</b>	<b>863,244</b>	<b>(14,928)</b>	<b>3,308</b>	<b>(518)</b>	<b>851,106</b>

Banka më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 nuk kishte instrumentë borxhi të matura me VDATGJ të cilat të ishin përdorur si kolateral.



**8. LETRAT ME VLERË TË INVESTIMIT (VAZHDIM)**

Bonot e Thesarit të emetuar nga qeveria Shqiptare sipas maturimit fillestar paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022			31 dhjetor 2021		
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Vlera kontabël	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Vlera kontabël
6 muaj	100,000	(1,856)	98,144	-	-	-
12 muaj	1,697,790	(39,590)	1,658,200	2,420,200	(20,356)	2,399,844
<b>Totali</b>	<b>1,797,790</b>	<b>(41,446)</b>	<b>1,756,344</b>	<b>2,420,200</b>	<b>(20,356)</b>	<b>2,399,844</b>

Bondet me kosto të amortizuar tregohen më poshtë sipas entitetit emetues. Interesi paguhet çdo gjashtë muaj dhe çdo vit.

	31 dhjetor 2022			
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interes i përlllogaritur	Vlera bruto
Qeveria Shqiptare	23,881,615	(138,317)	371,410	24,114,708
Qeveri të huaja	569,290	6,161	8,169	583,620
Korporatat	2,011,463	(3,282)	11,208	2,019,389
<b>Totali</b>	<b>26,462,368</b>	<b>(135,438)</b>	<b>390,787</b>	<b>26,717,717</b>

	31 dhjetor 2021			
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interes i përlllogaritur	Vlera bruto
Qeveria Shqiptare	22,607,076	62,452	335,203	23,004,731
Qeveri të huaja	491,889	22,982	8,021	522,892
Korporatat	955,832	16,284	5,244	977,360
<b>Totali</b>	<b>24,054,797</b>	<b>101,718</b>	<b>348,468</b>	<b>24,504,983</b>

Banka ka vendosur si kolateral letrat me vlerë për marrëveshjet e riblerjes me Bankën e Shqipërisë në vlerën 8,360,000 mijë Lekë (2021: 2,770,000 mijë Lekë).

Letrat me vlerë të investimit të matur me koston e amortizuar janë vlerësuar si më poshtë:

Vlerësimet e kompanisë Moody's ose të njëvlefshme	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Qeveria Shqiptare	<b>24,114,708</b>	<b>23,004,731</b>
Vlerësimi B+ (në euro)	2,342,376	2,027,396
I pavlerësuar	21,772,332	20,977,335
Qeveri të huaja	<b>583,620</b>	<b>522,892</b>
Vlerësimi Aa2	-	55,505
Vlerësimi Aa3	54,817	54,412
Vlerësimi A1	-	34,805
Vlerësimi A2	-	54,049
Vlerësimi A3	34,418	-
Vlerësimi Baa1	-	31,475
Vlerësimi Baa2	117,406	64,185
Vlerësimi Baa3	57,385	-
Vlerësimi Ba1	65,397	138,814
Vlerësimi Ba2	52,161	-
Vlerësimi Ba3	118,131	-
Vlerësimi B2	83,905	89,647
Korporata	<b>2,019,389</b>	<b>977,360</b>
Vlerësimi Aa2	57,657	43,610
Vlerësimi Aa3	334,158	161,070
Vlerësimi A1	38,732	31,845
Vlerësimi A2	89,923	151,589
Vlerësimi A3	206,132	99,793
Vlerësimi Baa1	784,276	200,442
Vlerësimi Baa2	367,604	266,141
Vlerësimi Baa3	140,907	22,870
<b>Totali</b>	<b>26,717,717</b>	<b>24,504,983</b>

**8. LETRAT ME VLERË TË INVESTIMIT (VAZHDIM)**

Letrat me vlerë me koto të amortizuar janë grupuar me poshte sipas vendit emetues:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Qeveria Shqiptare	24,114,708	23,004,731
Qeveri të huaja	583,620	522,892
Evrope	393,160	55,505
Azia dhe Paqesori	90,645	54,412
Lindje e Mesme	99,815	34,805
Amerika e Jugut	-	54,049
Korporata	2,019,389	977,360
Evrope	1,339,768	587,310
Amerika e Veriut	335,870	97,130
Azia dhe Paqesori	183,131	185,911
Lindje e Mesme	160,620	107,009

Të gjitha letrat me vlerë të investimit janë në Klasën 1 dhe nuk ka transferime ndërmjet klasave që nga fillimi i periudhave krahasuese.

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e drejtë për Letrat me vlerë të mbajtura me VDFH paraqitet më poshtë:

	Klasa 1	
	2022	2021
<b>Vlera e drejtë më 1 janar</b>	-	-
Aktive të reja	490,217	-
Aktive të maturuar ose paguar	(413,596)	-
Ndryshime në Vlerën e drejtë	(3,754)	-
Transferime ndërmjet Klasave	-	-
<b>Vlera e drejtë më 31 dhjetor</b>	<b>72,867</b>	-

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe vlerat korresponduese të humbjeve të pritshme për Instrumentet e borxhit të matura me VDATGJ jepet më poshtë:

	Klasa 1	
	2022	2021
<b>Vlera e drejtë më 1 janar</b>	<b>851,106</b>	<b>659,680</b>
Aktive të reja	-	848,225
Aktive të maturuar ose paguar	-	(637,420)
Ndryshime në Vlerën e drejtë	(127,507)	(7,009)
Shumat e fshira	-	-
Interesa të rrjedhur	204	3,308
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(44,390)	(15,678)
<b>Vlera e drejtë më 31 dhjetor</b>	<b>679,413</b>	<b>851,106</b>

	Klasa 1	
	2022	2021
<b>ECL më 1 janar</b>	<b>2,377</b>	<b>1,763</b>
Aktive të reja	-	2,377
Aktive të çregjistruar, paguar ose të fshira	-	(1,721)
Transferime ndërmjet Klasave	-	-
Rimatje neto e ECL	4	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(124)	(42)
<b>ECL më 31 dhjetor</b>	<b>2,257</b>	<b>2,377</b>

**8. LETRAT ME VLERË TË INVESTIMIT (VAZHDIM)**

Një analizë e ndryshimeve në vlerën bruto dhe vlerat korresponduese të humbjeve të pritshme për Instrumentet e borxhit të matura me koston e amortizuar jepet më poshtë:

	Klasa 1	
	2022	2021
<b>Vlera e mbartur bruto më 1 janar</b>	<b>26,904,827</b>	<b>24,273,042</b>
Aktive të reja	8,225,818	8,510,238
Aktive të maturuar ose paguar	(6,479,094)	(5,854,256)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(177,490)	(24,197)
<b>Vlera e mbartur bruto më 31 dhjetor</b>	<b>28,474,061</b>	<b>26,904,827</b>

	Klasa 1	
	2022	2021
<b>ECL më 1 janar</b>	<b>60,002</b>	<b>67,714</b>
Aktive të reja	18,330	18,805
Aktive të maturuar ose paguar	(11,264)	(16,835)
Rimatja neto e ECL	13,959	(9,551)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(391)	(131)
<b>ECL më 31 dhjetor</b>	<b>80,636</b>	<b>60,002</b>

**9. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT**

Hua dhe paradhënie për klientët detajohen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Hua dhe paradhënie	43,538,686	37,436,071
Interesa të rrjedhura	155,116	133,336
Të ardhura të shtyra pjesë e NEI	(216,597)	(185,087)
<b>Vlera Bruto</b>	<b>43,477,205</b>	<b>37,384,320</b>
Zhvlerësimet për humbjet e pritshme	(1,797,785)	(1,688,858)
<b>Totali</b>	<b>41,679,420</b>	<b>35,695,462</b>

Tabela më poshtë tregon levizjen në humbjet e pritshme (ECL):

	2022	2021
<b>ECL më 1 janar</b>	<b>1,688,858</b>	<b>1,864,291</b>
Shtesat gjatë vitit	341,845	206,909
Shuma të fshira	(174,969)	(358,669)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(57,949)	(23,673)
<b>ECL më 31 dhjetor</b>	<b>1,797,785</b>	<b>1,688,858</b>

Huatë dhe paradhëniet për klientët fitojnë interesa me normat si më poshtë:

Monedha	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
LEK	3.40% - 25.0% në vit	2.40% - 25.0% në vit
EUR	1.30% - 19.0% në vit	1.00% - 19.0% në vit
USD	5.00% - 10.0% në vit	3.00% - 10.0% në vit

Banka ka dhënë disa hua me norma interesi nën nivelet më të ulta të treguara më lart, të cilat janë nën normat që janë ofruar në përgjithësi nga Banka, të cilat janë të mbrojtura me kolateral.

## 9. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Huatë e dhëna personelit të Bankës më 31 dhjetor 2022 janë 784,142 mijë Lekë (2021 : 604,803 mijë Lekë) dhe mbartin norma interesi vjetore që janë 1.8% deri në 3.4% nën normat e ofruara klientëve të saj per kredite me hipotekë dhe konsumatore.

Banka ka dhënë hua për institucione financiare rezidentë. Këto kredi maturohen një periudhë nga 1 në 5 vite (2021: 1 deri 5 vjet) dhe mbartin interesa që variojnë nga 2.1% deri në 8.0% në vit. (2021: 2.1% deri në 8.0% në vit).

Kredia sipas klientëve dhe produkteve paraqitet më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022		
	Vlera e mbartur bruto	Fondi ECL	Vlera neto
Klientët individë			
Kredi me hipotekë	11,474,890	(141,554)	11,333,336
Kredi konsumatore	7,636,791	(414,143)	7,222,648
Overdraft dhe karta	342,282	(58,729)	283,553
<b>Kredi për individë</b>	<b>19,453,963</b>	<b>(614,426)</b>	<b>18,839,537</b>
<b>Kredi për biznese</b>	<b>24,023,242</b>	<b>(1,183,359)</b>	<b>22,839,883</b>
<b>Totali</b>	<b>43,477,205</b>	<b>(1,797,785)</b>	<b>41,679,420</b>

	Më 31 dhjetor 2021		
	Vlera e mbartur bruto	Fondi ECL	Vlera neto
Klientët individë			
Kredi me hipotekë	10,080,561	(127,156)	9,953,405
Kredi konsumatore	6,142,948	(383,538)	5,759,410
Overdraft dhe karta	317,418	(64,238)	253,180
<b>Kredi për individë</b>	<b>16,540,927</b>	<b>(574,932)</b>	<b>15,965,995</b>
<b>Kredi për biznese</b>	<b>20,843,393</b>	<b>(1,113,926)</b>	<b>19,729,467</b>
<b>Totali</b>	<b>37,384,320</b>	<b>(1,688,858)</b>	<b>35,695,462</b>

### 9.1. Fond i zhvlerësimit për hua dhe paradhënie për klientët

Një analizë e ndryshimeve në vlerën bruto dhe vlerat korresponduese të humbjeve të pritshme për secilën nga kategoritë e mësipërme, jepet më poshtë:

#### Kredi me hipotekë

	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Totali
<b>Vlera e mbartur bruto më 1 janar 2021</b>	<b>7,497,944</b>	<b>852,667</b>	<b>472,153</b>	<b>8,822,764</b>
Aktive të reja	2,814,886	-	-	2,814,886
Aktive të çregjistruar ose paguar	(1,145,063)	(128,684)	(131,941)	(1,405,688)
Transferime në Klasën 1	520,910	(490,395)	(30,515)	-
Transferime në Klasën 2	(318,146)	397,059	(78,913)	-
Transferime në Klasën 3	(92,879)	(58,410)	151,289	-
Shuma të fshira	-	-	(7,839)	(7,839)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(120,105)	(15,574)	(7,883)	(143,562)
<b>Vlera e mbartur bruto më 31 dhjetor 2021</b>	<b>9,157,547</b>	<b>556,663</b>	<b>366,351</b>	<b>10,080,561</b>
Aktive të reja	3,276,454	-	-	3,276,454
Aktive të çregjistruar ose paguar	(1,379,469)	(78,085)	(48,911)	(1,506,465)
Transferime në Klasën 1	204,831	(201,772)	(3,059)	-
Transferime në Klasën 2	(182,411)	261,560	(79,149)	-
Transferime në Klasën 3	(76,295)	(61,617)	137,912	-
Shuma të fshira	-	-	(7,894)	(7,894)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(332,020)	(20,727)	(15,019)	(367,766)
<b>Vlera e mbartur bruto në 31 dhjetor 2022</b>	<b>10,668,637</b>	<b>456,022</b>	<b>350,231</b>	<b>11,474,890</b>

(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

**9. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT (VAZHDIM)****9.1 Fondi i zhvlerësimit për hua dhe paradhënie për klientët (vazhdim)***Kredi me hipotekë*

	<b>Klasa 1</b>	<b>Klasa 2</b>	<b>Klasa 3</b>	<b>Totali</b>
<b>ECL më 1 janar 2021</b>	<b>9,303</b>	<b>15,119</b>	<b>89,139</b>	<b>113,561</b>
Aktive të reja	17,495	-	-	17,495
Aktive të çregjistruar ose paguar	(695)	(2,015)	(11,025)	(13,735)
Transferime në Klasën 1	11,222	(6,254)	(4,968)	-
Transferime në Klasën 2	(2,379)	16,058	(13,679)	-
Transferime në Klasën 3	(12,515)	(2,060)	14,575	-
Rimatja neto e ECL	(8,369)	(107)	28,365	19,889
Shuma të fshira	-	-	(7,839)	(7,839)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(198)	(323)	(1,694)	(2,215)
<b>ECL më 31 dhjetor 2021</b>	<b>13,864</b>	<b>20,418</b>	<b>92,874</b>	<b>127,156</b>
Aktive të reja	18,198	-	-	18,198
Aktive të çregjistruar ose paguar	(623)	(1,171)	(3,392)	(5,186)
Transferime në Klasën 1	8,775	(8,615)	(160)	-
Transferime në Klasën 2	(1,988)	14,286	(12,298)	-
Transferime në Klasën 3	(7,807)	(1,836)	9,643	-
Rimatja neto e ECL	(3,949)	(4,447)	23,921	15,525
Shuma të fshira	-	-	(7,895)	(7,895)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(810)	(747)	(4,687)	(6,244)
<b>ECL më 31 dhjetor 2022</b>	<b>25,660</b>	<b>17,888</b>	<b>98,006</b>	<b>141,554</b>

*Kredi konsumatore*

	<b>Klasa 1</b>	<b>Klasa 2</b>	<b>Klasa 3</b>	<b>Totali</b>
<b>Vlera e mbartur bruto më 1 janar 2021</b>	<b>4,437,576</b>	<b>504,445</b>	<b>571,830</b>	<b>5,513,851</b>
Aktive të reja	2,846,890	-	-	2,846,890
Aktive të çregjistruar ose paguar	(1,788,256)	(115,013)	(196,136)	(2,099,405)
Transferime në Klasën 1	308,019	(303,332)	(4,687)	-
Transferime në Klasën 2	(202,638)	250,641	(48,003)	-
Transferime në Klasën 3	(105,310)	(60,928)	166,238	-
Shuma të fshira	-	-	(67,578)	(67,578)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(39,687)	(7,038)	(4,085)	(50,810)
<b>Vlera e mbartur bruto më 31 dhjetor 2021</b>	<b>5,456,594</b>	<b>268,775</b>	<b>417,579</b>	<b>6,142,948</b>
Aktive të reja	3,837,344	-	-	3,837,344
Aktive të çregjistruar ose paguar	(1,952,755)	(89,546)	(110,381)	(2,152,682)
Transferime në Klasën 1	80,529	(78,781)	(1,748)	-
Transferime në Klasën 2	(243,322)	262,415	(19,093)	-
Transferime në Klasën 3	(151,239)	(78,914)	230,153	-
Shuma të fshira	-	-	(56,346)	(56,346)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(125,112)	(5,248)	(4,113)	(134,473)
<b>Vlera e mbartur bruto më 31 dhjetor 2022</b>	<b>6,902,039</b>	<b>278,701</b>	<b>456,051</b>	<b>7,636,791</b>

## 9. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

## 9.1 Fondi i zhvlerësimit për hua dhe paradhënie për klientët (vazhdim)

Kredi konsumatore

	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Totali
<b>ECL më 1 janar 2021</b>	<b>75,057</b>	<b>43,616</b>	<b>339,565</b>	<b>458,238</b>
Aktive të reja	76,528	-	-	76,528
Aktive të çregjistruar ose paguar	(23,164)	(10,606)	(62,327)	(96,097)
Transferime në Klasën 1	14,735	(12,659)	(2,076)	-
Transferime në Klasën 2	(15,560)	30,277	(14,717)	-
Transferime në Klasën 3	(27,738)	(11,217)	38,955	-
Rimatja neto e ECL	(29,651)	(9,123)	52,166	13,392
Shuma të fshira	-	-	(67,578)	(67,578)

Veprimtaritë ristrukturuese përfshijnë marrëveshje pagesash me shtyrje afati, modifikimin dhe shtyrjen e pagesave. Në vijim të ristrukturimit, një kredi që më herët ishte në vonesë rivendoset në status normal dhe menaxhohet së bashku me kredi të tjera të ngjashme. Portofoli total i ristrukturuar gjatë vitit 2022 është 301,831 mijë Lekë (2021: 783,278 mijë Lekë). Në vitet e fundit, menaxhimi ka vendosur të rrisë ristrukturimin për kreditë e disa huamarrësve të cilët kishin vështirësi financiare me ndikime negative në flukset e parasë, ndërkohë që ristrukturimi pritet të rrisë mundësitë që huamarrësi të jetë në gjendje të paguajë detyrimin e tij dhe planpagesa e re të jetë në përputhje me kapacitetin pagues aktual dhe të prishëm të huamarrësit.

*Politikat e fshirjes*

Banka fshin një kredi/ balancën e letrave me vlerë (dhe çdo provigjion përkatës për humbjet nga zhvlerësimi) nëpërmjet një vendimi Bordi, kur Komiteti respektiv vendos se kreditë/ letrat me vlerë janë të pambledhshme. Ky vendim arrihet pas konsiderimit të të dhënave si ndodhja e ndryshimeve domethënëse në pozitën financiare të huamarrësit/ lëshuesit është e tillë që huamarrësi/ lëshuesi nuk mundet më të paguajë detyrimin, ose si të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme të mbulojnë tërë ekspozimin. Totali i shumës së fshirë gjatë 2022, është 174,969 mijë Lekë (2021: 358,669 mijë Lekë), e gjitha në kategorinë kredi.

Banka mban kolaterale si garanci për kredi dhe paradhënie për klientet në formën e bllokimeve hipotekore mbi pasuri të patundshme, rregjistrimin si pengje në zyrat përkatëse të pajisjeve / mjeteve, dhe garancive. Vlerësimi i vlerës së drejtë behet mbi vlerësimin e kolateralit në momentin e huamarrjes, dhe zakonisht nuk përditësohet, përveç rasteve kur kredia individualisht vlerësohet për zhvlerësim. Zakonisht nuk mbahet kolateral për kredi dhe paradhënie ndaj bankave, përveç rasteve kur letrat me vlerë mbahen si pjesë e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes.

Më poshtë jepet struktura e kolateralit për kredi në Klasa të ndryshme:

31 dhjetor 2022	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Totali
Pasuri të patundshme	63,247,446	3,561,659	4,584,774	71,393,879
Pengje	27,934,421	410,581	560,075	28,905,077
Mjete monetare	3,763,391	7,678	4,220	3,775,289
<b>Totali</b>	<b>94,945,258</b>	<b>3,979,918</b>	<b>5,149,069</b>	<b>104,074,245</b>

31 dhjetor 2021	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Totali
Pasuri të patundshme	63,673,800	5,209,985	4,501,560	73,385,345
Pengje	27,962,609	649,922	279,658	28,892,189
Mjete monetare	3,047,619	47,446	22,615	3,117,680
<b>Totali</b>	<b>94,684,028</b>	<b>5,907,353</b>	<b>4,803,833</b>	<b>105,395,214</b>

**38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****38.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)****38.1.4 Analiza e përqendrimeve të rreziqeve (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme tregon thyerjen e vlerës së kredive dhënë klientëve dhe institucioneve financiare sipas mbulimit të tyre me kolateral:

31 dhjetor 2022	Portofol i mbikolateralizuar		Portofol i nënkolateralizuar	
	Vlera e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit
Kredi me hipotekë	10,363,202	24,891,428	1,111,688	598,810
Kredi konsumatore	4,389,753	10,794,572	3,247,038	122,491
Overdrafte dhe karta	50,722	20,479	291,560	28,188
Kredi për biznese	21,309,525	66,574,176	2,713,717	1,157,913
<b>Totali</b>	<b>36,113,202</b>	<b>102,280,655</b>	<b>7,364,003</b>	<b>1,907,402</b>

31 dhjetor 2021	Portofol i mbikolateralizuar		Portofol i nënkolateralizuar	
	Vlera e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit
Kredi me hipotekë	9,372,186	30,406,497	708,375	365,245
Kredi konsumatore	3,426,811	8,579,116	2,716,137	107,648
Overdrafte dhe karta	82,224	111,528	235,194	1,004
Kredi për biznese	19,079,549	65,281,188	1,763,844	542,988
<b>Totali</b>	<b>31,960,770</b>	<b>104,378,329</b>	<b>5,423,550</b>	<b>1,016,885</b>

**38.2 Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka të ndeshet me veshtirësi për të siguruar fonde dhe për të plotësuar detyrimet që burojnë nga instrumentat financiare, dhe në përgjithësi për të ruajtur vazhdimësinë e linjave thelbësore të biznesit. Në bazë operative, Banka monitoron depozitat e klientëve të saj, dhe kështu korrigjon gjendjet dhe aksesin ndaj fondeve të aktiveve të saj korrentë, në mënyrë që të mbajë një kapacitet të kenaqshëm pagesash. Në një nivel me strategjik, Banka nëpërmjet Komitetit të Menaxhimit të Aktiveve dhe Pasiveve (“KMAP”) menaxhon këtë rrezik duke monitoruar vazhdimisht flukset e pritshme të parasë prej instrumenteve financiare dhe axhustuar investimet e veta për të sinkronizuar momentet e pagesave dhe arkëtimeve.

Kur një degë operative është subjekt i limiteve të vendosura të likuiditetit, dega është përgjegjëse për menaxhimin e likuiditetit të saj brenda limiteve rregullatore duke u koordinuar me departamentin e thesarit të Bankës, i cili menaxhon procesin e transferimit të parave brenda degëve të Bankës. Departamenti i Thesarit monitoron në bazë ditore përputhshmërinë e çdo dege operative me limitet e vendosura. Gjithashtu, Departamenti i Thesarit sigurohet që kasaforta e thesarit të ketë rezervat e nevojshme për të mbështetur degët e Bankës kur/nëse nevojitet.

Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve vjetore respektivisht nga KMAP dhe Bordi. Raportime ditore bëhen për të matur likuiditetin e degëve operative dhe Bankës në tërësi.

Banka mbështetet tek depozitat e klientëve, Repo-ve, huave afatshkurtra ndërbankare si burim kryesor fondesh. Natyra afatshkurtër e një pjese të madhe të këtyre fondeve rrit rrezikun e likuiditetit të Bankës dhe Banka e menaxhon këtë rrezik nëpërmjet mbajtjes nivelit të nevojshëm të likuiditetit, shoqëruar me çmime konkurruese dhe monitorimit të vazhdueshëm të pririjeve të tregut.

Një nga elementet kryesorë të monitorimit që Banka përdor për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit është koeficienti i aktiveve likuide mbi detyrimet afatshkurtra, llogaritur në baza ditore në Lek, valutë dhe në total. Ky koeficient përlllogaritet bazuar në rregulloret e Bankës qendrore dhe Banka ka qenë gjithmonë mbi limitet e vendosura nga Banka Qendrore gjatë viteve 2022 dhe 2021 si dhe në fundet e tyre.

## **38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

### **38.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Për të menaxhuar rrezikun e likuiditetit që vjen nga detyrimet financiare, Banka mban aktive likuide duke përfshirë dhe paranë dhe ekuivalentet e saj, për të cilat ka një treg aktiv likuid. Këto aktive mund të shiten në rast nevoje për të arritur kërkesat për likuiditet. Banka gjithashtu monitoron vazhdimisht, merr vendimet për investime bazuar në dhe në përputhje me nivelet rregullatore të vendosura për raportin e mbulimit me likuiditet (LCR). LCR përllogaritet si raporti i aktiveve me cilësi të larta likuide me flukset dalëse neto të pritshme në 30 ditët e mëpasshme kalendarike.

Funksioni i monitorimit dhe kontrollit të investimeve të Bankës kryhet nëpërmjet KMAP. Politikat e KMAP përfshijnë sete raportësh ditore, javore dhe mujore që përgatiten dhe analizohen. Raportet mujore përfshijnë koeficientë, nivelin e LCR, NSFR and analiza të Hendekut të të drejtave dhe detyrimeve me specifika të veçanta të Bankës dhe të atij të simuluar sipas skenarëve krizë të tregut. Raportet prodhohen për çdo monedhë më vetë (LEK, USD dhe EUR) si dhe për të gjitha valutat së bashku. Limite të veçanta janë vendosur për rezultatet e Hendekut të maturimeve (sipas likuiditetit dhe të simuluar) dhe ndiqen në frekuencë mujore.

Si pjesë e një kuadri të plotë të administrimit të rrezikut të likuiditetit, Banka ka vendosur Planin e Financimit të Vazhdueshëm, i cili përcakton ngjarjet nxitëse dhe plane të detajuara veprimi, të cilat përfshijnë masat që duhen marrë dhe përgjegjësitë, për të menaxhuar çdo krizë likuiditeti që Banka mund të hasë. Gjithashtu, ai ka përfshirë rrezikun e likuiditetit midis treguesve kryesorë të Planit të Zgjidhjes, bazuar në kërkesat specifike të rregullimit të BSH-së. Të dy planet e tilla janë pjesë e rishikimit vjetor nga KMAP dhe i nënshtrohen miratimit të Bordit.

Në lidhje me ndikimet në COVID – 19 dhe ngjarjeve të konfliktit në Ukrainë, Banka, përveç rritjes së maturisë kur bëhet fjalë për cilësinë e investimit, mori të gjitha masat përkatëse për të rritur nivelet e likuiditetit të parave në degë, për të mbështetur menjëherë dhe adresuar çdo kërkesë në rritje dhe për të minimizuar çdo rrezik në lidhje kufizimet e lidhura me të dhe ndikimin e tij në levizjet fizike të parave ose konsum me te larte si pasoje e rritjes së inflacionit. Lëvizjet e tilla u shoqëruan me rritjen e monitorimit të aktiviteteve të parave dhe transferimin e rrezikut gjithnjë e më shumë operacional në lidhje me aktivitete të tilla, përmes ndryshimit të politikave të sigurimit dhe duke respektuar kufijtë e brendshëm të parave të gatshme brenda kufijve të siguruar. Gjatë gjithë periudhës së krizave dhe më pas, raportet e likuiditetit janë mbajtur brenda kufijve të brendshëm dhe rregullatore.

**Union Bank sh.a****Shënime për pasqyrat financiare të vecanta me dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022***(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)***38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****38.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Më poshtë jepet një analizë të flukseve të paskontuara (dmth përfshihen interesat sipas kontratave deri në maturim të instrumentëve) sipas maturimit të mbetur kontraktual të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës:

<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>Deri në 1</b>	<b>1 deri në 3</b>	<b>3 deri në 6</b>	<b>6 deri në 12</b>	<b>1 deri në 5</b>	<b>Mbi 5</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivët</b>	<b>muaj</b>	<b>muaj</b>	<b>muaj</b>	<b>muaj</b>	<b>vite</b>	<b>vite</b>	
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	8,417,677	-	-	-	-	-	<b>8,417,677</b>
Depozita dhe llogari me bankat	3,436,020	802,250	576,845	159,922	147,781	56,134	<b>5,178,952</b>
Letra me vlerë investimi	650,707	2,441,615	1,389,583	4,669,574	16,972,614	9,017,548	<b>35,141,641</b>
Hua dhe paradhënie për klientët	2,552,558	1,950,909	3,282,290	6,733,938	23,799,523	15,872,928	<b>54,192,146</b>
Tatim fitim i parapaguar	38,071	-	-	-	-	-	<b>38,071</b>
Aktive të tjera	204,013	1,828	2,742	5,483	43,864	21,018	<b>278,948</b>
<b>Totali i aktiveve financiare të paskontuara</b>	<b>15,299,046</b>	<b>5,196,602</b>	<b>5,251,460</b>	<b>11,568,917</b>	<b>40,963,782</b>	<b>24,967,628</b>	<b>103,247,435</b>
<b>Detyrimet</b>							
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	3,680,680	3,211,135	-	-	-	-	<b>6,891,815</b>
Detyrime bankave e institucioneve financiare	4,697,874	84,221	554,188	863,340	700,185	-	<b>6,899,808</b>
Detyrime ndaj klientëve	34,372,874	2,363,949	4,672,220	10,142,761	18,152,716	-	<b>69,704,520</b>
Detyrime për qira	16,152	32,305	48,457	96,242	369,004	134,109	<b>696,269</b>
Detyrime të tjera	436,726	1,417	1,416	2,830	15,703	2,056	<b>460,148</b>
Borxhi i varur	-	9,710	3,770	13,497	325,156	602,677	<b>954,810</b>
<b>Totali i detyrimeve financiare të paskontuara</b>	<b>43,204,306</b>	<b>5,702,737</b>	<b>5,280,051</b>	<b>11,118,670</b>	<b>19,562,764</b>	<b>738,842</b>	<b>85,607,370</b>
<b>Aktive dhe detyrime financiare të paskontuara, neto</b>	<b>(27,905,260)</b>	<b>(506,135)</b>	<b>(28,591)</b>	<b>450,247</b>	<b>21,401,018</b>	<b>24,228,786</b>	<b>17,640,065</b>

Është në natyrën e aktiviteteve të Bankës, veçanërisht kur financohen nga fondet e klientëve, të marrë hua afatshkurtër dhe afatmesme dhe të investojë në terma më të gjatë. Duke qenë se shumica e depozitave qarkullojnë tradicionalisht, hendeku i mbetur i likuiditetit është vetëm një tregues, por nuk pasqyron rrezikun e likuiditetit të Bankës. Siç u shpjegua në detaje më sipër, Banka ka të gjitha mjetet për të monitoruar dhe menaxhuar likuiditetin sipas monedhës, bazuar në maturimin kontraktual dhe të prishëm, dhe është vazhdimisht brenda kufijve rregullatore dhe të brendshme të likuiditetit.

## 38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

## 38.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2021	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
<b>Aktivët</b>							
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	5,339,675	-	-	-	-	-	5,339,675
Depozita dhe llogari me bankat	4,073,038	447,632	144,912	276,326	2,753	34,265	4,978,926
Letra me vlerë investimi	630,711	1,010,108	1,786,914	2,614,260	16,460,987	9,131,864	31,634,844
Hua dhe paradhënie për klientët	1,754,479	1,664,542	3,060,153	5,371,634	20,435,019	21,330,044	53,615,871
Aktive të tjera	318,151	1,932	2,898	5,796	46,372	33,813	408,962
<b>Totali i aktiveve financiare të paskontuara</b>	<b>12,116,054</b>	<b>3,124,214</b>	<b>4,994,877</b>	<b>8,268,016</b>	<b>36,945,131</b>	<b>30,529,986</b>	<b>95,978,278</b>
<b>Detyrimet</b>							
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	1,595,835	1,099,024	-	-	-	-	2,694,859
Detyrime bankave e institucioneve financiare	3,930,954	367,466	574,600	886,731	506,123	-	6,265,874
Detyrime ndaj klientëve	31,583,045	3,149,696	3,820,884	11,667,381	13,570,825	-	63,791,831
Detyrime për qira	15,535	31,070	46,349	90,652	435,934	142,945	762,485
Detyrime të tjera	419,229	1,500	1,500	2,998	19,693	5,067	449,987
Borxhi i varur	-	3,925	3,985	7,910	300,874	257,460	574,154
Detyrime tatimore	68,575	-	-	-	-	-	68,575
<b>Totali i detyrimeve financiare të paskontuara</b>	<b>37,613,173</b>	<b>4,652,681</b>	<b>4,447,318</b>	<b>12,655,672</b>	<b>14,833,449</b>	<b>405,472</b>	<b>74,607,765</b>
<b>Aktive dhe detyrime financiare të paskontuara, neto</b>	<b>(25,497,119)</b>	<b>(1,528,467)</b>	<b>547,559</b>	<b>(4,387,656)</b>	<b>22,111,682</b>	<b>30,124,514</b>	<b>21,370,513</b>

(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

**38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****38.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Tabela më poshtë tregon maturimin kontraktual të angazhimeve të Bankës. Çdo angazhim për kredi është përfshirë në datën më të afert në të cilën ai mund të tërhiqet. Për garancitë financiare të lëshuara, vlera maksimale e garancisë është alokuar në periudhën me të parë në të cilën ajo mund të ekzekutohet.

<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1 deri në 3 muaj</b>	<b>3 deri në 6 muaj</b>	<b>6 deri në 12 muaj</b>	<b>1 deri në 5 vite</b>	<b>Mbi 5 vite</b>	<b>Totali</b>
Garancitë financiare	21,417	12,212	171,918	468,423	477,377	-	1,151,347
Letër kredi	36,605	-	2,605	-	-	-	39,210
Angazhime të tjera për kredi	66,801	91,170	226,905	1,230,425	211,335	-	1,826,636
<b>Totali i garancive dhe angazhimeve</b>	<b>124,823</b>	<b>103,382</b>	<b>401,428</b>	<b>1,698,848</b>	<b>688,712</b>	<b>-</b>	<b>3,017,193</b>

<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1 deri në 3 muaj</b>	<b>3 deri në 6 muaj</b>	<b>6 deri në 12 muaj</b>	<b>1 deri në 5 vite</b>	<b>Mbi 5 vite</b>	<b>Totali</b>
Garancitë financiare	262	257,253	188,300	345,992	329,553	24	1,121,384
Letër kredi	27,076	268,664	-	-	2,753	-	298,493
Angazhime të tjera për kredi	28,907	151,447	94,007	1,317,825	306,463	-	1,898,649
<b>Totali i garancive dhe angazhimeve</b>	<b>56,245</b>	<b>677,364</b>	<b>282,307</b>	<b>1,663,817</b>	<b>638,769</b>	<b>24</b>	<b>3,318,526</b>

### 38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

#### 38.3 Rreziku i tregut

Banka ekspozohet ndaj rreziqeve të tregut sa herë që vlera e tregut ose flukset e ardhme të parasë të një instrumenti financiar luhet si pasojë e ndryshimeve në çmimet e tregut. Rreziqet e tregut burojnë nga pozicione të hapura të bilancit në norma interesi dhe monedha, të cilat të gjitha ekspozohen ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe të veçanta të tregut, dhe ndryshimeve në nivelin e volatilitetit të normave të tregut ose çmimeve si norma e interesit, marzhet e kredisë, dhe kurset e këmbimit të valutave.

#### Rreziku i monedhës së huaj

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhave nepërmjet transaksioneve në valuta të huaja. Rreziku i monedhës së huaj është rreziku sipas të cilit vlera e instrumentit financiar të luhet si pasojë e ndryshimeve në kursin e këmbimit në treg. Banka përpiqet ta administrojë rrezikun duke mbyllur pozicionet e hapura valutore ditore dhe duke vendosur dhe monitoruar limite mbi pozicionet e hapura. Monedha e paraqitjes së pasqyrave financiare të Bankës është LEK, në këtë mënyrë ato janë të ndikuara nga lëvizjet në kurset e këmbimit valutor midis monedhës LEK dhe monedhave të tjera të huaja. Ekspozimet e transaksioneve të Bankës çojnë në humbje ose fitime nga valutat e huaja që njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit të rrezikut të monedhës kryhen nga Drejtori i Divizionit të Financës dhe Departamenti i Rrezikut mbi baza ditore dhe si pjesë e përgjegjësisë të KMAP. Politika e KMAP përfshin një set të raportëve ditore të cilat përgatitën dhe analizohen. Banka ka vendosur limite të brendshme për pozicionin e hapur valutor të cilat janë shumë me konservatore së limitet rregullatore. Këto limite monitorohen dhe respektohen me frekuencë ditore.

Këto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës që nuk janë të emëruara në valutën funksionale të Bankës. Kurset e këmbimit për monedhat kryesore janë si më poshtë:

	2022	2021
EUR:LEK	114.23	120.76
USD:LEK	107.05	106.56

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 sipas valutave të huaja në të cilat ato janë emëruar jepet si më poshtë:

31 dhjetor 2022	LEK	USD	EUR	Të tjera	Totali
<b>Aktivet</b>					
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	2,852,342	801,746	9,374,630	303,934	13,332,652
Depozita dhe llogari me bankat	257,589	651,283	3,700,984	534,287	5,144,143
Letra me vlerë investimi	23,566,077	715,770	4,143,434	720,424	29,145,705
Hua dhe paradhënie për klientët	14,606,370	109,688	26,960,930	2,432	41,679,420
Tatim fitim i parapaguar	38,071	-	-	-	38,071
Aktive të tjera	118,751	4,389	135,484	3,986	262,610
<b>Totali</b>	<b>41,439,200</b>	<b>2,282,876</b>	<b>44,315,462</b>	<b>1,565,063</b>	<b>89,602,601</b>
<b>Detyrimet</b>					
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	6,868,994	-	-	-	6,868,994
Detyrime bankave e institucioneve financiare	3,107,623	89,961	3,571,891	86,495	6,855,970
Detyrime ndaj klientëve	29,271,757	2,054,966	36,012,912	1,422,472	68,762,107
Detyrime për qira	30,443	9,899	545,483	-	585,825
Detyrime të tjera	191,476	70,339	154,745	43,490	460,050
Borxhi i varur	-	-	808,173	-	808,173
<b>Totali</b>	<b>39,470,293</b>	<b>2,225,165</b>	<b>41,093,204</b>	<b>1,552,457</b>	<b>84,341,119</b>
Angazhime e këmbime spot, neto	401,090	(230,328)	(141,231)	(15,724)	13,807
<b>Pozicioni neto</b>	<b>2,369,997</b>	<b>(172,617)</b>	<b>3,081,027</b>	<b>(3,118)</b>	<b>5,275,289</b>

## 38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

## 38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)

## Rreziku i monedhës së huaj (vazhdim)

31 dhjetor 2021	LEK	USD	EUR	Të tjerë	Totali
<b>Aktivët</b>					
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	1,774,113	1,007,762	6,379,690	321,070	9,482,635
Depozita dhe llogari me bankat	-	594,318	3,900,103	482,175	4,976,596
Letra me vlerë investimi	23,233,219	678,002	3,385,823	398,887	27,695,931
Hua dhe paradhënie për klientet	11,853,125	165,077	23,677,260	-	35,695,462
Aktive të tjera	29,311	893	114,752	241,904	386,860
<b>Total</b>	<b>36,889,768</b>	<b>2,446,052</b>	<b>37,457,628</b>	<b>1,444,036</b>	<b>78,237,484</b>
<b>Detyrimet</b>					
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	2,693,411	-	-	-	2,693,411
Detyrime bankave e institucioneve financiare	2,950,770	103,121	3,050,394	17,482	6,121,767
Detyrime ndaj klientëve	28,643,090	2,218,933	30,979,644	1,374,046	63,215,713
Detyrime për qira	30,643	12,058	586,663	-	629,364
Detyrime të tjera	123,885	24,885	295,790	5,267	449,827
Borxhi i varur	-	-	487,866	-	487,866
Detyrime tatimore	68,575	-	-	-	68,575
<b>Totali</b>	<b>34,510,374</b>	<b>2,358,997</b>	<b>35,400,357</b>	<b>1,396,795</b>	<b>73,666,523</b>
Angazhime e kembime spot, neto	202,770	(74,940)	(83,503)	(44,166)	161
<b>Pozicioni neto</b>	<b>2,582,164</b>	<b>12,115</b>	<b>1,973,768</b>	<b>3,075</b>	<b>4,571,122</b>

Në çdo rast, pozicionet e brendshme të hapura në valutë të Bankës janë të kujdesshme dhe mjaft poshtë kufijve rregullatore.

**Rreziku i normës së interesit**

Rreziku i normës së interesit është përcaktuar si ndjeshmëria e fitimit dhe kapitalit të Bankës ndaj ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Rreziku i normës së interesit në librat e Bankës i referohet rrezikut aktual dhe të pritshëm në kapitalin dhe fitimet e Bankës si pasojë e ndryshimit të pafavorshëm në normat e interesit. Në rast të ndryshimit të interesit, ndryshojnë vlera aktuale dhe koha e flukseve të pritshme.

Banka përpiqet ta zbusë këtë rrezik duke mbushur plotësisht hendekun midis aktiveve dhe detyrimeve, në mënyrë që edhe aktivet edhe detyrimet, të maturohen dhe të ripërcaktohet çmimi njëkohësisht. Kjo ndihmon që Banka të mos jetë tepër e ndjeshme ndaj ndryshimeve të normave të interesit. Funkzioni i monitorimit dhe kontrollit për rreziqet e normës së interesit të Bankës është i KMAP. Politika e KMAP e Bankës përmban sete limitesh, metodash matjeje dhe raporte mujore që përgatiten dhe analizohen.

Hendeku i normave të interesit më 31 dhjetor 2022 është analizuar më poshtë. Më 31 dhjetor 2022 shumica e aktiveve afat-shkurtra financiare të Bankës dhe detyrimeve, përveç portofolit të kredisë, mbartin norma fikse interesi.



(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

**38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)****Rreziku i normës së interesit (vazhdim)***i. Informacion për normat e interesit*

Normat mesatare të ponderuara të interesit të kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës janë paraqitur më poshtë:

	Normat mesatare të ponderuara							
	LEK		USD		EUR		Të tjera	
	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021
<b>Aktivitet:</b>								
Rezerva e detyrueshme	2.75%	0.50%	N/A	N/A	N/A	-0.50%	N/A	N/A
Depozita dhe llogaritë me bankat	3.00%	N/A	3.76%	N/A	1.47%	N/A	N/A	N/A
Letrat me vlerë të investimeve	4.82%	4.51%	3.11%	2.97%	3.21%	3.40%	2.68%	2.03%
Hua dhe paradhënie për klientët	7.62%	7.62%	5.28%	5.28%	4.56%	4.56%	N/A	N/A
<b>Detyrimet:</b>								
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	2.67%	1.19%	1.60%	0.90%	1.03%	0.82%	2.25%	N/A
Detyrime ndaj klientëve	2.05%	2.10%	1.07%	0.78%	0.94%	0.53%	0.86%	0.33%
Repo	2.98%	0.54%	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Kredi nga qeveria	N/A	N/A	N/A	N/A	0.20%	0.20%	N/A	N/A
Detyrime për qira	7.92%	8.00%	7.25%	7.25%	7.11%	7.25%	N/A	N/A
Borxhi i varur	N/A	N/A	N/A	N/A	3.37%	3.28%	N/A	N/A

*ii. Analiza e ndryshimit të normës së interesit*

Tabela e mëposhtme paraqet datat e ndryshimit të normës së interesit të aktiveve dhe detyrimeve të Bankës. Aktivitet dhe detyrimet me norma interesi të ndryshueshme janë raportuar deri në datën tjetër të ndryshimit të normës së interesit.

Aktivitet dhe detyrimet me norma fikse janë raportuar sipas datave të caktuara të pagesës së principalit.

**Union Bank sh.a**

**Shënime për pasqyrat financiare të vecanta me dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022**

*(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)**

*Rreziku i normës së interesit (vazhdim)*

	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1-3 Muaj</b>	<b>3-6 Muaj</b>	<b>6-12 Muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Që nuk mbartin interes</b>	<b>Totali</b>
<b>31 dhjetor 2022</b>							
<b>Aktivët</b>							
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	1,213,981	-	-	-	-	12,118,671	<b>13,332,652</b>
Depozita dhe llogari me bankat	1,502,366	799,610	571,150	-	-	2,271,017	<b>5,144,143</b>
Investime në letra me vlerë	549,906	2,331,257	1,980,862	3,047,221	20,977,543	258,916	<b>29,145,705</b>
Hua dhe paradhënie për klientet	4,078,814	4,722,054	7,983,961	18,521,926	8,387,048	(2,014,383)	<b>41,679,420</b>
Tatim fitim i parapaguar	-	-	-	-	-	38,071	<b>38,071</b>
Aktive të tjera	554	1,119	1,703	3,501	52,633	203,100	<b>262,610</b>
<b>Totali</b>	<b>7,345,621</b>	<b>7,854,040</b>	<b>10,537,676</b>	<b>21,572,648</b>	<b>29,417,224</b>	<b>12,875,392</b>	<b>89,602,601</b>
<b>Detyrimet</b>							
Detyrime ndaj Bankës qendrore	3,672,784	3,187,228	-	-	-	8,982	<b>6,868,994</b>
Detyrime bankave e institucioneve financiare	1,685,072	83,892	551,164	852,288	671,205	3,012,349	<b>6,855,970</b>
Detyrime ndaj klientëve	8,408,357	2,908,157	5,652,467	11,947,039	32,492,199	7,353,888	<b>68,762,107</b>
Detyrime për qira	12,801	25,833	39,337	80,154	427,700	-	<b>585,825</b>
Detyrime të tjera	-	1,405	1,405	2,810	17,685	436,745	<b>460,050</b>
Borxhi i varur	-	-	-	-	799,610	8,563	<b>808,173</b>
<b>Totali</b>	<b>13,779,014</b>	<b>6,206,515</b>	<b>6,244,373</b>	<b>12,882,291</b>	<b>34,408,399</b>	<b>10,820,527</b>	<b>84,341,119</b>
<b>Hendeku</b>	<b>(6,433,393)</b>	<b>1,647,525</b>	<b>4,293,303</b>	<b>8,690,357</b>	<b>(4,991,175)</b>	<b>2,054,865</b>	<b>5,261,482</b>
<b>Hendeku i akumuluar</b>	<b>(6,433,393)</b>	<b>(4,785,868)</b>	<b>(492,565)</b>	<b>8,197,792</b>	<b>3,206,617</b>	<b>5,261,482</b>	<b>-</b>

**Union Bank sh.a**

**Shënime për pasqyrat financiare të vecanta me dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022**

*(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)**

*Rreziku i normës së interesit (vazhdim)*

<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1-3 Muaj</b>	<b>3-6 Muaj</b>	<b>6-12 Muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Që nuk mbartin interes</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivet</b>							
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	6,895,715	-	-	-	-	2,586,920	<b>9,482,635</b>
Depozita dhe llogari me bankat	3,062,895	-	-	-	-	1,913,701	<b>4,976,596</b>
Investime në letra me vlerë	603,294	843,771	1,733,515	2,914,930	21,299,928	300,493	<b>27,695,931</b>
Hua dhe paradhënie për klientët	2,666,783	3,608,211	6,887,101	17,221,446	7,185,866	(1,873,945)	<b>35,695,462</b>
Aktive të tjera	545	1,100	1,675	3,443	62,912	317,185	<b>386,860</b>
<b>Totali</b>	<b>13,229,232</b>	<b>4,453,082</b>	<b>8,622,291</b>	<b>20,139,819</b>	<b>28,548,706</b>	<b>3,244,354</b>	<b>78,237,484</b>
<b>Detyrimet</b>							
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	1,562,219	1,097,510	-	-	-	33,682	<b>2,693,411</b>
Detyrime bankave e institucioneve financiare	1,192,021	306,712	514,627	877,980	490,487	2,739,940	<b>6,121,767</b>
Detyrime ndaj klientëve	7,998,904	3,651,550	4,685,706	13,291,221	26,813,174	6,775,158	<b>63,215,713</b>
Detyrime për qira	11,720	23,654	35,766	71,441	486,783	-	<b>629,364</b>
Detyrime të tjera	-	1,485	1,485	2,970	24,637	419,250	<b>449,827</b>
Borxhi i varur	-	-	-	-	483,040	4,826	<b>487,866</b>
Detyrime tatimore	-	-	-	-	-	68,575	<b>68,575</b>
<b>Totali</b>	<b>10,764,864</b>	<b>5,080,911</b>	<b>5,237,584</b>	<b>14,243,612</b>	<b>28,298,121</b>	<b>10,041,431</b>	<b>73,666,523</b>
<b>Hendeku</b>	<b>2,464,368</b>	<b>(627,829)</b>	<b>3,384,707</b>	<b>5,896,207</b>	<b>250,585</b>	<b>(6,797,077)</b>	<b>4,570,961</b>
<b>Hendeku i akumuluar</b>	<b>2,464,368</b>	<b>1,836,539</b>	<b>5,221,246</b>	<b>11,117,453</b>	<b>11,368,038</b>	<b>4,570,961</b>	<b>-</b>

**38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)***Analiza e ndjeshmërisë*

Analiza e ndjeshmërisë më poshtë është kryer bazuar në ekspozimet ndaj interesit në datën e raportimit dhe ndryshimi i përcaktuar që do të ndodhte në fillim të vitit financiar është mbajtur konstant përgjatë periudhës raportuese. Më poshtë jepet një përcaktim i efekteve që ndryshimet në normat e interesit kanë në fitimin neto dhe kapital, duke supozuar së gjithë variablat e tjera janë mbajtur të pandryshuara:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Norma e interesit rritet me 2%	64,132	227,361
Norma e interesit rritet me 1.5%	48,099	170,521
Norma e interesit rritet me 1%	32,066	113,680
Norma e interesit ulet me 1%	(32,066)	(113,680)
Norma e interesit ulet me 1.5%	(48,099)	(170,521)
Norma e interesit ulet me 2%	(64,132)	(227,361)

Analiza e ndjeshmërisë të ndryshimit të kurseve të këmbimit është pjesë e raportimit të rrezikut të kurseve të këmbimit tek drejtuesit dhe paraqet vlerësimin e Drejtimit për ndryshimet e mundshme në kurset e këmbimit bazuar mbi informacionin e vlefshëm pas përgatitjes së bilancit. Analiza e ndjeshmërisë përfshin zërat kryesore monetare në monedhë të huaj dhe axhuston vlerat e konvertuara në fund të periudhës për ndryshimet në kurset e këmbimit të përshkruara më sipër.

Më poshtë jepet një përcaktim i efekteve që ndryshimi i kurseve të këmbimit ka në fitimin neto, duke supozuar së të gjitha variablat e tjera janë mbajtur të pandryshuara:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Lek zhvlerësohet kundrejt USD me 5%	(8,631)	606
Lek forcohet kundrejt USD me 5%	8,631	(606)
Lek zhvlerësohet kundrejt EUR me 5%	154,051	98,688
Lek forcohet kundrejt EUR me 5%	(154,051)	(98,688)
Lek zhvlerësohet kundrejt monedhave të tjera me 5%	(156)	154
Lek forcohet kundrejt monedhave të tjera me 5%	156	(154)

**38.4 Rreziku operacional**

Rreziku Operacional ndeshet përgjatë lëvrimit të të gjitha produkteve dhe shërbimeve bankare dhe shfaqet në baza ditore ndërsa transaksionet procesohen. Ai mund të ndodhë edhe si rezultat i sistemeve të pamjaftueshme të informacionit të papërshtatshëm, dështimeve të teknologjisë, dëmtimit të kontrolleve të brendshme, dhe mashtrimeve apo katastrofave të paparashikueshme.

Në mënyrë që të mbrohet nga rreziku operacional Banka ka hartuar një kuadër i cili përfshin përkufizime të qarta të rrezikut operacional përgjatë organizatës, dhe një filozofi të vetë-vlerësimit të proceseve të biznesit. Gjithashtu ka zhvilluar një set treguesish kyç të rrezikut dhe është duke monitoruar në mënyrë aktive performancën e tyre. Eventet e rrezikut operacional analizohen dhe monitorohen me kujdes, në kuadër të ekspozimit kundrejt rreziqeve të paparashikuara apo humbje potenciale të kontrolleve.

Komiteti i Rrezikut Operacional (“KRO”) i Bankës ndjek në mënyrë periodike ngjarjet që shkaktojnë humbje operacionale dhe ka përcaktuar përgjegjësitë përkatëse për shmangien e humbjeve dhe dhënien e zgjidhjeve rezervë për mbrojtjen nga rreziku për ato aktivitete që janë subjekt i rrezikut operacional.

Përveç kësaj, Banka ka krijuar Komitetin e Përputhshmërisë, i cili mbulon kërkesat e pajtueshmërisë dhe çështjet e lidhura me to në baza periodike.

Provigjonet për riskun operacional janë përfshirë nën Provigjone për risk dhe shpenzime nën Detyrime të tjera.

**39. PARAQITJA DHE VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË**

Vlerësimet e vlerës së drejtë janë bazuar mbi instrumentat financiare ekzistuese në bilanc pa tentuar të vlerësohet vlera e paraprirë e biznesit të ardhshëm dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen si instrument financiar.

**Instrumentat financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtë – hierarkia e vlerës së drejtë**

Tabela e mëposhtme tregon vlerën e drejtë të instrumentave financiare të cilët nuk mbahen me vlerë të drejtë dhe analizon ato nga hierarkia e vlerës së drejtë në të cilën është klasifikuar çdo vlerë e drejtë.

	<b>Më 31 dhjetor 2022</b>			
	<b>Vlera e mbartur</b>	<b>Vlera e drejtë Niveli 1</b>	<b>Vlera e drejtë Niveli 2</b>	<b>Vlera e drejtë Niveli 3</b>
<b>Aktive financiare</b>				
Depozita dhe llogari me bankat	5,144,143	-	-	5,144,143
Investime në letra me vlerë me vlerë të drejtë përmes Fitim humbjes	72,867	72,867	-	-
Investime në letra me vlerë me vlerë të drejtë në ATGJ	679,413	679,413	-	-
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	28,393,425	4,538,823	22,828,050	-
Hua dhe paradhëniet për klientët	41,679,420	-	-	43,910,203
<b>Detyrime financiare</b>				
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	6,868,994	-	6,868,994	-
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	6,855,970	-	-	6,868,455
Detyrime ndaj klientëve	68,762,107	-	-	68,770,228
Detyrime ndaj qeverisë	23,324	-	-	21,074
Borxh i varur	808,173	-	-	808,173
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>				
	<b>Vlera e mbartur</b>	<b>Vlera e drejtë Niveli 1</b>	<b>Vlera e drejtë Niveli 2</b>	<b>Vlera e drejtë Niveli 3</b>
<b>Aktive financiare</b>				
Depozita dhe llogari me bankat	4,976,596	-	-	4,976,596
Investime në letra me vlerë me vlerë të drejtë në ATGJ	851,106	851,106	-	-
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	26,844,825	3,531,251	24,338,794	-
Hua dhe paradhëniet për klientët	35,695,462	-	-	37,998,449
<b>Detyrime financiare</b>				
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	2,693,411	-	2,693,411	-
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	6,121,767	-	-	6,136,653
Detyrime ndaj klientëve	63,215,713	-	-	63,443,609
Detyrime ndaj qeverisë	30,598	-	-	27,605
Borxh i varur	487,866	-	-	487,866

**Depozita dhe llogari me bankat**

Depozitat dhe llogaritë me bankat përfshijnë depozita ndër-bankare dhe zëra për t'u arkëtuar. Për arsye se pjesa me e madhe e huave, paradhëniet dhe depozitave një-ditore janë afat-shkurtër dhe me norma interesi të ndryshueshme, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e njëjtë me vlerën kontabël të tyre.

**39. PARAQITJA DHE VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË (VAZHDIM)***Hua dhe paradhëniet për klientet dhe institucionet financiare*

Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve dhënë klientëve dhe institucioneve financiare vlerësohet duke përdorur teknika të skontimit të flukseve të arkëtimit, duke aplikuar norma që ofrohen për kredi për maturitete të ngjashme sipas produkteve apo klientëve. Vlera e drejtë e overdrafteve përafrojnë me vlerën e tyre kontabël.

*Investime në letra me vlerë*

Bono thesari përfshijnë bonot e thesarit të emetuara nga qeveria të cilat janë blerë me qëllimin për t'u mbajtur deri në maturim. Përderisa nuk ekziston një treg aktiv për bonot e thesarit, vlera reale është llogaritur duke përdorur një model të skontimit të fluksit të parave bazuar në kurbën aktuale të yield-it dhe e përshtatshme për maturitetin e mbetur.

Obligacione thesari përfshijnë obligacione të emetuara nga qeveria shqiptare në LEK, bonde të emetuara nga qeveria Shqiptare dhe ato të huaja në EUR dhe bonde korporative në EUR të cilat janë blerë me qëllimin për t'u mbajtur deri në maturim. Për letrat me vlerë të emetuara në LEK, nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv. Megjithatë, kishte informacion të mjaftueshëm për të matur vlerën e drejtë të këtyre letrave me vlerë duke u bazuar në inputet e vrojtueshme të tregut. Për këtë, kur gjendej një çmim i kuotuar në treg aktiv, letrat me vlerë u përfshinë në Nivelin 1 të hierarkisë, ndërsa letrat me vlerë për të cilat u përdorën inputet e vrojtueshme të tregut për të përcaktuar vlerën e tyre të drejtë, u klasifikuan Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë.

*Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare dhe klientëve*

Vlera e drejtë e depozitave nga bankat dhe klientët vlerësohet duke përdorur teknikën e skontimit të fluksit të parasë duke përdorur normat e ofruara për depozita me maturime dhe kushte të njëjta. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme me kërkesë është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

**40. MENAXHIMI I KAPITALIT***Kapitali Rregullator*

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur, përveç masave të tjera, rregulla dhe përqindje të vendosura nga rregullatori Shqiptar, Banka e Shqipërisë, e cila në mënyrë përfundimtare përcakton kapitalin statutor që duhet për të përforcuar biznesin. Rregullorja “Mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit” është lëshuar duke u mbështetur në ligjin nr. 8269 datë 23.12.1997 “Ligji për Bankën e Shqipërisë”, dhe atij nr. 8365 datë 02.07.1998 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

*Raporti i Mjaftueshmerise së Kapitalit*

Duke nisur më 1 prill 2015, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) është ajo pjesë e kapitalit rregullator ndaj ekspozimeve të përgjithshme të ponderuara me rrezikun, e shprehur në përqindje. Ky raport duhet jetë jo më i vogël së 12%.

*Ekspozimet e përgjithshme të ponderuara me rrezikun.*

Ekspozimet e përgjithshme të ponderuara me rrezikun llogariten si shuma e të mëposhtme:

- Ekspozimet e ponderuara me rrezik për mbulimin e rrezikut të kredisë dhe kundërparsise, në të cilin ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit janë ponderuar bazuar në metodën standarde të rregullores së Bankës së Shqipërisë mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit. Sipas kësaj metode, të gjitha ekspozimet dhe ekspozimet e mundshme grupohen në disa kategori të caktuara ekspozimi dhe brenda tyre grupohen në grupe me të vogla sipas rrezikut të lidhur me to.
- Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun e tregut
- Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun operacional, duke zbatuar metodën e treguesit të thjeshtë

Tabela e mëposhtme tregon koeficientët e mjaftueshmërisë së kapitalit në fundvitet:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Ekspozimet e përgjithshme të ponderuar me riskun	45,864,848	41,895,033
Kapitali rregullator	7,261,746	6,402,964
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	15.83%	15.28%

#### **40. MENAXHIMI I KAPITALIT (VAZHDIM)**

Politika e Bankës është që të mbajë një bazë optimale kapitali në mënyrë që të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit dhe të ruajë konfidencën e tregut. Ndikimi i nivelit të kapitalit në fitimin e ardhshëm aksionar njihet dhe pranohet dhe Banka njeh dhe pranon nevojën për të mbajtur një ekuilibër ndërmjet fitimit të lartë që mund të jetë i mundur me më shumë manovrim brenda limiteve rregullatore dhe prudenciale, si dhe avantazheve dhe sigurisë që përballohet me një pozicion të shëndoshë kapitali.

Banka vlerëson dhe monitoron kërkesat e kapitalit referuar Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (ICAAP), duke qenë në përputhje me udhëzimin përkatës të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë përmes vendimit nr. 41, datë 5.6.2019. Sipas kërkesave të tilla, raporti i brendshëm i synuar për shkallën e mjaftueshmërisë së kapitalit është vendosur nga Bordi në 13.5%.

Për më tepër, Banka zbaton dhe është në përputhje me rregulloren për masat makroprudenciale, të miratuar me vendimin nr. 41 datë 5.6.2019 nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Bankat zbatojnë vendimin e komunikuar nga Guvernatori dhe kanë mbajtur raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit në përputhje me raportin e Shtesave të kërkuara nga tamponet aktual makroprudencial, i cili për vitin 2022 kishte qenë + 1.5% mbi nivelin e ICAAP.

Për sa i përket kërkesave për MREL, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, Banka është kualifikuar për të mos zbatuar këto kërkesa, duke marrë parasysh pozicionin e saj në treg dhe produktet dhe shërbimet që ofron.

Banka monitoron të gjitha kërkesat e vendosura nga rregullatori për kapital gjatë gjithë periudhës dhe parashikon nevojat e ardhshme në mënyrë të vazhdueshme.

#### **41. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Pas datës së raportimit, gjatë javës së tretë të marsit '23, Credit Suisse Group ("CS"), një nga shtyllat më të forta të bankave në Zvicër, përjetoi një krizë besimi, e cila është shfaqur në dalje të konsiderueshme të fondeve të klientëve. Për të mbrojtur depozituesit dhe tregjet financiare, oferta nga UBS për të marrë përsipër Credit Suisse ka rezultuar të jetë zgjidhja më efektive.

Përpara atij momenti CB ishte një bankë financiarisht e qendrueshme e vlerësuar BBB-. Si rezultat, pasqyrat financiare të Bankës më dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022, e konsiderojnë kolapsin e CS si një ngjarje përgjithësisht materiale jo rregulluese.

Në datën e raportimit dhe në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, Banka ishte e ekspozuar ndaj CS në obligacione të pasigurta sinjore (senior unsecured bonds) me vlerë 500 mijë GBP. Duke ditur që UBS është një bankë e vlerësuar me AA-, u deklarua se do të ketë mbështetje të jashtëzakonshme nga qeveria, tranzicioni do të shkaktojë një regjistrim të plotë të vlerës nominale të të gjitha instrumenteve të Kapitalit shtesë të nivelit të parë të CS në zero dhe nuk do të ketë ndikim në instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë (Tier 2) dhe letrave me vlerë sinjore, ne nuk presim të pësojmë humbje në portofolin tonë të investimeve në letra me vlerë.

Pas datës së raportimit, përveç sa me sipër, nuk kanë ndodhur ngjarje që do të kërkonin rregullime dhe shënime shtesë në pasqyrat financiare të veçanta.

